

BIBLIOTEKA
SHËTËTIT

ESH-32

29



Dyller Hasani

**UNË
QË NDËRTOJ
SHËTËPI
PËR NJERËZIT**

novela e tregime

81H-32

H 29

DYLBER HASANI

UNË
QË NDËRTOJ
SHTËPI
PËR NJERËZIT



Novela e tregime

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

DYLBER HASANI

(1939-1976)

Tregimi i fundit që shkroi Dylber Hasani, «Unë që ndërtoj shtëpi për njerëzit», është kuptimplotë për jetën dhe krijimtarinë e tij. Si shkrimtar ai u rrit në gjirin e klasës punëtore. Qysh në tregimet e para të tij lexuesi ndien singëritetin, thjeshtësinë, humorin e shëndoshë dhe ngrohtësinë me të cilën shkruante autori i ri punëtor.

Në librat e vet «Godina 17» (1971), «45 minuta mbi çati» (1971), «Ballkoni i katit të katërt» (1972), «Ngjitja nëpër skela» (1975) dhe në tregimet e fundit ai solli punën dhe jetën e njerëzve që ka njohur kantierëve të ndërtimit, përpjekjet dhe vetëmohimin e tyre për ndërtimin e socializmit, botën e pasur të këtyre njerëzve të thjeshtë, me veti e tipare të larta morale, të edukuara nga Partia jonë.

Vëllimi që i jepet tani në dorë lexuesit, është një përmbledhje me tregime të pabotuara dhe me pjesë të zgjedhura nga krijimtaria e tij.

NGJITJA NËPËR SKELA

Im atë u mundua shumë të më mbushte mendjen që të mos e ndërprisja shkollën, por të vazhdoja më tej.

— Ç'janë katër klasë, — thoshte ai, — hiçgjë nuk janë. Unikja po, ajo ti hap sytë mirë.

Unë ngulja këmbë: jo dhe jo. Pasioni im i vetëm ishte të bëhesha bari lopësh. Profesionin e lopçarit në atë kohë ishte më i papërfillshmi në të gjithë fshatin. Por dhe unë isha djali më ters në fshat, prandaj me pasionin tim u kundërvihesha atyre që më bërtisnin. Kjo ishte një arsye që unë s'doja të bindesha në kërkesën e tim eti. Arsyeja tjetër ishte se atëherë nuk kishte shkollë shtatëvjeçare (unike siç e quanin) as në fshatin tonë dhe as në qendër të lokalitetit. Babai, kur më thoshte të ndiqja shkollën, kishte parasysh të më dërgonte te një mik, në një fshat të Kolonjës. Dhe kjo s'më pëlqente.

— S'ia dal dot, — thosha, — të bredh në dyert e botës.

Dhe arsyeja e tretë ishte se unë e quaja shumë të vështirë të mbërthehesha për një gjysmë dite në bankë, të mos lëvizja as kokën para e prapa,

majtas e djathtas e, me sy të mbërthyer në dërrasën e zezë të ndiqja shpjegimin e mësuesit. Dhjetë vjeç nisa klasën e parë. Dita e hapjes së shkollës së parë në fshatin tonë më gjeti në këtë moshë. Kishte edhe të tjerë, më të rritur. Hasani i Tahirit, që rrinte në një bankë me mua, ishte edhe tre vjet më i madh. Por, ndërsa Hasani rrinte me duar lidhur mbi bankë, mua më vinte plasje kur më detyronte mësuesi të mos dilja të lozja jashtë, në kohën e pushimit. Ishte viti 1945, kur u ula në bankën e klasës së parë të shkollës fillore.

Bëheshim tre fëmijë në shtëpi. Motra, tre vjet më e madhe, sillej gjithnjë urtë me mua, kujdesej që të mos griseshia e të mos bëhesha pis, megjithatë do të qe ditë e jashtëzakonshme po të kthehesha një mbrëmje në shtëpi me gishta të pavarur ose me pantallonë të pashqyera. Në fshat më quanin djalë zevzek, që nuk lë dy gurë bashkë. «Le të më quajnë, — thosha me vete, — më mirë zevzek, sesa i humbur». Vëllai më i vogël ishte i urtë. Sido që të sillesha me të, s'ndihej.

Mësues Muharremi, me atë zërin e tij të butë e të folurit e ngadalshëm, më porosiste pa u mërziur që të rrija drejt e të mos bëja zhurmë në klasë, të sillesha mirë edhe në shtëpi e në rrugë. Ai kërkonte rregull nga të gjithë. Për çdo mëngjes na kontrollonte për pastrimin e duarve, pastrimin e thonjve e për shkundjen e baltës nga pantallonat. Të tjerët e shikonin në dritë të syrit, kur ai fliste, dhe i përgjigjeshin: «Si urdhëron, si urdhëron!» dhe të nesërmen vinin me kërkesat e mësuesit të plotësuara. Mua më i rregullonin për bukuri nëna dhe motra rrobat natën, por unë, me t'u ngritur në mëngjes,

do të rrëshqisja në një rripë që ndodhej para shtëpisë.

Disiplina që kërkohej në shkollë, më mundonte shumë. Vija me shpresë se, duke mos qenë i rregullt, mësues Muharremi do të më largonte nga shkolla. Mirëpo ndodhte e kundërta: ai merrej me mua më shumë se me cilindo nxënës tjetër. E kisha dëgjuar të fliste me babanë tim:

— Është i zgjuar, por e ka të vështirë të përqëndrohet, — i thoshte. — Çështje edukate.

Dhe unë e përfytyroja edukatën si një majë mali, ku nuk mund të ngjitesha kurrë. Tri herë desha të ikja nga shkolla. Babai më çonte në shkollë e më kritikonte në prani të mësuesit e të nxënësve. Ai ishte kryetar i këshillit popullor të fshatit dhe si do ta zbatonte detyrimin arsimor, kur të mos shkoja në shkollë unë, djali i tij? Mësimet më tërhiqnin, veçanërisht ato që bënin fjalë për histori dhe ngjarje të mëdha, por librat e fletoret i mbaja gjithnjë pa kujdes e kështu, nota ime e përhershme ishte «mjaf-tueshëm»...

... Sidoqoftë, i kalova katër klasët e shkollës fillore. Bashkë me Zyberin shkoja për të kullotur lopët e fshatit: ai të lagjes së sipërme, dyzet krerë, unë të lagjes së poshtme, tridhjetë lopë, që e vija mbi një vit e gjysmë. Kur dilnim nga fshati, nisehim veç e veç, pastaj kur arrinim kullotën, i bashkonim.

Zyberi ishte njeriu që doja më shumë. Gjatë ditës futesha shumë herë nëpër pyll, kërkoja dru frashri për të bërë rrathë për zile e këmborë dhe dru bushi e dëllinje për lugë. Zyberi dilte në ndonjë majë kodre e thërriste:

— O Beluuuuul! Po nga humbe, more kolopuç?

E dëgjoja dhe nuk i përgjigjesha. Dilja kur më mbushej mendja. Ai më fliste me të butë. Asnjehere s'mbaj mend të jetë nxehur me mua.

Në fshatin tonë Zyberi ishte i ardhur. Shkaku i ikjes nga vendlindja kishte qenë grindja me një aga të atij fshati. Dervish e kishte emrin agai. Ai kërkonte që Zyberi të kulloste vetëm dhjetë lopët e tij. Zyberi ankohej se, aq sa e paguante Dervishi, s'i dilte as për bukën e gojës. Me të u bashkua fshati, dhe agai, për hakmarrje, i grabiti mushkën, Arapkën, që Zyberi e mbante gjithnjë pas lopëve. Në darkë, kur kthehej në shtëpi, e ngarkonte edhe mushkën me dru. Pesë dhi edhe Arapkën kishte pasuri Zyberi. Por Arapkën ia grabiti Dervishi dhe e çoi në ca agallarë të tjerë, miq të tij, në një fshat të largët.

Atëherë që formuar çeta e parë partizane e krahinës. Partizanët e njohën mushkën e lopçar Zyberit dhe ia dorëzuan të zotit. Dervishi u hodh në anën e ballistëve. Zyberi u lidh plotësisht me partizanët. S'mund të qëndronte më nën hundët e hasmit. Erdhi në fshatin tonë, ku kishte mbështetje kushërinjtë nga e ëma, babanë tim dhe gjashtë vëllezërit. Fisi ynë që bashkuar me Lëvizjen Nacional-Libërimitare. Gjithë-gjithë bëheshim një mëhallë.

Meqë nuk mund të ndërtonte shtëpi të vetën, u strehua te ne. U bëmë shpejt si njerëz të një familjeje. «Fukarenjtë i bashkojnë hallet, zengjinët i bashkon tahmaja», thoshte Zyberi në bisedat e netve të gjata të dimrit. Mua më donte veças të gjithëve. Po të kishte në prehër djalin e tij, Shahinin, e kalonte në njërin gju dhe mua më merrte në gjurin tjetër.

Kjo ndodhte kur isha i vogël. Ja, u rrita dhe u

bëmë si shokë. Shpirti im dhe i Zyberit ndienin kënaqësi në natyrën e gjallë, në pllajat e bleruara e pyjet me drurë të mëdhenj. Gjithë kohën, nga fillimi i prillit deri në fund të tetorit, andej e kalonim. Pesë muajt e tjerë kullotat malore mbuloheshin nga dëbora dhe fshatarët kujdeseshin secili për lopët e veta, i mbanin me ushqim të thatë e në kullotat dimërore në afërsi të fshatit. Gjatë kësaj kohe, unë e Zyberi përgatishim parmenda dhe orendi të tjera bujqësore.

Zyberit i vinte ndoresh për disa lloj pune. Ai meremetonte samarët e u mbathte potkonjtë kuajve të fshatit, kur ktheheshim në mbrëmje. Ditën mërrte me vete tel e u përgatiste shtiza grave të fshatit, bënte çibukë e bastune për pleqtë. Ndjaj të tjerëve e mbante të fshehtë ustallëkun, kurse mua m'i mësonte të gjitha.

— Të dua, se, vërtet je i sertë, por je dhe i mprehtë e i drejtë, — më thoshte.

Por, ç'është e vërteta, edhe ndaj meje ai kishte sekrete. Natyrisht, më pak se ndaj të tjerëve, por si doqoftë kishte. Zyberi kryente detyrën e dentistit. Darët me kokë të kthyer dhe një shishe çereklitërshë me raki prej mani të zi i mbante gjithnjë në çantën e tij.

Nën hijet e aheve dhe të lisave të mëdhenj kishte shkukur me qindra dhëmbë e dhëmballë. Vinin nga të gjitha fshatrat e krahinës, edhe vllahët e malit e kurbatët e çadrave.

Kur kryente këtë punë, mua më përzinte:

— Ik e priti lopët andej nga ana tjetër, se janë futur thellë pyllit e mos u del përpara ndonjë egër-sirë.

Ditët e para i bindesha. Më vonë mendoja se ai

diçka më fshihte. Ky mendim nisi ngadalë-ngadalë e pas ca kohe m'u kthye në një shqetësim të përditshëm.

«Përse të ma punojë kështu, me hile, Zyberi mua?»

Ja, edhe Zyberi, që unë e quaja dhe e vlerësoja për njeri të drejtë, punokësh tinëz meje, më mbakësh të fshehta. Kurse unë s'kurseja asgjë për të.

Ekonomikisht ai ishte më ngushtë se familja ime. Kishte gjashtë fëmijë, të gjithë të vegjël, vetëm për bukë, siç thoshte edhe vetë. Djali i madh, Shahini, ishte tre vjet prapa meje. Në muajt maj, qershor dhe dhjetë ditët e para të korrikut, kur piquej elbi, familja e Zyberit ndihej më hollë se familja ime për ushqim. Ai vetë merrte në çantë një copë bukë të vogël (babai im aq hante në mëngjes, para se të ndizte cigaren) dhe pak gjizë në një kuti të drunjtë, që e kishte përgatitur vetë. Ishin ngushtë dhe nga bulmeti: dhjetë dhen bëheshin, por vetëm pesë qenë me qumësht, kurse lopa që blenë para dy vjetësh, kishte mbetur mbarsë atë kohë.

Unë zihesha përherë me nënën time që të më vinte më shumë bukë në çantë dhe lëkurën, ku mbaja dhallë e qumësht përzier, të ma mbushte plot. Kur uleshim për të ngrënë, i hapja përpara dhe e ftoja Zyberin me gjithë zemër. Ai mbaronte pjesën e vet dhe ngrihej. Vraponte të kthente ndonjë lopë që shkëputej nga tufa. Atëherë ngrihesha edhe unë e i shkoja pas. Sapo uleshim, hapja çantën dhe lëshoja ushqimin përpara. Zyberi përsëri bënte të ngrihej. Unë i vija duart te gjunjët. S'e lejoja të çohet.

— Nuk më hahet, Belul, të betohem për Pirballëmin që nuk më hahet.

Pirballëmi kishte qenë dikur një dervish me emër, i famshëm për mrekullitë e tij, sipas tregimeve që Zyberi i pat dëgjuar kushedi se nga kush. E dija atëherë se, kur betohej për emra fetarë, nuk thoshte të vërtetën.

*

*

*

Shqetësimi im pse Zyberi më mbante të fshehta, më mundonte çdo ditë.

Një ditë, lopët i çuam të kullosnin nga pllajat e Qelqëzës. Qelqëza është maja më e lartë ndër mallet përreth. Kur dilja atje, shikoja krahina të tëra, sa më arrinin sytë. Shikimi më ndalonte vetëm kur ndeshej me Gramozin, Nemërçkën e Tomorin. Këto male ngriheshin më lart nga Qelqëza, ku qëndroja unë. Pllajat poshtë majës mbuloheshin vende-vende me pyje prej ahesh gati pesëdhjetë metra të larta, e vende-vende të zhveshura, ku qenë krijuar livadhe të pjerrëta, plot me bar të njomë. Bari nuk thahej gjatë gjithë verës. Vetëm në vjeshtë, kur ftohej koha e niste të binte brymë, gjethet e aheve binin dhe bari i livadheve merrte ngjyrën e verdhë. Në verë mbretëron gjelbërimi. Burimet i gjen të shpeshta dhe uji është i ftohtë akull. Sa herë që vendosja ta mbaja gishtin në atë ujë duke numëruar deri në njëqind, s'ia mbërrija dot. Një burimi që ndodhej në krye të një sheshi në formë rrethi të rregullt, i bëmë çezmë prej druri dhe ia vumë emrin Çezma e Lopçarëve. Dora e kujdesshme e një bariu më të hershëm kishte mbjellë një gështenjë pranë burimit. E vetmja gështenjë në gjithë atë mori ahesh. Degët

e saj merrnin formën e një çadre të madhe dhe bënin hije të plotë në kohën e vapës. Atje, nën hijen e gështenjës, pranë Çezmës së Lopçarëve, shpeshherë bënim pushimin e drekës, ndërsa lopët, të ngopura, përtyreshin rrëzë pyllit.

Pikërisht atje na gjetën atë ditë tre vetë, që erdhën për të takuar Zyberin. Nga rrobat e shajakta njiheshin që ishin vllah, dy burra dhe një nuse e re. Kuptohej se ishte nuse e jo vajzë nga gjerdani i rruazave që i mbështillej rreth gushës së bardhë. Vllakat e pamartuara nuk mbanin të tilla. Njëri prej burrave që i moshuar, me mustaqe të zeza, të përdredhura e me majë, tjetri i ri, me faqe të kuqe e flokë të verdhë. Nusja që hipur mbi mushkë. Sapo e zbritën, u ul mbi bar, nën hijen e gështenjës. Nga biseda që bënë me Zyberin, mësova se nusja ishte vajza e plakut dhe djali dhëndri i tij. Vllaka gushëbardhë rrinte mbi bar me trup të përkulur, me pamje të pikëlluar dhe sy të përbotur. Dorën e djathtë e mbante mbi mjekër. I dhimbte tmerrësisht dhëmballa. Prandaj edhe e kishin sjellë te Zyberi.

— Pas dy minutash, usta Zyberi do të të bëjë që ti të ndihesh e lehtë si flutur, — i tha i ati së bijës.

Më i riu s'qe në gjendje ta fshihte shqetësimin. Zyberi mendohej me vështrim të përqëndruar mbi nusen e re, që mbështillej në dhembjen e saj. Për pak ai i ngriti sytë dhe m'u drejtua mua.

— Ti, Belul, ik e shiko, se mos na futen lopët në thellësi të pyllit!

E prisja këtë urdhër. Arsyen për të mos u bindur munda ta gjeja me lehtësi. Lopët ndodheshin të gjitha aty, përçark sheshit. Po të donte Zyberi, unë isha gati që në çast t'i numëroja një për një.

Nuk kundërshtova... U futa në pyll dhe, duke ecur, thërrisja ho, ho, hooo...! Veproja kështu, që Zyberi të mendonte se po shkoja gjithnjë e më larg. Kështu ai do të niste nga puna i shkujdesur. Ndalova. Prita pak dhe u ktheva mbrapsht. Ecja me kujdes, opingat i mora në dorë, që të mos ndihej zhurma e hapave, kur shkelja mbi gjethet e thata të ahut. U afrova dhe u fsheha pas një trungu ahu. Pas atij trungu mund të fshiheshin katër vetë. Njerëzit që vrojtoja, i shikoja fare qartë dhe zërat e tyre vinin si me porosi në veshët e mi.

Zyberi po i shikonte dhëmballën e prishur vllakes, që rrinte me gojë të hapur. Dy burrat shikonin.

— E ka shumë keq, — tha Zyberi, kur mbaroi së shikuari, — është qelbëzuar. S'e marr dot përsipër. Shkoni te dentisti, në qendër. Është ca larg vërtet, po më mirë të lodheni e të mundoheni, sesa...

Nusja e re s'pati më forca të përmbahej dhe shpërtheu në dënesë. Ajo shpresonte se pas pak do të shpëtonte prej dhembjes që e mundonte, kurse shpresat iu rrëzuan. Qante me zë, duke thënë: — Oh, unë e zeza! Oh, unë e mjera!

Burri i moshuar iu lut Zyberit:

— Aman, shpëtoje!

— Është me zarr. Është me rrezik, — kundërshtonte Zyberi. Dukej shumë i vendosur në kundërshtimin e tij.

«Më shkoi huq përgjimi», thashë me vete.

Nusja s'i ndalonte dënesat dhe as plaku lutjet. Me ta u bashkua edhe flokëverdhi.

Zyberi as fliste, as vepronte. Më në fund tha:

— Mirë, po ia shkul, por të më betohesh ti për kokën e sat bije, që, sapo të ikësh nga unë, drejt e te dentisti ta shpiesh, — iu drejtua burrit të mo-shuar.

— Për kokën e kësaj çupe, që e kam të vetme, do të bëj si më thua, — u përgjigj me një frymë i ati i së sëmures.

— Epo, na daltë për mbarë! — tha duke psherëtirë dentisti pa shkollë, i njohur në tërë krahinën. — Na lini vetëm tani.

Edhe këtë e prisja unë. E dija që Zyberi s'lejon-te asnjeri ta shikonte kur hiqte dhëmballë.

Dy të tjerët u shikuan sy në sy, të lëkundur. I pari u largua plaku dhe më i riu pas tij. Ecën dhjetë-pesëmbëdhjetë hapa më tej dhe rrinin karshi njërit-tjetrit, pa thënë asnjë fjalë. Prisinin.

Gjithë vëmendja ime u përqëndrua në veprimet që kryente Zyberi. Ai mori nga trasta darët e mbështjella me tri peceta të reja. Se si më vinte kur krahasoja ato peceta me mëngët me arna të këmishës së Zyberit. Këputi disa gjethe ahu, i lau me raki dhe vendosi mbi to darët. I lau edhe darët me raki. S'ngopesha duke e shikuar në ato çaste. Fytyra i merrte pamjen e njeriut që kryen detyrën më fisnike në botë. I tha së sëmures të mbështetej tek ahu më i afërt.

U gëzova së tepërmi ngaqë vendi ku u ul vllaka, ndodhej përkundrejt vendit ku rrija vetë. Kështu, s'më shpëtonte pa shikuar asgjë. I pashë dhëmbët e darës që u ngjeshën pas dhëmballës. Për një çast fare të shkurtër u ndalën, pastaj dora e dja-

thtë e Zyberit bëri një lëvizje mjaft energjike, darët dolën jashtë gojës, duke mbajtur të shtrënguar fort dhëmballën e saposhkukur. Nusja e re pati kohë vetëm sa të lëshonte klithmën «aaa» dhe iu mbyllën sytë vetvetiu. Zyberi e qëlloi fort në faqen tjetër. Nusja u përmend, e mblodhi veten.

Dy burrat që kishin ardhur me të sëmurën, u gjendën pranë saj me të dëgjuar klithmën.

— Ma keni lënë mua, ikni ju tani, — u foli i nxehur Zyberi. — Ju thërres vetë.

Ata u larguan me shpejtësinë që erdhën.

Buzët e nuses së re qenë gjakosur. Zyberi grisi një leckë të pastër, që e nxori nga pecetat, ku mbante të mbështjella darët, e lagu me raki dhe ia vendosi te vendi ku hoqi dhëmballën. I fshiu gjakun nga buzët... pastaj thirri babanë dhe burrin e së sëmurës.

* * *

Këtu unë e ndërpreva përgjimin tim. Ashtu lehtë-lehtë, siç erdha, zbathur e me opingat në dorë, u futa midis pyllit. Si u largova ca, zura përsëri të bërtisja: ho, ho, ho... që t'i jepja Zyberit përshtypjen se po mblidhja lopët.

Kaq desha. Tani dija se si shkuleshin dhëmballët. Le ta mbante të fshehtë Zyberi sa të donte...

Të pasnesënmen i kullota vetëm lopët. Zyberi s'erdhi. E lajmëruan të paraqitej në qendrën e lokalitetit. Siç më tha ai vetë, një veteriner i thërriste në mbledhje disa nga blegtorët, që t'u jepte disa këshilla e udhëzime.

Kur erdhi, s'më tha asgjë për atë mbledhje. As unë s'e pyeta. Dukej i mërzitur. Ç'të kishte? Pushimin e drekës e bëmë te Çezma e Lopçarëve. Sapo hëngrëm bukë, Zyberin e mbërtheu gjumi.

S'prita më. Mora me të shpejtë darët nga torba e tij dhe vrapova midis lopëve. E kisha bërë ndër mend si do të veproja: ta bëja praktikën e dentistit me ndonjë lopë.

Kafshët përtypeshin më nge. Sytë e tyre si të qelqtë më shikonin si të çuditur. Cilës do t'ia ndërprisja të përtypurit? Ndjeva keqardhje. Ndoshtesha në një gjendje të papërcaktuar. Qetë ishin të përjashtuara. Respekti për punën që kryenin, më ndalonte të bëja operacion prove në gojën e një kau. Ndryshe me lopët. Kau tërheq parmendën. Nga shpatullat e tij prodhohet buka. Pa qumësht lope kalon, po pa bukë... Kështu mendoja.

Po me cilën lopë do të praktikohesha?

«Ç'të mendohem gjatë, — thashë me vete. — Njësoj janë të gjitha». I fola njëres që ndodhej më pranë.

— Çohu, Zeskë!

Lopa u ngrit me përtesë duke tundur kokën. Lëkundesha. Hera e parë që veproja kështu. Vërtet isha unë, «djali zevzek, që s'lija dy gurë bashkë», por lopët m'i jepnin në mirëbesim për t'i ruajtur e kullotur. Për punën që bëja, edhe më paguanin. Çdo familje hiqte nga goja e fëmijëve një kilogram misër për çdo muaj e ma jepte mua.

Zeska, që e ngrita nga vendi, ndaloi përtypjen dhe më shihte si me çudi. Ndërrova mendje në çast. S'do ta ngisja më tej. I zoti i saj, Xhaferri, vetëm atë lopë kishte. Pesë fëmijë prisnin të njominin lugën me qumështin e Zeskës. Nga dhembja që

do t'i shkaktoja, do ta priste qumështin. Jo Zeskën e Xhaferrit, jo.

Atëherë Balashkën e Pandeliut. Ai kishte dy lopë. Mund t'u qaja hallin atyre që kishin vetëm nga një. Pandeliu, edhe në ia ndërpriste qumështin Balashka, kishte tjetrën.

— Balashkë, çohu!

Ndjeva përsëri pendesë. Pandeliu kishte miqësi me tim atë. Vinte shpesh te ne, në shtëpi. Sa herë më ndëshkonin prindërit për padrejtësitë e mia, Pandeliu më qetësonte me fjalë të buta. Ai punonte murator bashkë me vëllanë më të ri, Gjergjin. E pra, vërtet kishin dy lopë, por ishin edhe dy vëllezër, dy palë fëmijë. Dhe me sa mundim i patën blerë ato dy lopë! Punonin në ndërtimin e shtëpive të të tjerëve gjithë ditën. Bridhnin fshat më fshat me vegla në krahë. Ata të dy punuan në ndërtimin e shkollës së fshatit tonë, në dy shkolla të fshatrave të tjera, në ndërtesën e këshillit popullor të lokalitetit, në spitalin e ri. Kanë qenë të varfër gjithnjë. Gjatë luftës punonin në terren me babanë tim. Tani, pas luftës, iu vu në punës me gjoks dhe e rregulluan disi gjendjen. Jo. Lopën e Pandeliut s'do ta tra-
zoja.

Më pushtoi një ndjenjë dyshimi e papërcaktuar. Siç e kisha zënë, s'besoja të më dilte ndonjë lopë e përshtatshme për t'u praktikuar në shkulljen e dhëmballëve.

Shikoja të gjitha lopët tek përtyreshin dhe mendohesha. Lopën e Tafilit jo, të Çaushtit, jo të Ndrekes jo...

Sytë m'u ndalën te lopa e Muhametit. Muhametit i bëheshin tri lopë e tri mëshqerra, që ishin gati të bëheshin me viça. Pas dy apo tre muajsh Mu-



hametit i bëheshin gjashtë lopë me qumësht. Kishte pasur edhe më shumë përpara. Mbaja mend që pesë lopë ia morën pa shpërblim dhe ua ndanë atyre që s'kishin fare. Njëra nga tri lopët e Muhametit ishte e përshtatshme për t'u praktikuar në shkulle dhëmballe. Zgjodha Murricën, atë që kishte më shumë qumësht.

— Çohu, Murricë!

Kësaj here s'ndieja aspak lëkundje. E treta e vërteta, thashë me vete. Hoqa nga mesi litarin, që e kisha marrë në mëngjes nga shtëpia. E futa Murricën e Muhametit midis dy aheve që ndodheshin pranë e pranë dhe e lidha për brirësh. Meqë vepra mbi një lopë e jo mbi një njeri, siç bënte Zyberi, s'ndihej nevoja t'i pastroja më parë darët me raki. Ia hapa gojën lopës dhe i ngjeshja darët pas dhëmballës më të madhe që vura re. Kur e tërhoqa, dhëmballa nuk shkulej. S'më mjaftonte forca. Trupi m'u mbulua me djersë. I zura darët me të dyja duart. Lopa u vërsul që të këpuste litarin. Mua më mbeti në dorë dara me një copë nga dhëmballa. Në çast nxora biçakun dhe preva litarin që mbante lidhur Murricën e Muhametit. Ajo filloi të pëllasë. Gjaku i shkante çurg nga goja. Filluan të pëllasin edhe lopët e tjera si në kor.

Me shpejtësi rrufeje futa në gji litarin e darët dhe vrapova më thellë në pyll. Kështu, kur të zgjohesh Zyberi e të më thërriste, do t'i pëngjigjesha së largu.

Në vrap e sipër u pengova dhe rashë. Kontrollova këmbën mos isha çjerrë. Asgjë. Opinga më ishte shqyer; qe kapur pas një cope predhe të mbetur gjatë luftës. Më shkoi mendja në djallëzi. Shpejt

e shpejt theva copën metalike ndërmjet dy gurëve dhe copën më të vogël e futa në xhep.

Ndërkaq u dëgjua zëri i Zyberit:

— E ç'kanë ato lopë që pëllasin, o Belul? — Unë lëshova një o, mor, ooo! dhe vrapova drejt vendit ku pëlliste grumbulli i lopëve. Arritëm në të njëjtën kohë me Zyberin. Ai u çudit kur pa gjithë atë gjak. I hapi gojën Murricës.

— Ou, po kjo pikë e zezë! — tha me dëshpërim.

Nxora fshehtas nga xhepi copën e hekurt, e ngjeva me gjak dhe ia tregova Zyberit. Ai e mori në dorë dhe e kthente dhe e rrotullonte.

— Do të ketë qenë poshtë ndonjë kërpudhe, — thashë. — Lopa e ka mbështjellë me gjithë atë. Tak-sirati i dhëmballës.

Ai heshte.

— Shko më merr pak darët dhe shishen e rakisë, — foli pas pak.

U nisa në sekondë.

Më eci. S'ishte më nevoja të mendoja për të krijuar ndonjë gënjeshtëri.

Ndieja kënaqësi që ia hodha Zyberit. Nejse, s'ka gjë, mendova. Rëndësi ka që Zyberi nuk mori vesh hiçgjë.

Por isha gabuar. Në dhëmbët e darës kishte mbetur një çikë gjak. Kur e futa në gji, ashtu me nxitim, s'munda të tregohesha i kujdesshëm. Edhe në këmishë kisha dy njolla gjaku.

— Ç'ke bërë kështu, mor spurdhjak! — tha rreptë Zyberi, ndërsa vërente pikat e gjakut në dhëmbët e darës.

Më zbërtheu komçat e këmishës. Nga gjoksi im rrëshqiti litari në tokë si gjarpër i ngordhur.

M'u rrëqeth trupi. Me siguri fytyra do të më qe

bërë dyllë e verdhë. Mendoja kështu, ngaqë vura re menjëherë se Zyberi ishte shqetësuar pa masë.

— Ndihmomë ta lidhim prapë lopën, — foli me zë të zbutur.

Pas gjysmë ore Zyberi mundi që gjakun që i rridhte lopës, ta pushonte, sepse ia hoqi edhe pjesën tjetër të dhëmballës.

Zyberi ndezi një cigare. E thithte tymin me forcë.

— Nga ç'u ruajta, nuk shpëtova, — tha i menduar. — Po ç'të tha mendja, Belul? Unë e kam zënë nga e keqja, kur isha i ri. Shikoja njerëzit që vuanin nga dhembja e dhëmballëve. Kërkonin ndihmë të njohurit e mi, që u dhimbnin dhëmballët. Kush t'i ndihmonte? Një plak që dinte, s'kishte më fuqi. I shkova plakut në shtëpi dhe i thashë të më mësonin. Më mësoi, ndjesë pastë. Me darë të hekurta ua hiqja dhembjen. Po ka pasur edhe raste që ua shtoja dhembjen. Nga e keqja mësova unë t'u shkull njerëzve dhëmballët. E ku kishte atëherë dentist në këto anët tona?

Dëgjoja i përhumbur dhe i penduar që pata menduar keq për Zyberin. Më tregoi edhe për pasojat e asaj vllakës që i hoqi dhëmballën e qelbëzuar para pak ditësh. Asaj i qe infektuar mishi i dhëmbëve. E çuan te dentisti i lokalitetit natën.

— Prandaj më thirrën në lokalitet, — vazhdoi Zyberi.

— Më qortuan shëndoshë. Ma bënë paq. Më thanë se kam mbeturina të vjetra. Mirë më thanë. Unë përsëri i mora darët me vete. Nga ç'u ruajta, s'shpëtova. Më mirë të kisha folur hapur me ty. Ti deshe të bëje si unë, pa e vrarë mendjen.

Ai fliste. Unë dëgjoja dhe mendoja.

«E ç'gjë e madhe u bë, se theva dhëmballën e një lope!» Në fakt, këtë mendim doja t'ia kundërvija shqetësimit që ndieja e që po nxirrte kokë në ndërgjegjen time.

Kësaj radhe Zyberit i mbeti qejfi. Ia kisha punuar me hile. Unë dyshoja në sinqeritetin e Zyberit. Kurse ai donte të më ndalonte rrugën e mësimin të atij profesioni të dëmshëm. Shteti nuk i kishte hapur kot klinikat për mjekimin e dhëmbëve.

Lopa e Muhametit, që unë i theva dhëmballën, i takonte Zyberit për t'u kujdesur. Mund t'i infektuhej edhe asaj plaga, ashtu si asaj vllakës para tri ditësh. Atëherë Muhameti do të ankohej për Zyberin.

S'do ta lejoja Muhametin të njolloste emrin e Zyberit. Do të shkoja drejt e në mbledhje të fshatit e do të thosha:

— Fajin e bëra unë, mua më gjykoni e më dënoni. — E kisha aq kurajë, sa t'i dilja së vërtetës ballë për ballë.

Por edhe me kaq nuk mbyllej. Babai im ishte kryetar i këshillit popullor në fshat. Po sikur ta kritikonin ose edhe ta hiqnin babanë prej këshillit për fajin tim? A nuk e kritikuan Ademin nga kryesia e këshillit të Frontit për fajin e të birit, që vriste pulat me llastik. Si t'i humbiste tim eti gjithë ai nder që gëzonte?! Në fshat kishte edhe nga ata që nuk e donin. Ja, Muhametit do t'i hapej më shumë goja për të sulmuar babanë tim. E merrja me mend se si do të fliste.

«Mua më vjen keq për Malon, se është njeri i urtë e punëtor. Por ç'e do, s'e lënë hallet që të drejtojnë edhe punët e mëdha që ka fshati. Ja, ka këtë djalë, që zoti ia faltë, se e ka rritur me shumë vuajtje e përpjekje. E dimë të gjithë sa është munduar Maloja për të rritur fëmijët, për të rritur këtë djalë, që s'iu bë për të qenë. Ç'të shikojë më parë Maloja, djalin e tij, apo fshatin? Unë them që të shikojë më mirë të birin, se kështu do të lërë rehat edhe fshatin». Kështu do të fliste. Ai kështu kishte folur edhe pa pasur shkak e jo më tani, që i vinte vetë lepuri në shteg.

Mos isha unë vërtet një djalë që s'u bëra për të qenë, ashtu siç do të thoshte Muhameti? Kur isha më i vogël, bridhja gjithë ditën gur me gur, ferrë me ferrë e gërmadhë me gërmadhë. E pranoj, disa nga moshatarët kishin akoma shenja plage që u shkaktoja kur ne mundeshim për mes, dhe ata, ngaqë isha më i fortë, më vinin stërkëmbësh. Kështu e ndëshkova edhe Qerimin e Muhametit, se më erdhi që prapa kurrizit e më shtyu në një gropë me ujë. Ashtu i lagur me ujë dhe i llangosur me baltë e ndoqa Qerimin vrimë më vrimë. Ai nxitoi për nga shtëpia e vet, u fut në plevicën e kashtës. U shpejtua e menjëherë i vuri derës shufrën e hekurt nga brenda. Mora një gur dhe e zërtheva derën. Qerimit i hyri tmerri. S'priti më, u fut me kokë në kashtë e u zhduk në të. Edhe në kashtë e ndoqa pas. E mbërtheva për këmbë.

— Aman, mos më ngit! — bërtiti. — S'të ngacmoj më.

E ngjeshja fort afje, brenda në kashtë.

— Aman, së m'u zu fryma, — thirri.

Ai përpëlitej që të dilte jashtë, unë e ndiqja pas.

Duke u vërtitur, duart më prekën diçka, që s'ngjan-
te si kashtë. E provova përsëri, dora m'u mbush me
disa si kokrra. «Si misër më duket», thashë me vete.
E shtyva dorën në thellësi. Grumbulli i kokrrave s'ki-
shte fund. E lashë Qerimin të përpëlitej nëpër ka-
shtë dhe vetë, me kokrrat në dorë, dola jashtë. Ko-
krrat ishin misër. Misër atje, brenda në kashtë. Dhe
disa nga fshatarët, që s'kishin bukë, mbeteshin me
thasë në krahë në depon e shtetit.

... Në shtëpinë tonë vinin gjithnjë për të fjetur
të deleguarit, pasi bënë mbledhje me fshatarët për
grumbullimin e drithit të tepërt. Së pari, thoshin
ata, të furnizohen brenda fshatit ato familje që s'e
kanë bukë të mjaftueshme sipas normës së caktuar
për çdo pjesëtar. Pjesa tjetër të dërgohet në ndër-
marrjen e grumbullimit për furnizimin e qytetit.
Unë e pyesja babanë tim se ç'i shtynte këta njerëz,
që interesoheshin kaq shumë edhe për fshatin edhe
për qytetin.

— Janë komunistë, — më thoshte im atë.

— Po ti, a je komunist? — e pyesja përsëri.

— Unë jam shok i komunistëve, — më përgji-
gjej.

Atëherë, kur bëhej grumbullimi i detyruar i te-
pricave, ata, me gjithë grupin e rinisë, shkonin shtë-
pi më shtëpi, i bindnin fshatarët se s'duhej të mba-
nin teprica. Ne fshatarë të varfër kishim qenë edhe
gjatë luftës, por partizanët i kishim mbajtur me bu-
kë.

Unë shkoja ngaherë me babanë, Pandeliun, Kri-
ston, të deleguarit dhe grupin e rinisë.

Një pjesë e mirë e fshatarëve tregoheshin të
gatshëm.

— Ja, këto pesëdhjetë qillo po ia jap pushtetit.

Por kishte edhe nga ata që mblidhnin supet e thoshin:

— S'kemi ç'të japim, vetëm shpirti na ka mbetur.

Në të vërtetë, jo vetëm të rriturit, por edhe në të vegjlit e dinim se në ç'gjendje ishte secili fshatar, se cilët blinin bukë e kush shiste nën dorë.

Për Muhametin e dinin të gjithë se kishte shumë drithë të tepërt. Ai atë vit dorëzoi vetëm një kuintal misër.

— Këtë kam. Merreni, jua jap me gjithë shpirt. Kisha edhe pak tjetër, por ua dhashë disa fshatarëve tanë, që u kanë mbetur kalamajtë pa bukë.

Një natë më parë u kishte dhënë vërtet tre-katër fshatarëve, kujt dhjetë e kujt njëzet kilogramë misër. Veçse ata nuk ishin më të varfrit e fshatit, «ata që i kishin kalamajtë pa bukë». Atëherë ka qenë fillimi i muajit mars dhe në atë kohë asnjë shtëpi e fshatit tonë s'mbetej pa bukë. Tutje, nga fundi i prillit e fillimi i majit, po. Ata fshatarë Muhameti i numëronte si mbështetje të tij. Prandaj dhe hiqej sikur i shpëtonte nga e keqja me atë pak misër që u jepte.

Edhe atë kuintal misër që dha Muhameti tepriçë, ishte i hidhur. Me siguri, e kishte nga të vitit të kaluar, ndoshta edhe më të vjetër.

... M'u kujtuan këto ngjarje, ndërsa mbaja në dorë ato kokrra misri, që gjeta të fshehura në kash-tën e plevicës së Muhametit. S'patën kaluar as dhjetë ditë që kur u mblodhën tepricat.

E lashë, pra, Qerimin të zhgërryhej në kashtë dhe, me kokrrat e misrit në dorë, vrapova te babai, që punonte në krasitjen e pjergullave.

— Të lumtë, Belul, — tha im atë dhe më shtrën-

goi dorën, si të isha një burrë i madh. M'u bë qejfi shumë.

Babai e la punën. Iu qepa pas. Takuam Pandeliun e Kriston, morëm me vete edhe disa nga të rinjtë e shkuam në shtëpinë e Muhametit, të cilin e gjetëm të alarmuar.

— Më ka rrahur yt bir djalin për vdekje, o Mallo! Do të nisem që tani për ta çuar në spital. Është keq, rri shtrirë.

Unë përfitova nga rasti që burrat po bisedonin në këmbë, të mbledhur afër e afër, dhe renda me vrap në dhomën ku ishte Qerimi. Rrinte më kurriz dhe herë pas here rënkonte. Bënte kot. E shtrëngova fort në rrëzë të veshëve dhe i fola me inat:

— Ngrehu tani e nxito të të shikojnë ata burrat që janë në oborr të shtëpisë, se ta mora shpirtin, të vdiqa në vend!

Qerimi s'priti sa t'i mbaroja fjalët të gjitha. U ngrit e vrapoi si një atlet para burrave që bisedonin.

— Mos u shqetëso për djalin, — i tha Pandeliu Muhametit. — Shkojmë te misri, në plevicën e kashës, tani, për atje kemi ardhur.

Muhameti i tërhoqi këmbët zvarrë. Gjatë kontrollit iu gjetën edhe disa kuintalë grurë tepër. U lamë vetëm nga 17 kilogramë për frymë në muaj.

Qysh atëherë ai s'linte rast pa thënë për mua: «S'u bë djalë për të qenë.» Le të thoshte. S'prisja të më mburrte Muhameti. Ai lëvdonte të birin, që ishte një qull i tëri. Kur ia zinte zegali qetë, vinte ulërimën.

Përse s'isha djalë për të qenë unë? Mos ishte punë e paktë ajo që bëja duke kullotur lopët e fshatit së bashku me Zyberin?

Unë shkova vetë bari me lopë, pa më thënë as-

kush. Shokët e organizatës së rinisë më thirrën dhe më falënderuan për këtë veprim. Unë shkova, se më pëlqente, sidoqoftë, punë të mirë bëja. Fshati ishte nderuar në dorëzimin e planit të mishit. Gjithë qetë e lopët e vjetra, të dorëzuara në Grumbullim, kishin dalë të cilësisë së parë. E pra, si s'qenkësha unë djalë për të qenë?

Para një jave më thirrën në organizatën e rinisë. Në çdo mbledhje të zgjeruar më kanë thirrur. Kanë kaluar gjashtë muaj që kur kam paraqitur kërkesën për t'u pranuar anëtar rinie. S'më vjen mirë të rri i veçuar, u bëra 15 vjeç djalë. E dija se, me të paraqitur kërkesën, do të më pranonin. Por s'qenkësh aq e lehtë. Herë pas here më ngarkonin detyra. Para një jave më lavdëruan për punë të mirë, për kujdes ndaj lopëve të fshatarëve. Por nuk harruan edhe të më kritikonin. M'i numëruan të gjitha: sa fjalë të pahijshme kisha përdorur, kur isha grindur me fshatarët, sa ara gruri e misri kisha demtuar. S'e nderonin këto një të ri që kërkonte të pranohet në organizatë.

Këto mendoja, ndërsa Zyberi fliste kundër mbeturinave. Lopët u ngritën nga hijet e aheve dhe u grumbulluan në shesh. Kërkova me sy Murricën e Muhametit. Ajo kulloste si edhe para se t'i shkulej dhëmballa. Në atë çast se si më erdhi një mendim. Të bëja provë në dhëmbët e Muhametit; ndoshta do të ishte më mirë.

■

Një ditë Zyberi më tha:

— Në Fshesas pashë që po bëjnë një shkollë të re e të madhe. Mirë që na thërresin nganjëherë an-

dej nga qendra e krahinës, shkojmë e hapim sytë. Na mbinë në sy brirët e lopëve e trungjet e aheve. E, që të ta ngas fjalën, po bëjnë një shkollë të madhe. Pandeliu e Gjergji me shokë po e ndërtojnë. Ata bëjnë punë. Punë që do t'i mbajë të gjallë edhe kur të kenë vdekur. Në atë shkollë të re e të madhe do të mësojnë të gjithë fëmijët që kanë mbaruar nga katër klasë. Kështu dëgjova të flitej andej nga zyrrat e lokalitetit. Edhe ti, Belul, shko në atë shkollë. Lopët m'i lër mua.

Deri këtu pata durim të dëgjoja. Ç'më duhej shkolla mua? U ngrita pa thënë asnjë fjalë. Si bëra disa hapa më tej, ktheva kokën. Zyberi s'm'i ndante sytë.

— Hajde t'ia marrim një herë, — më tha. Ndalova. Nderkaq ai nisi këngën e tij të preferuar:

*Nga trimat e Shqipërisë,
Bilal Alipostivani...*

Duke e shoqëruar, iu afrova pranë. Kënga bënte fjalë për një trim mbi trima, siç thoshte Zyberi. Kur armiqtë u vërsulën me egërsi mbi fshatrat tona, Bilal Alipostivani me shumë shokë morën armët dhe luftuan për nderin, për vatanin, duke u bërë kështu tmerr për armiqtë.

Në vargun e fundit të çdo strofe Zyberi e ngrinte dhe e zgjaste më shumë zërin dhe, duke më ftuar edhe mua të veproja po ashtu, pa e ndërprerë melodinë, shtonte:

— Të lumtë, more Belul, të lumtëëëëë!

Jehona e këngës pushtonte gjithë pyllin.

— Ka nxjerrë burra trima dhe të mençur kjo tokë, — tha Zyberi me vështrim të tretur në majë-

malë. — Ku e kanë gjetur forcën, do të thuash ti! Te ky dhe në këto pyje, në këta shkëmbinj. Po mendojnë ku e kanë gjetur? Në vuajtjet e njerëzve, në ahët dhe ohet e fukarenjve. Gjithë jetën shqiptari ka thirrur: liri, bukë dhe dituri! Të parën ne e fituam, dy të tjerat po përpiqemi t'i sigurojmë. . . .

Ai ndaloi për një çast, por vështrimin s'e hiqte nga majëmalet.

— Eh, more Belul, eh, — vazhdoi. — Të erdhi radha ty t'i dëgjosh nga unë këto fjalë, nga Zyber analfabeti. Të huajtura nga të tjerët i kam edhe unë. Po i kam përsëritur aq shpesh me vete, sa që më dukën së i kam nxjerrë nga mendja ime. Për lirinë, unë këtë torbë, që s'e kisha mbushur ndonjë herë me bukë, e mbushja me fishekë. Ua merrja ballistëve dhe ua jepja partizanëve. Kurse sot, në vendin ku mbaja fishekët, mbaj libra. Ja, shikoje.

Hapi grykën e torbës dhe pashë që nxori andej një libër me vjersha.

Unë u çudita për faktin që s'e kisha vënë re më parë atë libër, kur mora darët. E dija që Zyberi ashtu vjedhurazi kishte mësuar shkrim e këndim, por që të lexonte edhe libra me vjersha s'e dija.

— Kur unë dua të mësoj, po ti? Po të mësosh, i mirë do të bëhesh, ndryshe viç do të mbetesh.

Përsëri ma nxori fjalën te shkolla. Me siguri ai edhe abetaren për atë qëllim e kishte marrë me vete, të më mbushte mendjen me anë të shembullit personal.

«Ehu, kujt donte t'ia hidhte! Rri, o Zyber, për kokën tënde, mos na fry, — thosha me vete. — Ti merr në torbë jo një libër, por njëmbëdhjetë po deshe, s'të ndalon njeri. Unë di të shkruaj një letër, të lexoj një gazetë, të bëj një llogari. . . A i dije ti

këto, kur ishe kaç sa unë?! Lërmë tani, mirë jam me lopë këtej pyjeve e pllajave, bëj ç'më do zemra...»

Në një rast tjetër do t'ia thosha të gjitha sa mendoja. Faji që kisha bërë pak më parë, më detyronte të heshtja. Për t'iu shmangur kundërshtimit, u bëra gati të ngrihesha, të largohesha më tej. Zyberi ia mori përsëri një kënge. Dhe unë e shoqërova. Ma njihte ai qejfin që kisha për këngë dhe më tërhiqte me anë të tyre, si fëmijën që e heqin për dore, kur mëson të hedhë hapat e para.

*
* *

Në ato kohë na dukej sikur udhëhiqeshim edhe nga këngët. Rinia e fshatit mblidhej për çdo mbrëmje te shkolla dhe kënga vinte gjym, «si në të shtatë puset», thoshte një shakaxhi. Këngët e reja i sillnin ata që vinin nga hekurudha, ku kishin shkuar vullnetarë. Herë pas here te shkolla shkonim edhe ne, dy lopçarët. Të rinjtë ngriheshin më këmbë dhe i lëshonin Zyberit një vend midis tyre. Dhe, po të ishin duke kënduar, sapo hynim ne, e ndërprisnin e, pasi rrinin pak, i thoshin Zyberit që t'ia mernte një herë pleqërishte. Atij i pëlqenin shumë edhe këngët e reja që sillnin «djemtë e hekurudhës», por vetë s'i këndonte dot, qe mësuar me melodinë e këngëve pleqërishte. S'priste t'i thoshin për herë të dytë. Kohët e fundit, me atë melodinë e këngëve të vjetra këndonte një këngë të re:

*Tregojnë pleqtë ca derte:
Jemi rritur me izjete,*

në bejlerë e në të keqe;
pa ua kthyer me dyfeqe,
i zumë si minjtë ndër leqe.
Rrofsh, Parti, ku na mbështete!
Te ylli me pesë cepe.
Punojmë e rrojmë për vete,
pa hatëre, pa ryshfete.

Sapo niste vargun e parë, më ftonte mua që ta shoqëroja. I shkoja pas me shumë qejf. Të tjerët përreth mbanin iso e kënga vërsulej me vrull nga dritaret e hapura, përhapej nëpër fshat e futej në çdo shtëpi, ku shkaktonte buzëqeshje.

Pastaj niste një valle të kënduar. Mihali ecte përpara, ne të tjerët shkonim pas tij, sipas ritmit të fjalëve:

*Bre, bre, bre, Balli Komdëtar,
ha, ha, ha, Balli Kombëtar.*

Në tekstin e këngës qëlloheshin edhe disa ish-ballistë nga fshati ynë. Dhe ndodhte që, ndërsa ne këndonim e kërcenim, ata zienin përbrenda nga inati. Ne i shim fitues të së drejtës sonë dhe kishim të drejtë të këndonim. Disa burra «të mençur», me Muhametin në krye, e thirrën njëherë mënjane Mihalin dhe i tërhoqën vëmendjen, se nuk ishte mirë të këndoheshin këngë të tilla të rënda mu në mes të fshatit. Kështu mbetej e gjallë ndjenja e përçarjes, thoshin ata. Ajo që kaloi, kaloi, ç'duhej më që të kujtohej?

— Kështu i kemi këngët ne, — thirri Mihali, — flakë e barut i kemi! Kush do që të futet në vallen tonë, i japim dorën. Po të ketë ndonjë që kërkon të

na e prishë vallen, e heqim zvarrë.

Ne që dëgjonim, ashtu siç ishim, me duart të shtrënguara në valle, u afruam pranë atyre që bisedonin. Atëherë burrat e «mençur» u tërhoqën duke thënë: «I riu si veriu».

Kjo këngë u fut në çdo qoshe e në çdo monopat. Xha Demoja, më plaku i fshatit, rreth të nëntëdhjetave, që fare pak shikonte nga sytë e mezi që dëgjonte nga veshët, tek numëronte tespihet, murmuriste:

*Bre, bre, bre, o ballista,
që ju vumë dhe kapistra!*

Mënyra se si i krijoi këto vargje ai plak, bëri që unë të mendoja se mjaft fjalë të asaj kënge mund të thuheshin më mirë, disa të tjera të plotësoshin.

Në atë këngë bëhej fjalë edhe për një farë Bido Qylahu, nga një fshat tjetër, kulak dhe armik i pushtetit tonë. Ai në moshën 50-vjeçare u martua me një vajzë të re nga fshati ynë.

Njëherë m'u kujtua diçka. Kisha vënë re se Bido Qylahu mbante këpucë me shollë. Të tilla këpucë dikur mbanin edhe disa nga ballistët. Gjithashtu mbaja mend që, kur erdhën ballistët për kontroll në shtëpinë tonë, se dyshonin që strehonim dy partizanë të plagosur, në oborrin me pllaka të gurta u rrëzuan e u bënë lëmsh. Sa u ngritën e u rregulluan ata (një pjesë të kohës e kaluan me të shara e të bërtitura), partizanët e plagosur u dërguan në shtëpinë e një xhaxhait tim, ku sapo kishte mbaruar kontrolli. Ballistët rrëshqitën, sepse mbi gurët e oborrit dikush kishte hedhur urov.

Mendova se edhe Bido Qylahu si ballistët ishte.

Shkova dhe e spërkata me urov rrugicën me kall-
drëm, ku do të kalonte Bido Qylahu. Pastaj u fshe-
ha prapa një muri. Ai ecte çakërcejf. Do të kishte
pirë shumë raki gjatë natës tek e vjehrra. Kalin e tër-
hiqte prej freri. Kur këpucët më shollë i rrëshqitën
e sa mezi mbahej për freri, unë fërkoja duart nga
kënaqësia. Më vete thosha: «Hë, plakush, s'është e
lehtë të marrësh nuse të re».

Inat kisha edhe ndaj kunatit të tij, Metolit. Si
pranonte ai t'ia jepte motrën një plaku?

Në fakt, edhe babanë e dëgjova një ditë, kur i
fliste Metolit:

— S'bëtë mirë që e fejuat Naxhijen me Bidon.
Ndryshim të madh kanë në moshë.

Metoli iu përgjigj me gjysmë zëri:

— Po ja, si t'ia bëj, s'ia prish dot miqësisë.

Ndërmjetës për atë krushqi kishte qenë Muha-
meti.

Bido Qylahun, Muhametin e Metolin unë i fusja
të tre në një kallëp. Vargjet që krijoi xha Demoja,
më nxitën të bëj një këngë për ta.

Bido Qylahut i thosha:

*Shite veten te të huajt,
siç shesin xhambazët kuajt.*

Për Metolin shkruaja:

*Të dinim miell, na dole krunde,
të heq i ligu për hundë.*

Dhe Muhametit:

*Mos të qarkulloftë gjaku,
që vajzë të re i dhe një plaku!*

Të nesërmen ia tregova Zyberit. Ai foli i entu-
ziazmuar:

— E ke qarë, Belul! Për kokën e Shahinit që e ke qarë! Kam thënë unë për ty që je i zoti. Por, që nuk do ta vazhdosh edhe më tej shkollën, e ke gabim. Do të digjesh pa shkollë, si bimët pa ujë.

E vuri re që s'e prita mirë punën e shkollës dhe, për të më zbutur, nisi këngën:

*Seç jam i sëmurë, në pikë të hallit,
merrmëni e shpjermëni në majë të malit,
të takoj komitët, se më dogji malli,
atje midis tyre të më dalë xhani.*

E dija që Zyberi ishte një thesar me këngë. Dhe ai e dinte që unë këtë thesar e lakmoja shumë. Kështu më zbuste dhe më tërhiqte pas vetes.

Edhe atëherë, pasi unë i kisha thyer dhëmballën lopës së Muhametit, po kështu veptoi. Më tërhoqi pas vetes me këngën e Bilal Alipostivanit.

■

Ndërtimi i shkollës së re në Fshesas u bë çështja kryesore e ditës. Me dy vëllezërit muratorë, Pandeliun e Gjergjin, u bashkuan edhe shokë të tjerë të zanatit të tyre nga fshatrat e krahinës. Grupe njerëzish shkonin përditë vullnetarisht, afronin gurë e nxirrnin lëndën e drurit. Shkuam me radhë edhe unë me Zyberin. Ai që mbetej me lopë, kujdesej për të gjitha.

Në fillim s'doja. Shkoi Zyberi i pari. U kthye pas pesë ditëve dhe më fluturoi mendjen me gjithçka që tregonte.

— E, more Belul, e, të shikosh sa njerëz mbli-

dhen. Plot çupa e djem, mesoburra e mesogra, pleq e plaka nga tërë krahina. Punojnë me aq vrull, sa, edhe ulok të jesh, do të ngrihesh e të punosh. Punojnë me norma e me gara. Në çdo pushim të vogël gjëmon vendi nga këngët e nga vallet. Hajde, more Belul, hajde. Mjerë ai që s'ka sy të shikojë këtë bukurri që bëhet.

Shkova që të nesërmen. Rrija i veçuar, duke afruar ndonjë gur, ashtu i humbur në grumbullin e madh të njerëzve. Turma ziente nga gjallëria, kurse mua s'më ngjitej. Ata vinin nga fshatrat e tjera dhe s'i njihja. Nga fshati ynë unë isha i fundit. Lëvizjet i bëja të ngathëta, i penduar që vajta. Po matësia t'ia mbathja për te lopët, kur më vuri re murator Pandeliu e më foli:

— Ooo, na paska ardhur Beluli i Malos, — u tha shokëve të tjerë, që punonin në ndërtim muri.

Më zgjati të dyja duart e tij të ashpra e të forta e më ngjiti në skelën ku qëndronte vetë. Më shtrëngoi fort pas gjoksit e më puthi në të dyja faqet.

— Po ku je, more lopçar i vogël, ku je? Nga punët e shumta s'kam pasur kohë të vija andej nga shtëpia dhe për ty më paska marrë malli. Malon e kam takuar gjithnjë dhe e kam pyetur. Ai më ka thënë se ti e paske për zemër të kujdesesh për lopët. Ashtu, ë? Po tani ja, po e bëjmë shkollën këtu dhe erdhi koha që t'u lësh shëndenë njëherë e mirë lopëve. Kështu, kështu. Ti, po të kesh qejf, kthehu përsëri te lopët, por jo lopçar i thjeshtë. Bëhu veteriner e kujdesu për lopët. Kështu, more Belul, kështu!

Nga gjithë ky vërshim fjalësh, në një çast, kur s'qeshë aspak i përgatitur dhe nga prania e njerëz-

ve të shumtë përreth, e ndieja veten krejtësisht të pazotin për t'i dhënë Pandeliut qoftë edhe një përgjigje çtarëdo.

— Dëgjo këtu, — vazhdoi ai, — këtyre shokëve u kam thënë se, po erdhi Beluli një ditë e të shikojë si punojmë ne që ndërtojmë shkollën e re, do të na e rrëmbejë zanatin nga dora. E kupton ti, apo jo? Kështu, more Belul, kështu! Po s'e bëre këtë që të them, mua më bën të ndihem ngushtë, dal gënjeshtar unë pastaj. Tani punojmë bashkë, afromi gurët, shikomë mua dhe përpiqu të vendosësh ndonjë gur në anën e brendshme. Hajde, se të mësoj unë.

Nisa të punoja me kujdes, i përqendruar. Pandeliu kryesonte ustallarët që ndërtonin shkollën. Ai pra, i pari i muratorëve, shfaqti besimin për të vendosur edhe unë gurë në murin e shkollës. Më bëri nder dhe nderi shpërblehet me punë. Nuk duhej shpërdoruar ky besim. Ta kuptonin shokët e Pandeliut se ai dinte kujt t'i besonte.

Muri ngrihej me shpejtësi. Unë vendosja ndonjë gur të vogël, i druajtur, i pasigurtë në punën që bëja. Pandeliu punonte shumë shpejt në anën e jashtme, përballë meje. Nga brenda më ndihmonin Gjergji dhe usta Miçoja.

Punova pesë ditë. Të gjashtën u ktheva përsëri te lopët, me shokun tim më të afërt, Zyberin. Ato pesë ditë më krijuan një vatër të re në mendje. Megjithatë e ndieja se freskia e pyjeve më tërhiqte më shumë. Në ato pesë ditë edhe isha lodhur, gjatë punës bëhesha me djersë, duart m'u vranë nga fërki mi pas gurëve. Për duart e vrara iu ankova edhe Zyberit.

— Dembel! — tha ai.

E shikovaçi çuditur. Me gjithë mend Zyberi ki-

shte pësuar ndryshim. Ndërsa prisja që të më për-
qafonte e të gëzohej, ai më priti buzëvarur.

— Kujtova se do të të pëlqente zanati e do të
qëndroje atje. Po s'dole gjë, o dembel me vulë! Di-
tën e parë e kishe nisur mbarë, pastaj... Epo do të
të vriten edhe duart, po çfarë...

— E di ç'ke ti, — ia prita, — i ndajmë më mirë
lopët, ti ato për të cilat të paguajnë, dhe unë pjesën
që më takon. Secili më vete...

Mendoja ta gjunjëzoja. E dija që nuk i pëlqente
Zyberit të më veçonte. Ai më donte. Dhe për këtë
arsye do të më bënte lëshim.

Por nuk ndodhi ashtu.

— Rri urtë, more spurdhjak! U bëre ti! S'do të
rrimë më dy vetë me lopë. Derisa e bën një njeri këtë
punë, ç'duhet dy? Prandaj e kemi vendosur fshaçe
që me lopët të rri unë. Ti ja, sa të fillojë shkolla
dhe atje e ke vendin. Deri në fund të muajit gusht
do të jemi bashkë, pastaj...

Pa ditur si t'i përgjigjesha dhe si të veproja më
tej, heshta. Ashtu në heshtje më hipi në kokë ze-
mërimi ndaj gjithë fshatit, që qenkësh kthyer kun-
dër meje, që donte të më ndiqte nga jeta prej lop-
çari, që më pëlqente e të më dërgonte në shkollë me
zor.

Të nesërmen në mëngjes, pa pyetur e pa bise-
duar me asnjëri, u paraqita te Pandeliu në ndërti-
min e shkollës së re.

Përsëri mbeta i çuditur e i pakënaqur. Edhe Pa-
ndeliu s'më priti mirë.

— Shkolla, Belul, shkolla, — tha. — Ajo është
kryesorja. Na duhen njerëz të zotë për punë, por
edhe të ditur na duhen. Njerëz me shkollë kemi pak.
Se, që ta dish ti, edhe mësimi është punë. Fute mi-

rë në mendje këtë. Je i ri, e ke jetën përpara. Do të të qëllojë të futesh në rrugë të panjohura. E në ato rrugë shkolla është në vend të syve. Sytë që ke, nuk shikojnë në ato rrugë, pa shkollë. Rrugët e reja duan katër palë sy.

Të gjithë kështu më flisnin. Edhe im atë, edhe Zyberi, edhe burrat e tjerë të fshatit.

— Ty të kujtohet fare mirë se sa kemi vuajtur ne për shkollë, — vazhdoi Pandeliu.

E kujtoja fare mirë. Ishte viti i parë pas çlirim-it. Kursi kundër analfabetizmit filloi në mars, gjashtë muaj përpara se të hapej shkolla fillore në fshat. Kursin e drejtonte Hekurani. Ai kishte bërë pesë klasë. Të tjerët, bashkë me ta edhe Pandeliu, s'dinin të shkruanin as emrin e tyre. Meqë s'kishte shkollë (atëherë Pandeliu me Gjergjin punonin për ndërtimin e saj), mbledheshin në shtëpinë tonë. Ishin të gjithë burra me fëmijë. Ditën punonin me kazmë ose me parmendë, pasdreke donin të mësonin shkrim e këndim.

Mua më pëlqente kur zhvillohej ora e mësim-it të aritmetikës. Asnjëri s'kuptonte nga rregullat e mbledhjes, të zbritjes, të shumëzimit e të pjesëtimit. Hekuranit i mungonte përvoja e mësuesit. Dhe, për ta pasur më lehtë, bënin lojën e kungulleshkës:

«Kisha një kungulleshkë që bënte pesë kunguj».

Burrat-nxënës zgjatnin një-rën dorë dhe numëronin të pesë gishtat.

— Po pesë kungulleshka me nga pesë kunguj secila, sa bëjnë?

Atëherë shikoja gjithë ato duar të ashpra, të argasura nga puna, që ngjisheshin pesë herë me radhë mbi dysHEME.

— Kështu, more Belul, kështu, — tha Pandeliu.
— Shkolla është kryesorja për ty që je i ri. Megjithatë, këto ditë, sa të mbarojmë shkollën, puno me ne.

*

*

*

Fshati im ndodhet një orë e gjysmë larg Fshesasit. Këtë rrugë e bëja dy herë ditën. Natën kthehesha edhe natën shkoja. Në shtëpi haja darkë e më vinte gjumë. Kur kullosja lopët, flija tri-katër orë hijeve.

— Rroftë puna, që ia mblodhi Belulit! — thoshin njerëzit. Këtë urim e para e bënte nëna ime. Kur shkoja me lopë, ngrihesha në mëngjes para saj dhe e lëshoja vëcin të pinte gjithë qumështin e lopës. Nënës i mbetej kusia bosh në duar. Këtë urim e bënin me gjithë shpirt edhe gratë e fshatit. Ato për çdo mëngjes detyroheshin të më ndiqnin gjysmë ore larg shtëpive, sepse e kisha bërë zakon të thërrisja vetëm një herë.

— Lëshoni lopët, oreeee!

Dhe ikja me të shpejtë, pa pritur t'i sillnin të gjitha.

— Epo puna të rregullon, — thoshin të tjerët.

Në këtë përfundim arrinte i pari im atë. Ai qysh në vogëli kërkonte që unë të isha një djalë i bindur, i urtë dhe i vëmendshëm për gjithçka. Por, sa kohë që isha me lopë, s'u bëra dot i tillë. Sa ndahesha me Zyberin në mbrëmje (ai shkonte në lagjen e sipërme, unë në të poshtmen), i lija lopët të futeshin nga u donte qejfi. Atij fshatari që i dhimbej gruri, misri ose bari i livadhit, le ta thurte tokën e tij me gardh ose me mure. Lopët, po të gjenin shteg, fute-

shin, kafshë ishin ato. Unë nuk do të kujdesesha edhe për çdo lopë në veçanti? Pagesën ma bënin që t'i kullosja në mal e t'ua ktheja shëndoshë...

Burrat e fshatit në përgjithësi u gëzuan që unë po vija në rrugë të mbarë. Dikush prej tyre më kishte qortuar rëndë, apo më kishte shkukur një çikë veshin dhe s'qe detyruar të merrte masa për t'u mbrojtur, sepse hidhesha menjëherë në sulm për të marrë hak. Borxh pa larë e hak pa marrë, s'lejoja. Prandaj ndryshimi i sjelljes sime bënte përshtypje në fshat.

Ndryshimin e ndieja edhe vetë.

Ja ç'ndodhi një ditë:

Njërit nga muratorët, Feritit, që punonte pranë meje, i shpëtoi guri nga dora, u rrokullis në skelë e u përplas në këmbën time.

— Oh, më fal, se të vrava padashur! — tha.

Mua s'm'u zbut zemërimi nga ndjesa që më kërkoi ai. Dhembja shlyhet me dhembje, mendova. Ashtu, gjithë inat, rrëmbeva po atë gur dhe ia hodha Feritit me gjithë forcën mbi këmbë.

Çekiçi dhe mistria i ranë nga duart. E mbajti veten. Po atë gur e ngriti përsëri në duar. Prita që të ma hidhte mua dhe u largova; ndërkohë mora një gur tjetër të vogël dhe rrija në gatishmëri për të qëlluar.

Feriti e vendosi gurin në mur.

— Nuk bëre mirë kështu. Tani vazhdo punën. Mendohu edhe se, po të zihemi ne të dy, shkolla bëhet dy ditë më vonë. Po të zihen edhe shokët e tjerë, shkolla mbetet pa u ndërtuar fare.

I turpëruar, e flaka gurin që mbaja në dorë. Opinga e Feritit, në këmbën ku e qëllova me gur, u lye me gjak. Unë s'isha gjakosur fare, kurse ai tha:

«Më fal». Po unë? Më rëndonte gjuha. Derisa u bëra aq, s'kërkova dot një herë ndjesë.

Pandeliu, i pasuar nga muratorë të tjerë, erdhi në çast nga pjesa e brendshme e murit. Më hodhi një vështrim qortues.

Aty për aty mallkova çastin kur vendosa të punoja atje. Për këtë ua hodha fajin Zyberit e Pandeliut. «Mirë shumë isha me lopët. Atje as më kishite ndodhur e as do të më ndodhte një gjë e tillë», mendova.

— Mos i bini më qafë. Ai s'ka faj, — tha Feriti.
— Beluli më lajmëroi që ta largoja këmbën. Unë u tregova i ngadalshëm.

A grisi një çopë nga këmisha, mbështolli këmbën, e futi në çorape dhe mbathi opingën.

— Po që nevoja, do ta mjekoj, — foli përsëri Feriti. — Veç shpërndahuni tani dhe mos e rëndoni me vështrime këtë djalë. Pa dashur vriten trima dhe jo më një plagë në këmbë.

Njerëzit u larguan ngadalë. Shikoja supet e varura e kokat e ulura të tyre, me sytë përtokë. E kuptoja: mbi ato supa rëndonte pesha e gurit që unë hodha mbi këmbën e Feritit. Duke goditur këmbën e Feritit, unë kisha goditur edhe supet e tyre. Në ato koka mplekseshin keq mendimi për fajin tim dhe mendimi për zemërgjerësinë e Feritit. Në ata sy ngatërroheshin pamja e këmbës së Feritit me pamjen e duarve të mia.

Pas kësaj ngjarjeje, gjithë kohën, deri në mbrëmje, sa folët ju që s'ishit atje, aq fola edhe unë. Isha thyer keq. Ndieja nevojë të ndodhesha pranë Zyberit, atje, në pyjet me ahe të mëdha. Ai do të më bërtiste:

— Çfarë bëre, more spurdhjak!

Pastaj, kur të vërente se do të më prishej qejfi, do t'ia merrte një kënge, unë do ta shoqëroja, dhe kështu kalohej lehtë. Ndërsa këtu asnjëri s'më shau, asnjëri s'më bërtiti. S'kisha ndaj kujt tjetër ta shpërtheja zemërimin dhe iu vërsula vetes. Nxitoja të afroja sa më shumë gurë pranë Pandeliut, Miços, Gjergjit, të praktikohesha edhe vetë në ndërtimin e pjesës së brendshme të murit. Të lodhesha, që të mund të harroja dëshpërimin, boshllëkun e krijuar.

Kam qenë një djalë i dobët nga trupi e me fytyrë të hollë si presë sëpate. Më binte rasti shpeshherë ta shihja fytyrën në pellgjet me ujë. Kur isha shtatë vjeç, nxitoja nëpër dëborë me opingat e qepura me tela. Thundrat e këmbëve, që më dilnin nga çorapet e grisura, më skuqeshin nga dëborat e duke-shin si patate të qëruara. Nxitoja nëpër dëborë, jo për të lozur, por që të çoja ato pesë dhi që kishim të kullosnin në gjembat e dëllinjave. Dushku që sillte babai im ngarkuar në kurriz (një gomar që kishim, s'çapitej dot në dimër), nuk mjaftonte.

Qerimi i Muhametit, i veshur me rroba shajaku e i mbathur me këpucë me qafa, dilte te bregu pranë shtëpisë së tij, ku mua më duhej të kaloja, e thërriste.

— Zbatharaku, rrjepacaku...

I lija dhinë e i sulesha Qerimit me topa dëborë (gurët ishin mbuluar e, t'i zbuloja, më mërddhinin duart). Ai vraponte e mbyllej brenda. Muhameti nxirrte kokën nga dritarja e bërtiste:

— Ik, more leckaman, se vij e të fryj në lak të këmbës.

Qëndroja këmbëngulës. Më kishin sharë, pa ua pasur borxh.

— Hajde, pa ta shikosh, — thosha dhe, pa u ndier, gërmoja në fund të dëborës, zbuloja gurët e filloja ta qëlloja. E urreja shumë atë burrë, që ishte më i ngjalluri dhe më i pasuri në fshat.

■

Muajit gusht i kishin mbetur edhe dhjetë ditë. I kishim përfunduar muret e ndërtesës së shkollës. Filluam të hedhim trarët e çatisë.

Fshatarët e kishin grumbulluar gjithë lëndën e drurit në sheshin para shkollës.

Cilido nga njerëzit e krahinës, po ta takoje në ato ditë, pyeste:

— A do të përfundojë shkolla deri më 1 shtator?

Fëmijët përgatiteshin. Blinin librat, fletoret, lapsat, penat, shishet e bojës. Gjithë kjo gjallëri më kujtonte vitin 1945, kur u hap për herë të parë shkolla fillore në fshatin tonë. Atëherë blinin dy vetë një abetare. Në vend të fletores përdornim nga një pllakë të zezë. Shkruanim në të dhe i fshinim përsëri ato që shkruanim. Bojën e përgatishim nga shpendrat. Duart i llangosnim deri në bërryla. Bashkë me bojën e shpendrave më kujtohet edhe një ndodhi në fillim të klasës së dytë.

Unë i humbisja gjithnjë tapat e shisheve të bojës. Këpusja një majë kallamishte misri dhe e fusja në grykën e shishes. Shishen zakonisht e mbaja në çantën me lesh dhie, të hedhur krahaqafë. Përtoja ta mbaja shishen në dorë, siç bënin të tjerët. Një ditë Hasani i Tahirit (me atë e kishim së bashku librin e këndimit) iu ankua mësues Muharremit që disa faqe ishin zhyer me bojë e nuk njihe-

shin shkronjat. Mësuesi më porositi të mos e fusja më kurrë shishen me bojë shpendre në çantë.

Të nesërmen shishen e bojës, të mbyllur me kallamishte misri, e futa në xhepin e djathtë të pantallonave. Sapo arrita në sheshin e shkollës, u futa në lojën me top. Për pak ra bilbili i mësuesit dhe u vumë në rresht. Hymë në klasë, u ulëm secili në vendin e caktuar. Mësuesi bëri kontrollin e zakonshëm të pastërtisë. Bektashin e Kamberin e qortoi, sepse s'kishte prerë thonjtë dhe e urdhëroi t'i priste në pushim. Me këtë rast na tërhoqi vëmendjen të gjithëve që t'i kushtonim më shumë kujdes pastërtisë, si një gjë të domosdoshme për shëndetin.

— Tani fillojmë mësimin, — tha. — Kush e ka mësuar vjershën e qukapikut?

Pjesa më e madhe ngritën dorën e djathtë. Unë u çova në këmbë. Atë vjershë e kisha mësuar «ujë» dhe dëshiroja shumë të përgjigjesha.

— Hajde, thuajse ti, Belul, — tha mësues Muharremi. Dola serbes. U ktheva në drejtim të shoqëve e fillova:

*Qukapik, o qukapik,
të kam vëlla e të kam mik,
mizat, krimbat..,*

— Mjaft, mjaft! — më ndërpreu mësuesi. — Po ti ç'je llangosur kështu?

Shishja e bojës prej shpendre që derdhur në xhep. Pantallonat ishin zhyer si mos më keq.

— Shpejt në shtëpi! — klithi i zemëruar mësuesi. — Shko lahu, vish një palë pantallona të tjera, pas-taj hajde të thuash vjershën. Shpejt, se na e bëre klasën pis!

Ika. Nëna më ndihmoi të lahësja e të pastrohesha, nuk la prapa as qortimin, sepse s'kishim roba që unë të ndërrohësja sa herë bëhësja pis. Më veshi një palë pantallona të vjetra të babait, që i lidha dy herë te mesi e te sqetullat. Në atë mënyrë më vinte turp të këhësja përsëri në shkollë. Mora një copë bukë me gjizë në dorë e shkova me Fadilin e Koçiu, që kulloste delet.

Ditën tjetër mësuesi më qortoi:

— Pse nuk veshë një palë pantallona të tjera të vije prapë në shkollë, siç të porosita!?

— Vetëm një palë pantallona kam, — iu përgjigja. — Nëna më tha se do të më blejnë të tjera, kur të shesin kaçkat.

Qëndrimi i mësuesit ndaj meje ndryshoi menjëherë.

— Mirë, ulu! Dhe mos u bëj më pis!

Shkuan edhe pesë vjet nga fillimi i klasë së parë. Dy beharë i kalova me Zyberin, duke kullotur lopët e fshatit.

*

*

*

Mësuesit qenë shpërndarë fshatrave e bënin regjistrimet. Mua s'më thanë të regjistrohësja. Dëgjoja se flitej se detyrimi shkollor kapte deri në 14 vjeç. Unë isha 15. Ky rregull m'u duk shumë i ëmbël. Kjo bashkohëj me dëshirën që shfaqja kur mbarova katër klasë e babai donte të më dërgonte në fshatin e një miku. Për çudi, ndieja keqardhje. Çeti gjashtë muaj më i vogël ishte nga unë dhe u

regjistrua. U regjistruan Sadiku, Bardhoshi, Mihali, Qemali, Zeneli...

Prej të gjithëve unë mbetsha i veçuar. Ata blinin librat, fletoret, i hapnin, i shfletonin e diskutonin gjithë gjallëri. I shikoja ashtu grupe-grupe. Një ndjenjë zilie më shqetësonte. Prapë s'e bëja veten. E mposhtja tundimin që provova për t'i hapur edhe unë ata libra, t'i shikoja titujt e mësimeve, ç'figura kishin brenda.

Atë ditë që nxënësit e ardhshëm të shkollës që ndërtonim ne, morën librat, unë mora rrogën e parë. Pandeliu m'i mbështolli lekët me një letër dhe më porositi t'i mbaja me kujdes. I futa në gji. Pasi lamë punën, shkova nga libraria e lokalitetit. Shikoja nga dritarja. Sa shumë libra! Kishte ikur ajo kohë kur dy vetë merrnin një abetare. Shikoja me radhë kapakët: Botanika, Historia, Gjeografia, Algjebra, Zoologjia... Historinë e gjeografinë i dija nga shkolla fillore. Ç'tregonin algjebra, zoologjia, s'e kuptoja. Për botanikën mendoja se bënte fjalë për formimin e botës.

Në librari hynin fëmijët e dilnin andej me libra në duar. Ndonjëri i thoshte shitësit se nuk i kishte lekët e do t'ia sillte pas ca ditësh. Ai shënonte diçka në një bllok. Pastaj i jepte librat.

Ata kishin qejf t'i merrnin librat që atë ditë.

Unë, që kisha lekë, vështroja nga dritarja. Po të doja unë, ehu, sa libra blija. Sa për dhjetë, për njëzet vetë libra blija. Por... derisa s'më kishin regjistruar... Po të dinte babai im se ç'mendoja atë çast, do të bënte çmos që të më shkruante emrin për të shkuar në shkollë. «Punë e madhe se është bërë 15 jec. — do të thoshte ai. — Shkolla i duhet njeriut për

gjithë jetën». Kështu edhe Zyberi, edhe Pandeliu... Por unë askujt s'i jepja të kuptonte se çfarë ndieja në ato caste.

Paratë e rrogës sime të parë vlenin sa për të blerë gjashtëdhjetë e pesë kilogram misër me çmim shtetëror, ose pesëdhjetë kilogram me çmim privat. Kështu pra, unë isha i zoti të punoja e të mbaja familjen me bukë. Nejse, tjetër punë që s'ndihej nevojë të harxhoheshin për misër ato para. Babanë tim e lavdëronin gjithnjë, sepse e dorëzonte lëmin e parë në ndërmarrjen e grumbullimit. Shiste edhe teprica drithi në tregun shtetëror.

Rrogën time të parë ia dorëzova tim eti. Ai më rrahu lehtë supet. Lekët nuk m'i mori.

— Të lumshin krähët, — tha. — Jepja sat ëme.

Nëna s'u përmbajt. Mallëngjimi i çastit bëri t'i shkëlqenin lotët në sy e nëpër faqe. Më pushtoi në gjoks e më shtrëngonte fort.

— T'u bëfshin duart flori, biri i nënës! Do të të blejmë një palë rroba që të vishesh mirë e në ditë të shënuara të dalësh si pëllumb.

Sa mirë i vajti ndër mend nënës sime. Tek ajo s'dukeshin më gjurmët e ëndrrës për misër, gjurmët e urisë.

Në fshatin tonë, veshja më e përdorur ka qenë ajo me rroba lesh dhie; rrallë ndonjëri mbante rroba leshi delesh. Babait tim vetëm një palë rroba shajaku pa arna i mbaja mend. Dhe ato i vishte vetëm kur shkonte mik në ndonjë dasmë. Përditë, që vi-

shte rrobat e përdorura me andra, ai thoshte:

— M'u bënë si samar këto të shkreta.

Kurse Zyberi, atë vitin e parë pas luftës, si në ditë të shënuara e të pashënuara vishte një palë pantallona që s'merreshin vesh prej çfarë cope kishin qenë në fillim. Një përzierje nga më të ngatërruarat: copa gune, mushamaje, kanavace, çitjanesh, parashute. Vetë Zyberi ndonjëherë thoshte:

— Më shumë penjë, sesa rroba kanë të shkretat poture.

Ashtu, të veshur keq, i mbaj mend gjithë ata burra, kur vinin në shtëpinë tonë e mësonin në kursin kundër analfabetizimit.

Më pas u ndje një farë ndryshimi.

Kostumet prej doku, për herë të parë në fshatin tonë, u përdorën kur u kthyen të rinjtë e parë, që kishin shkuar vullnetarë në hekurudhë. Ata gjithë ditën punonin me rrobat e zakonshme dhe në mbrëmje visheshin me rrobat e reja, që ua kishin falur në hekurudhë. Nuk uleshin pa druajtje, sipër mureve të rrënuara. Rrinin në këmbë, gjithë kujdes. Po t'u bëhej një njollë, e fshinin me kujdes të veçantë.

Kur u kthyen vullnetarët e parë nga hekurudha, ka qenë fillimi i vjeshtës, domethënë pragu i dasmave. Dhe në dasmën e parë të atij viti të gjithë burrat e fshatit u veshën me rroba doku. Vajzat dhe nusët e reja, nën shembullin e tri shoqeve që shkuan në hekurudhë me djemtë, i hoqën çitjanet e veshën fustane. Më të afërmit e djalit që martohej, kur vinin fshatarët pas darkave për urim, sipas zakonit këndonin:

*Trak e truk këmborët,
po vijnë dasmorët,
veshurë përbukuri,
secili kostum të ri.*

Me rrogën time të parë nëna do të më blinte një kostum prej stofi. Këtu synonin fjalët e saj «të dalësh si pëllumb».

Të veshur me kostum stofi për herë të parë unë pashë mësues Muharremin. Të gjithë ne, të vegjlit, kishim qejf t'i lëmonim ato rroba, por druheshim. Ai i mbante të hekurosura, të pastra, pa asnjë njollë. Edhe këpucët i mbante të lustruara xixë, me bojë të zezë.

Pas mësues Muharremit erdhi i veshur me kostum stofi Hekurani, që punonte në komitetin ekzekutiv të rrethit... Tre djem të fshatit, kur u martuan, u bënë dhëndurë me kostume stofi.

Mua po më takonte të vishesha me kostum stofi, s'do mend edhe me këpucë të zeza si të mësues Muharremit, pa u bërë akoma dhëndër. Epo kisha punuar. Ishin djersa ime ai kostum dhe ato këpucë që do të blija. Me rrogën e dytë e gjysmën e së tretës mendoja të blinim kostum për babanë, pastaj për nënën, për motrën, për vëllanë...

*
*
*

Sa mirë do të qe, po të rronin gjyshja e gjyshi. Ata jetuan vetëm dy vjet e pak pas Çlirimit (gjyshja edhe një muaj më shumë nga gjyshi). I kisha prindër të nënës. Jetonin me ne. Tre djem u qenë

vrarë nga njerëzit e qeverisë së Zogut. Për mua thoshin se u ngjaja shumë djemve të tyre. Mbjaj mend se në vogëli, pa filluar Lufta Nacionalçlirimtare, më mernte kush të mundte më shumë në prehër e më pyeste:

— A do të bëhesh edhe ti kaçak, si dajat, që t'u bluash nofullat bejlerëve, agallarëve e fajdexhinjve?

— Do të bëhem! — u përgjigjesha.

— Po i kujt je më shumë, kaçaku i vogël i gjyshit, apo i gjyshes?

— Kaçaku i vogël i gjyshit dhe i gjyshes, — përgjigjesha.

Të dy qeshnin të kënaqur.

Gjyshi im numëronte nga fisi i vet njëmbëdhjetë breza kaçakësh. Për çdo mbrëmje, gjatë kohës së luftës e kishte bërë zakon të zbulonte supin e djathtë e të më tregonte vendin gropë, të formuar nga rripi i dyfekut e më thoshte:

— Prapë unë andej i kam sytë, nga malet. Por ç'e do, gjunjët s'më dëgjojnë. S'janë të zotë të mbajnë 85 vjet mbi shpatulla e të marrin përpjetë gërxheve.

Gjyshja ishte 15 vjet më e vogël dhe mbahej më mirë. Vishte çitjane të gjera, që i quante tumane, ngjishte një rrip të trashë në mes, ku varte një qostek sahati si burrat, mbante edhe tespihe, si burrat.

Kur filluan të vinin partizanët e parë në shtëpinë tonë, gjyshi e gjyshja s'më thërrisnin më «kaçaku i vogël», por «partizani i vogël».

Sa mirë po të kishin jetuar akoma! Tani do të më quanin punëtor i gjyshit e i gjyshes, pa atë shtesën «i vogël» prapa. Kur të më shikonin të ve-

shur me kostum stofi, do të kënaqeshin shumë. Me rrogën time të muajve të ardhshëm do të blinim kostum edhe për gjyshin, edhe për gjyshen. Si të visheshim mirë, do të rregullonim shtëpinë, ashtu siç thoshin të deleguarit në mbledhjet e fshatit, t'i pajisnim dhomat me krevatë, dollapë për rroba, dollapë për ushqime, tavolina, karrige...

*
* *

Një pjesë e fshatarëve, sidomos në fillim, s'besonin se mund të dilnin të vërteta ato që thoshin të deleguarit. «Hane Shan, hane Bagdad». Ku kasabaja e fshatrat e fushës e ku krahina jonë, fshati ynë gjithë gurë e shkrepë». Ndonjëri tregohej edhe më i papërmbajtur: «Me llafe u ngopëm, duam bukë.» Zakonisht, ata që flisnin kështu në mbledhjet e fshatit, qëndronin andej nga rreshtat e fundit të bankave të shkollës. Ne, nxënësit, s'pranonim të uleshim në ato banka, i kishim cilësuar: «Vendi i të pakënaqurve». Në mbledhjet që bëheshin natën, atje uleshin Haliti me mustaqe të zeza, Ismet qimeverdhi, Lace shtataniku... E dinim që ata ishin tarafi i Muhametit. Ndërsa Muhameti vetë rrinte i ngrysur, vinte një rën pas tjetrës cigaret e trasha dhe dëgjonte në heshtje. Vetëm kur mbledhja arrinte në të përfunduar, e merrte fjalën dhe jepte disa mendime të «mençura».

— Fshati ynë do ndihmë... T'i bëjmë një lutje qeverisë që të na japë dorën... Ndryshe nuk ia dalim dot... Unë nuk e kam për vete, por për bashkëfsha-

tarët e mi... Më dhimben njerëzit mua, prandaj them kështu. Këta njerëz po rropaten e po copëtohen gjithë ditën në punë... E kjo qeveri është e popullit, po të na e dijë hallin, na ndihmon. Fajin na e kanë shokët e këshillit, që s'e tregojnë gjendjen siç është, po thonë gjithnjë «Jemi më mirë nga ç'ishim në të kaluarën». E ç'e mirë zeza është kjo e mira jonë... Duam ndihmë ne, ndihmë nga qeveria.

Mihali i Goles ishte ai që e ndërpriste i pari Muhametin. Ai para lufte kishte qenë hyzmeqar te Muhameti dhe e njihte mirë atë. Ja si i tha njëherë:

— Pse nuk e thua të vërtetën siç është? Thuaje hapur para fshatarëve, sa drithë ke akoma të fshehur, përveç atij që të gjetëm, kur bëmë kontrollin?

Kritikën e Mihalit ndaj Muhametit e mbështetën Pandeliu, Kristoja, babai im, shokët e rinisë...

Por kishte edhe nga ata, që fjalët e «menduarra» të Muhametit i bënë për vete. Dhe kështu mbledhja niste përsëri nga e para.

Unë shkoja vazhdimisht në ato mbledhje. Dhe, pasi ktheheshim në shtëpi, babai më fliste hapur:

— Na duhet luftë, Belul, punë e luftë, që të mundim fukarallëkun e trashëguar... Dhe ata duan të na shikojnë vetëm në fukarallëk. Unë flas me ty si me një shok të madh, se tani nuk je i vogël.

Në fshatin tonë kishin qenë disa lëndina, toka të papunuara. Ato lëndina shërbenin si kullotë për delet e Muhametit edhe të dy fshatarëve të tjerë që ishin në gjendje, Ismetit e Halilit. Të tjerët mbanin vetëm dhi, delet s'kishin me se t'i ushqenin. Dhe dhitë e kishin të ndaluar të kullosnin në ato lëndina. Fshatarët kishin bërë përpjekje që të vendosej një rregull për t'i kthyer lëndinat në tokë buke. Li-loja, kryeplaku i fshatit, nuk lejonte në asnjë mëny-

rë. S'kishte si ndodhte ndryshe, përderisa Liloja e Muhameti hanin në një çanak, siç thoshin fshatarët.

Babai im, qysh përpara se të vinte Italia, bleu një copë lëndinë nga Muhameti. Nuk kishte t'ia jepte gjithë paratë njëherësh dhe gjysmat e tyre duhej t'i shlyente me fajde. Ajo tokë kishte qenë moçalishte, e kështu Muhametit s'i vlente për të kullotur delet. Por babai i bëri tri kanale e pas kësaj në ish-moçalishte, bari bëhej për t'u kullotur dy herë në vit. Atë bar babai detyrohej t'ia jepte Muhametit, për të shlyer borxhin. Një vit vendosi ta punonte lëndinën, ta kthente në tokë buke. Muhameti s'e lejoi. Dhe im atë u tërhoq. PAGESA E ASAJ TOKE NUK QE SHLYER AKOMA.

Sapo u çlirua krahina jonë, im atë e punoi atë tokë, pa pyetur për Muhametin dhe për Lilo kryeplakun, që mbante anën e Muhametit.

Atë vit filluan edhe fshatarët e tjerë të punonin tokat e mbetura lëndinë deri atëherë. Për çudinë e të gjithëve, edhe Muhameti iu vu punës për të hapur toka të reja. S'e kishte parë njeri të përdorte kazmën për qilizëm. Dhe nuk zinte vetëm një vend të caktuar e ta përfundonte të gjithë, siç bënin shumica, por shkonte lëndinë më lëndinë, ngulte nga dhjetë-pesëmbëdhjetë kazma dhe s'vazhdonte më tej. Fshatarët e etur për tokë, pasi punonin vendin që kishin zënë më parë, me kazmë në krahë drejtoheshin për në vend tjetër. Kazma u mbetej pa ngulur në tokë. Lëndina që donin të punonin, ishte e filluar. Por fshati ishte më i mençur se Muhameti: mori një vendim, ku thuhej se nuk lejohej të zinte vend tjetër asnjeri, që nuk kishte përfunduar së punuari tokën e filluar më parë. Muhameti mbeti kokëvarur

dhe në vesh i ushtonin fjalët e xha Demos: «Harro, mushkë, Valarenë...»

...Babai im punonte një lëndinë, që ne e quajtmë «Ara e lumit», sepse ndodhej në anë të lumit nga shkolla, merrja një gavetë me fasule, ca bukë në një çantë me lesh dhie dhe vrapoja për tek im atë. «Ara e lumit» ishte afërsisht një orë larg shtëpisë, por unë ecja me të rendur dhe e bëja më shpejt. Im atë, sapo më shikonte nga larg, lante duart e zhyera me baltë në lumë. Ndërkaq unë arrija pranë tij e të dy uleshim të hanim drekën. S'mbaj mend asnjë rast, kur të na kishte tepruar qoftë edhe një copë bukë apo një lugë fasule gjatë atyre drekave. Kur afronte fundi i gavetës, babai e ngadalësonte lugën e tij. Edhe unë kështu bëja. Atëherë ai ndizte një cigare.

Në shtëpi ktheheshim vonë. Rruga ishte e përpjetë dhe ecnim ngadalë. Përpara shkonte gomari, ngarkuar me dru për zjarr, më prapa babai, i ngarkuar me krisje për kafshët, dhe në fund unë, me çantën bosh të hedhur krahaqafë...

...Kështu përlesheshim për të mposhtur fukarallëkun. Ata fshatarë, që në vitet e para pas Çlirimit sulleshin për në depot e shtetit me thasë në duar për të marrë ushqimin e garantuar e mezi prisnin të piqej elbi, këtë vit shkuan me karvan, të gjithë së bashku, për të dorëzuar planin e detyrimit të grurit, qysh në lëmenjtë e parë. Edhe Zyberi, që nuk kishte shirë asnjë lëmë dhe që s'kishte plan detyrimi për të dorëzuar grurë, u kërkoi disa fshatarëve nga pagesa që i takonte për kullotjen e lopëve dhe dorëzoi 50 kg grurë, në vend të misrit që kishte në plan.

— S'ndahet Zyberi nga fshati. Ne kemi qenë të

bashkuar në kohë të keqe e jo tani, — tha vetë ai një ditë.

Edhe Muhameti dërgoi Qerimin me dy mushka të ngarkuara me grurë bashkë me karvanin e gjithë fshatit. Atë mëngjes, rrugën për në Fshesas unë e bëra me shokë. Më vinte mirë, por ndieja edhe inat që ndodhej edhe Qerimi i Muhametit midis nesh. Sikur nuk e kishte vendin aty...

...Por në mbrëmje mora vesh se nëpunësi i Grumbullimit ia kishte kthyer Qerimit grurin që donte të dorëzonte. Ishte grurë i vjetër dhe i mbushur me egjër. Ndërsa gruri që dorëzuan fshatarët e tjerë, ishte i pastër, si flori.

Siç ka zemrën njeriu, ashtu e bën edhe punën.

*
* * *

Mendoja për të shkruar një vjershë. Kohë më parë më ishte dukur gjë e lehtë. E ndieja si një nevojë thurjen e vjershave. Qysh në vogëli më kishte hyrë në të gjithë qenien pamja përreth fshatit tim, pllajajat e kodrat të vendosura si nga një dorë mjeshtri të përsosur, shkëmbinjtë e gërxhet e thepisura, uji që lëshohej me vërtik e thërrmohej duke u shndërruar në mijëra copa shumëngjyrëshe në karaktet, dielli që lindte i bardhë nga mali i Radomit e perëndonte i kuq në majën e Kokojkës, zilet e dhive dhe këmborët e deleve, blegërimat e keçave e të qengjave, lehjet e qenve e sokëllimat e barinjve. Të gjitha këto më ngatërroheshin me gjendjen reale të fshatit, me pleqtë e kërrusur e fëmijët e zbathur, burrat e parruar e gratë kockë e lëkurë, me këngët me

melodi të zgjatura e bisedat me fjalë të shkurtuara, si të prera me sëpatë, ku si një hyjneshë e parritshme hynte e dilte fjala bukë. Dhe më vonë — krismat e dendura të pushkëve. Të gjitha këto më ngjanin me një vjershë pa fillim e pa fund, që zuri vend e nuk shqitej nga zemra ime.

Puna për ndërtimin e shkollës së re hapi një pamje tjetër, një botë të re e të madhe përpara syve të mi.

Ditët e para i numëroja një e nga një dhe u vija shenja gurëve që vendosja në murin e shkollës. Doja që të dukej puna ime, të njihej, të kisha edhe unë për se të mburresha: ja, këta gurë i kam vendosur vetë. Por shpejt vura re se gurët me shenja ishin shumë të paktë. Sa shumë punë bënin shokët e sa pak kryeja unë! Prandaj hoqa dorë nga shenjat. Kur shikoja murin që lartësohej, më dukej se edhe unë rritesha.

Isha rritur vërtet. Çamarokllëqet mbetën prapa. U bëra 15 vjeç djalë. Gjyshi im, në moshën 15-vjeçare, rrëmbeu pushkën e doli kaçak. Babai im, në moshën 15-vjeçare, punonte 20 orë në ditë, gërmonte tokën me kazmë, duke kryer kështu edhe punën e kaut që i mungonte, për të fituar bukën. Pandeliu, në moshën 15-vjeçare, mbante dy govata me llaç në krahë, një në supin e djathtë e tjetrën e mbannte në supin e majtë, i ngjiste nëpër shkallë e ua çonte ustallarëve që ndërtonin shtëpinë e një beu. Feriti, në moshën 15-vjeçare, doli partizan, për të zënë vendin e të vëllait, që iu vra në luftë me të huajt. Unë, në moshën 15-vjeçare, punoja për ndërtimin e një shkolle të re. Bile Pandeliu më caktoi të ndërtoja një oxhak.

Kënaqësia ime arriti kulmin, kur shokët e orga-

nizatës së rinisë më thirrën në mbledhje dhe më pranuan anëtar. Në atë mbledhje mora zotim të ndërtoja një bazament përmendoreje, që do t'ua kush-tonim dëshmorëve të fshatit tonë. Këtë punë e filluam qysh të nesërmen, bashkë me shoqet e shokët e organizatës.

Një ditë Pandeliu s'ndihej në humor. Ishim prapa me punimet. Dita e hapjes së shkollës po afrohej. Tre muratorë munguan nga tri-katër ditë. Për Haj-darin e Stefanin e dinim që kishin shkuar në shtëpi të bënin dushkun për bagëtitë gjatë dimrit.

— Eh, ky interesi i vogël! — shfrente Pandeliu...
— Se mos u prish dushku, ka kohë deri në tetor.

Sa për Seferin, njëri nga fshatarët e tij na tha se atij i qe sëmurur vajza e shkoi ta vizitonte te mjeku, në qendër të rrethit.

Seferi nuk erdhi as ditën e pestë në punë. Por shpejt e morëm vesh se ai ishte kthyer në shtëpi pa vajzën, që e kishte lënë te një mik në qytet. Pat ardhur që të merrte disa dokumente nga këshilli popullor i fshatit.

Tjetër shqetësim e vintë në lëvizje Seferin. Don-te t'i ngrinte moshën vajzës së tij, Menduhijes 13-vjeçare.

E njihja Menduhijen. Para dy ditësh, provimet e klasës së katërt i dhamë në qendrën e lokalitetit. Me nxënësit nga fshati i saj erdhi edhe Menduhija. Ishte një vajzë e dobët, me dy sy të zinj dhe flokë të zinj të lidhur gërshehta, tepër të gjatë për trupin e saj të pakët.

Në provimin e hartimit Menduhija mbaroi e fundit. Kur i shkonin anëtarët e komisionit pranë, e mbulonte letrën me gishtat e hollë. Gjatë dy orëve shkroi vetëm një faqe. Kryetari i komisionit e lexoi

sapo e mori në dorë dhe shënoi në fund të hartimit: Mrekulli.

Atë hartim na e lexuan të gjithëve.

Në provimet e tjera Menduhija nuk e mbajti shkëlqimin e fillimit. Kryetari i komisionit rrinte me të gjithë kohës.

Në fund të provimeve kryetari i komisionit shkoi bashkë me Menduhijen në shtëpinë e saj e bisedoi me të atin që ta dërgonin vajzën për të studiuar. I premtoi se do të bënte gjithçka, vetëm e vetëm që Menduhija të mos shkëputej nga shkolla.

Biseduan gjatë dhe vonë u shtrinë për të fjetur.

Të nesërmen në mëngjes Menduhija nuk ndodhej në shtëpi. I ati e kishte çuar natën te një mik, në një fshat të largët. Atë mëngjes mësuesi i vjetër mori vesh diçka fort të hidhur: vajza që ai donte ta dërgonte në shkollë, ishte fejuar fare e vogël, pa i mbushur të pesë vjetët.

Kjo ndodhi dihej në gjithë krahinën, por qe harruar. Ngjarje të tjera i kishin zënë vendin.

— Mbeturinat e së kaluarës, — thoshte Pandeliu, — i qepen njeriut si këpusha e nuk i shqiten.

Fjalën *mbeturinë* unë e kisha dëgjuar edhe më parë, kur prindërit më detyronin që me kafshatën e fundit të mblidhja thërrimet që bëja mbi sofër, ose kur haja ato që kishin mbetur nga darka. Këto i quanim atëherë *mbeturina*. Kurse Pandeliu quan *mbeturina* të këqijat që kanë mbetur nga e kaluara.

Kështu kuptoja se mbeturinat që kishte Seferi, e shtynin që Menduhijen ta fejonte pa mbushur pesë vjeç, mbeturinat e shtynin Seferin t'ia rriste moshën së bijës e ta martonte, që të mos e dërgonte në shkollë. Në atë shkollë, që ne po lodheshim aq shu-

më për ta ndërtuar. Sipas Pandeliut, që të përpiqesh për të ndaluar fëmijët nga shkolla, do të thosh-te që të mos përfillje gjakun e atyre që kishin rënë për liri e dituri, mundin e bujqve që haheshin me tokën për të shtuar bukën, djersën e punëtorëve që ndërtonin shkolla.

Sikur edhe unë fillova ta ndieja veten të mbushur me mbeturina. Babai donte të më dërgonte në shkollë, unë s'pranoja. Zyberi më nxiste të mësoja, unë i zemërohesha. Pandeliu më tregonte rrugën e re të jetës, rrugën e shkollës, unë ktheja kokën mënjanë...

Unë atëherë s'kuptoja mirë, pse Pandeliu, megjithëse më fliste për shkollën, më pranoi në punë. Por çfarë vlerësonte më shumë ai, punën apo shkollën? Një gjë po ndieja në shpirt, që, kur punoja me Pandeliun e shokët e tij në ndërtimin e shkollës, m'u ngjall e m'u rrënjos dëshira për të vazhduar shkollën.

Koka m'u mbush me fjali pyetëse dhe me përgjigjen e lëkundshme: «Ndoshta». Sidoqoftë isha shkëputur njëherë e mirë nga jeta e bariut të lopëve private. Kisha hyrë në «armatën e duarve të hekurta», siç shprehej Pandeliu, në gjirin e punëtorëve.

Ditën e tridhjet e një gushtit e nisëm punën që me natë. Një ditë përpara përfunduam së mbërthyeri lëndën e drurit dhe mbetej vetëm mbulesa. Tjegullat që na dërguan, s'mjaftonin për gjithë çatinë e shkollës. Pjesën që mbetej do ta mbulonim me rrasa guri. Me të tilla rrasa ishin mbuluar çatitë e shtë-

pive, shkollat fillore dhe ndërtesa e këshillit popullor të lokalitetit. Shkollën e re donim ta bënim me «kapelë të kuqe», të hijeshonte qysh së largu. S'patëm mundësi. Një javë përpara u vunë dy vetë të nxirrnin rrasa guri. Pandeliu bëri llogaritjet dhe tha se mbulesa e çatisë kërkonte tri ditë punë.

— Por ne kemi vetëm një ditë në dispozicion, — tha. — Nesër këtu do të buçasin zërat e fëmijëve.

Atë ditë gjashtorëshi na kaloi shumë shpejt. Mbulesa e çatisë nuk kishte vajtur as deri në gjysmë.

— Nuk e lë punën, — i thashë Pandeliut. — Dua ta shikoj shkollën të mbaruar.

— Mirë, — tha ai. — Sot të gjithë do ta thyejmë orarin.

Kur perëndoi dielli edhe nga maja e malit të Gramozit, u mbaruan tjegullat. Vendosëm shtatë fenerë në çati dhe vazhduam mbulimin me rrasa guri.

Në shtëpitë e fshatit nuk u fikën dritat. Fshatarët vinin grupe-grupe, ndihmonin për të ngjitur rrasat. Dritat e fenerëve s'kishin aq forcë, sa të ndriçonin vendin përreth. Shumë vetëve u dëgjonim vetëm zërin. Bisedat vërtiteshin rreth ngjarjeve të ndryshme, por në çdo fjalë nënkuptohej shqetësimi: «Do të jetë gati shkolla deri në mëngjes?» Më shumë nga të gjithë, katër mësuesit e shkollës së re s'e fshihnin dot shqetësimin. Pasi përfunduan regjistrimet, ata çdo ditë punonin me ne.

— Ju lumshin krahët, se e mbaruat, — dëgjohej gati për çdo dhjetë minuta zëri i mësuese Marianthit, drejtoreshës së shkollës.

Usta Miçoja qysh gjatë ditës kishte thënë se nuk do të mjaftonin rrasat e gurit për mbulesë. Me ato

rrasa që kishin mbetur çatia nuk mund të mbulohej.

— Po halli? — tha usta Miçoja. — Si do t'ia bëjmë tani?

Usta Miçoja vendosi rrasat e fundit. Pllakosi heshtja. Shikonim yjet e panumërta në qiell.

— Sikur të bëheshin rrasa ato yje, — tha njëri nga fshatarët.

— Nga qielli s'bie asgjë, — tha një tjetër, që sapo erdhi. — Edhe gurët në tokë i kemi.

— Ashtu, o Skënder, ashtu, po ç'e do se edhe rrasat na mungojnë tani për në çati, — foli përsëri fshatari që dëshironte të bëheshin yjet e qiellit rrasa guri.

— Tjetër të keqe mos paçim, o Daut. Unë kujtova se mos ndodhi ndonjë e papëlqyer. Po bëhesha gati të shkoja në mulli, kur papritur zhurma e gjallëria që vinte këtej, u pre. Të vete të shikoj njëherë, thashë me vete. Helbete, matë është... Larg qoftë, mos u rrëzua ndonjë... Po sa për rrasat... vetëm mjekra e qoses nuk rregullohet. I kam unë ca rrasa mënjanë. I mbaja për të mbuluar kasollen e bagëtive. Hajde edhe ti, Daut, më ndihmo t'i sjellim.

Skënderi dhe Dauti u larguan nëpër errësirë.

— Do ta mbulojmë sonte shkollën, — foli Pandeliu.

— Tani e di edhe unë, — tha usta Miçoja. — Do ta mbulojmë që ç'ke me të, përderisa gjithë njerëzit mendojnë për këtë çështje.

Kënduan gjelat e dytë. Një erë e freskët vinte që nga gryka e malit. Ndjeva të ftohtë. Po të kishim pasur material për mbulesën e çatisë, do ta kishim mbaruar, ose do të ishim duke e përfunduar. Ashtu nuk do të mërdhija. Prisnim të vinin Skënderi dhe

Dauti. Andej nga shtëpia e tyre dëgjoheshin copa bisedash me zë të lartë, zëra që herë ngriheshin e herë uleshin.

Mendoja për Skënderin. Ai bëhej vetë i dymbëdhjeti në shtëpi. Kishte edhe fëmijët e të shoqen e vëllait të vrarë nga gjermanët gjatë luftës. Punonte shumë dhe, sa kthehej nga arat, vinte të ndihmonte për ndërtimin e shkollës.

— Të hedh edhe unë ca gurë, se edhe fitim do të kemi më shumë nga të tjerët, — thoshte. — Të kështër fëmijët e mi dhe pesë të vëllait do mësojnë në këtë shkollë.

Skënderin unë e kisha njohur gjatë luftës.

Në shtëpinë tonë strehoheshin dy partizanë të plagosur. S'kishin gjetur mundësi për t'i çuar në spitalin partizan. Mjekimin e tyre e kryente gjyshja ime. Asaj i vinte shumë ndoresh përdorimi i barnave mjekësore popullore. E kishte ushtruar me kaçakët këtë profesion.

Por ndodheshim ngushtë për ushqime. Sa herë shtroheshim për të ngrënë, secili, edhe ne të vëgjelit, u linim gjysmën e bukës partizanëve të plagosur.

Edhe partizanët linin gjysmën e ushqimit që u vinte përpara nëna ime.

— Jepua fëmijëve, — thoshin. — Ne u ngopëm.

Një natë më vonë erdhi një udhëtar me dy kafshë të ngarkuara me miell misri. Ne flinim, por, nga zhurma e potkonjve në pllakat e gurta të oborrin, u zgjuam. Babai nuk ishte në shtëpi dhe derën e hapi gjyshi.

Udhëtari tha se ishte një shok i tim eti. Kishte qenë në mulli dhe, meqë e zuri nata në rrugë, u kthye për të fjetur.

Gjyshi e pyeti për emrin.

— Skënder Mëlleza, — u përgjigj udhëtari.

— Hajde, bujrum! Na ka folur Maloja për ty.

Në mëngjes ai iku pa u bërë akoma ditë. Katër thasët me miell misri i la në shtëpinë tonë.

— Janë për partizanët e plagosur, — tha. — E mblodhën fshatarët e mi nga dy e nga tri qillo secili dhe më dërguan t'i sjell.

Qysh atëherë m'u fiksua ndër sy fytyra e tij me rrudha të thella dhe m'u ngulitën në veshë fjalët, që i përsëriste shpesh gjatë bisedës me gjyshin:

«Me vuajtje, por do ta fitojmë!»

... Nga maja e malit doli Ylli i Karvanit. Kur del ky yll, ka dhe dy-tri orë natë. Në sheshin para shkollës ndezëm një zjarr dhe u mblodhëm përreth.

Nga rrugica me kalldrëm u dëgjua zhurma e thundrave të kafshëve, që vinin të ngarkuara me rrasa guri. E lamë të gjithë zjarrin dhe u dolëm përpara. Usta Miçoja, që ishte në krye, numëronte:

— Një, dy... pesë... njëmbëdhjetë mushka të mbuluara deri te koka me rrasa guri. Të lumtë, ore Skënder Mëlleza, se e bërë fora!

— Për vete i kemi, — tha Skënderi.

Pas tij vinin të tjerë, pas çdo mushke një njeri.

I shkarkuam shpejt e shpejt dhe rinisëm punën për ambulimin e pjesës së mbetur të çatisë.

Mësuese Marianthi nisi këngën:

*Punojmë natë e ditë,
pa u lodhur fare,
se në zemër kemi
ndjenjën proletare.*

Nga oxhakët e shtëpive nisën të dilnin grumbuj shkëndijash, si të ishin fishekzjarrë për festën

e fillimit të vitit të ri shkollor. Gjëmimi i tundësve të bulmetit të jepte përshtypjen e një orkestre të vjetër, që atë mëngjes ekzekutonte melodi me nota të reja.

Kur usta Miçoja vendosi rrasën e fundit mbi çatia, në majën e malit të Nemërçkës flakëritën rrezet e diellit.

Zbritëm të gjithë nga çatia. Shikonim shkollën e re. Në majë të çatisë kuqonin tjegullat. Pjesa e mbuluar me rrasa guri ngjante me një fustanellë me kinda prej rrobe të vjetër, përgatitur me kujdes nga një dorë mjeshtri.

Rrugët e fshatit u gjallëruan më tepër nga zërat gazmorë të fëmijëve, nga zilet e këmborët e bagëti-ve.

Për një çast vështrimi ynë u gozhdua mbi një grumbull shtëpish të fshatit. Shtëpia e Skënderit, Dautit dhe disa të tjerëve pranë ishin zbuluar deri në gjysmë metri mbi strehë.

— Për vete, për vete e bëjmë, — tha Skënderi. — Tani kohë e mirë është, i nxjerrim shpejt aq rrasa sa duhen dhe i mbulojmë.

Erdhën të rinjtë e të rejat e Fshesasit për të pastruar klasat e për të vendosur bankat.

■ Sheshi para shkollës u mbush me njerëz. Mësuese Marianthi nxitoi të bisedonte me kryetarin e këshillit popullor të lokalitetit se si të vepronte. S'qe përgatitur të mbante fjalim para fshatarëve, prindërve të nxënësve. Ata asnjëri s'i kishte lajmëruar, por erdhën vetë, grupe-grupe, të mëdhenj e të vegjël bashkë, sipas fshatrave.

Kryetari i këshillit popullor të lokalitetit u mendua për një çast, pastaj tha:

— As unë nuk di ç'të them. Duhet ta kishim planifikuar një festë me rastin e hapjes së shkollës së parë shtatëvjeçare në krahinë. Fshatarët mezi e kanë pritur këtë ditë. Ne, të dhënë pas punës, e humbëm toruan në këtë pikë. Por populli vetë na mëson. I themi Pandeliut të flasë. Ai ka punuar më shumë nga të gjithë për këtë shkollë.

Pandeliu hipi mbi skelën e jashtme akoma të pahequr.

— Fëmijët që do të ulen sot në bankat e kësaj shkolle, të dalin përpara, — tha.

Ata u afruan dhe u vunë në rresht. Djemtë i kishin hedhur çantat krahaqafë, vajzat i mbanin ato në duar.

Më shpërtheu një dëshirë e papërmbajtur që të futesha edhe unë midis tyre, bile të dilja në rreshtin e parë. A nuk isha unë, që për atë shkollë kisha punuar më shumë se cilido prej atyre picirukëve që kapardiseshin e lëpinin buzët me mburrje? Mirë që s'më kapte detyrimi shkollor. S'doja të më detyronin. Një muaj e ca më parë ishte e nevojshme kjo masë ndaj meje. Ndërsa tani...

Po puna? Unë qeshë rritur. Duart e mia u mësuuan të vendosnin gurë e tjegulla në atë shkollë... Po do ta bisedoja njëherë me mësuese Marianthin. Ajo më buzëqeshte gjithnjë gjatë punës dhe s'do të ma prishte.

...Pandeliu mendohej të gjente fjalët që do të thoshte. Më në fund iu drejtua fëmijëve:

— Këtë shkollë e ndërtuam për ju. E gëzofshi dhe na nderofshi!

Deshi të shtonte edhe diçka tjetër. Dy lotë ndër

sy ia ndërprejnë fjalët. U hodh nga skela dhe nisi t'i përqafohte e t'i puthte me radhë nxënësit e parë të shkollës shtatëvjeçare.

Në slesh u prish qetësia. Njerëzit përqafoheshin, secili me atë që kishte më pranë.

Nxënësit u ndanë në tri klasa paralele dhe filluan mësimin. Në orën e parë morën pjesë edhe prindërit. Rrinin në këmbë, të mbështetur pas mureve.

Nuk isha vetëm unë që dëshiroja të ulesha në bankat e shkollës. Gjithë ata burra me mustaqe e gra me flokë të bardhë, që ishin tre-a katërfishi i moshës që kapte detyrimi shkollor, dukej se s'donin të malinin radhën mua, që isha vetëm 15 vjeç.

Seferi nuk kishte ardhur. Ai as në punë nuk erdhi ditët e fundit. Pandeliu ndërhyri në gjykatën e rrethit, u tha të vërtetën, përse Seferi donte të ngrinte moshën e së bijës. Dhe ashtu, i zemëruar ndaj Pandeliut, ai s'pranoi të punonte më për ndërtimin e shkollës.

Menduhija, e pakët nga trupi dhe e dobët në fytyrë, rrinte në bankën e parë të rreshtit të mesit. Ndërsa shokët e shoqet e klasës këmbenin vështrime e buzëqeshje me prindërit e tyre, ajo shikonte vetëm në dërrasën e zezë. Pamja e saj më rriste inatin ndaj mbeturinave.

*

*

*

Mësuesit e shkollës shtatëvjeçare morën përsipër të zhvillonin mësim edhe në mbrëmje me ata që do të ndiqnin shkollën pa shkëputje nga puna.

.Sapo dëgjova që do të hapej shkolla e natës, nxitova të regjistroheshja i pari. Kështu kisha pse të krenoheshja. Emri im nuk do të shënohej në fund të listës së nxënësve të vegjël, por në krye të të rriturve. Por... ma kishin zënë radhën. Pandeliu, Gjergji, Fatmiri dhe ušta Miçoja qenë regjistruar përpara meje. Çfarë etje për të mësuar kishin këta njerëz! Ashtu, pas pune, mësonin shkrim e këndim. Pas pune mësuan e mbaruan shkollën fillore. Pas pune edhe për në shkollën shtatëvjeçare. Shumë mirë që edhe emri im do të rreshtohet pas tyre.

...Për mua ishte fillimi i ngjitjes nëpër skela.

1975

UNË, HABIBI DHE BRIGADIERI

Ishte rrokullisur kapaku e kishte gjetur tenxheren. Ja si ishim puqur me njëri-tjetrin unë dhe Habibi. Megjithëse ai ishte nga Veriu dhe unë nga Jugu, kush na shikonte së bashku, mendonte se ishim rritur bashkë e nuk ishim ndarë ndonjëherë nga njëri-tjetri. . . Po të afroheshe pranë objektit që po ndërtonim, do të kujtoje se aty bëheshin prova për ndonjë festival folklorik; gjithë ditën kënga vinte gjym! Zakonisht mëngjeseve unë e Habibi ia fillonim me ndonjë këngë nga Shqipëria e Mesme, pastaj hidheshim në këngët e Veriut. Ai i këndonte, kurse unë ia bëja dingërdang me gojë (imitoja çiftelinë); ndërsa aty nga mesdita uleshim këmbëkryq mbi skelë dhe ia merrnim labçes, sa oshëtinte dhoma ku suvatonim! Aq na rrëmbente kënga, sa harronim se ndodheshim në skelë, me mistri në dorë, e na dukej vetja se po jepnim shfaqje për publikun mbi ndonjë podium!...

Kur vinte brigadieri e na gjente ashtu, ulur këmbëkryq, duke kënduar për shtatë palë qejfe, na fliste në fillim me të urtë, pastaj çirrej e bërtiste me sa kishte në kokë. Po ne i aktivizonim më shumë

gurmazet, sa ai tërhiqej, hëpërhë i thyer, nga fusha e betejës! Po kjo thyerje ishte e përkohshme për të, sepse bëri ç'bëri dhe na ndau më në fund nga njëri-tjetri, na veçoi në skuadra të ndryshme. Na erdhi plasja, po s'kishim ç'bënim; nuk i dilej dot brigadierit, aq më tepër që kishte edhe pak të drejtë: ne nuk e shfrytëzonim sa duhet kohën e punës. Por këtë nuk më pëlqente ta pranoja.

Të them të drejtën, u mërzita që më ndanë nga Habibi, prandaj më erdhi mirë, kur një ditë, një nga punëtorët e brigadës, Seit Qyreçi, më hoqi mënjanë dhe më tha me zë të ulët: «Kemi ndër mend që ta heqim brigadierin.»

— Po pse?
— E para, — më përgjigjet Seit, — ai nuk e shfrytëzon kohën e punës, por sillet vërdallë sa në një skuadër në tjetrën.

«Një në dorë», thashë me vete, se më pëlqeu ky argument.

— E dyta, — vazhdoi Seit, — i mungon aftësia për të organizuar punën.

«Paska kápur pikat kyçe», thashë me vete dhe bëra shenjë aprovimi me kokë.

— Dhe e treta, — vijoi Seit Qyreçi, — është arrogant dhe i pasjellshëm me anëtarët e brigadës.

«I ka rënë më të!», mendova dhe kujtova se ç'na kishte punuar brigadieri mua dhe të shkretit Habib, që na ndau për së gjalli nga njëri-tjetri.

Tanimë për mua ishte çdo gjë e qartë si drita e diellit: këto tri arsye mjaftonin që brigadieri të hiqej e të mos na krekosej më si ai gjeli majë plehut! .. Ishte qerrata i madh ky Seit Qyreçi! Ç'vinte e i pillte mendja! .. Mirëpo flitej se Seitin e kishin përzënë nga brigada ku kishte qenë më parë, sepse na fa-

skësh qenë grindavec i madh, llafazan e intrigant. Kështu flitej për Seitin, po mua sikur nuk më besohet. Seiti sillej mirë dhe të gjithëve na rrinte me dorë në qafë. . .

Kështu, vazhdimisht unë mendoja për ato që më kishte thënë Seiti: shfrytëzimi i tetorëshit, organizimi i punës, sjellja me punëtorët. . . A ka brigadieri ynë të meta të tilla? Vrava mendjen, po, të them të drejtën, sikur s'po bindesha se qe ashtu. «Ndoshta i kanë vënë re të tjerët këto të meta të brigadierit tonë», thashë me vete, sepse ma kishte pak qejfi që ta zinin mat. Ah, more brigadier, paç veten në qafë! Të paktën të mos më kishe veçuar nga Habibi! . . .

— Hë, ç'thua! — më shkundi nga mendimet Seiti, duke më shkelur syrin.

— Kam frikë se nuk do të na ndezë! — i thashë.

— Ç'ke ti! — ma priti ai, duke i rënë gjoksit me grusht. — E rregulloj unë këtë punë, ti vetëm të na japësh votën. Kam biseduar edhe me të tjerë për këtë çështje.

— Po Habibi ç'thotë?

— Edhe ai dakord është, vetëm se pret fjalën tënde.

Epo, s'kisha pse ta zgjatja më tej. Edhe po të mos doja unë, kjo punë, sipas fjalëve të Seitit, pas-kësh marrë fund. Vetëm për një gjë më hante meraku dhe ia thashë Seitit:

— Po për brigadier, kë keni menduar?

Sytë e tij bojë hiri sikur u veshën me një lëng të ngjashëm me rrëshirën e pishës. Ai buzëqeshi, duke përveshur buzën e poshtme, sa iu dukën një sërë dhëmbësh të florinjte. «Këtij i hëngërka vetë qafa

për këmborë dashi!», thashë me vete. Ndërkaq Seiti më vuri dorën në sup dhe më pëshpëriti me ëmbëlsi: «Shokët e kanë syrin te ti. Po shiko, mos i thuaj njeriu tani për tani...»

— Je në vete! — thashë i habitur. — Jo, mor vëlla, nuk e mbajnë dot krahët e mi atë kungull!

— Kështu të duket ty, po shokët kanë të drejtë. Edhe unë mendoj se ti je i vetmi njeri, te ne, i përshtatshëm për brigadier.

Kaq tha dhe iku, duke më lënë të shtangur nga habia. Fjalët e Seitit dalngadalë erdhën e m'u ëmbëlsuan, sa shprehja «shokët e kanë syrin te ti» nuk m'u hoq nga mendja gjatë gjithë mëngjesit.

Në pushimin e drekës u takova me Habibin. Ai ishte shend e verë. «Sigurisht gëzohet që do të më zgjedhin mua brigadier», mendova i kënaqur. Më shkoj mendja që Seiti, duke e ditur që unë dhe Habib jemi shokë të ngushtë, do t'ia kishte dhënë lajmin edhe atij. Prandaj tani prisja me zemër të gufuar nga kënaqësia urimet e Habibit. Po ku unë e ku ai!

— Tani do t'ia themi këngës, sa të na lodhet gurmazi! — ma priti ai.

— Jo, more! — thashë i gëzuar. — Mos e rregullove me brigadierin, që të na bashkojë prapë?

— Çne, ore! Më tha kryetari i komiteti profesional, që te ne u ngrit grupi artistik.

— Mirë që e ngritën më në fund, — i thashë. — Po brigadierit, ama, ia kam vëth në vesh për atë që na bëri... Ke biseduar gjë me Seitin?

— Ohu, ç'e dëgjon dhe ti atë! — ma ktheu Habibin. — Nuk është gjë ajo mesele!

Më erdhi inat me Habibin. Ai s'kishte besim se mua mund të më zgjidhnin brigadier. Sa me qejf e

kisha kapur këtë çështje, kurse ai në çast ma përmbysi.

— Po pse, mor vëlla, — i thashë, — mua Seiti ma bëri të mbaruar!?

— E, mirë, mirë, ashtu të mbaruar ma bëri ai edhe mua, po e mendova punën mirë dhe, të them të drejtën, ato që thotë Seiti për brigadierin janë pesë me hiç, janë qiqra në hell. Të rrimë shtrembër e të flasim drejt: brigadieri nuk na ka ndonjë faj, apo jo? — më foli ai.

— E, e, ashtu është, po sikur na e ka prishur një çikë qejfin që na ndau. . .

— Mor, lëre atë. Ato që thotë Seiti për brigadierin mua më duket se s'janë gjë. Nuk i ka brigadieri ynë ato të meta. . . Si thua ti?

— Ashtu më duket edhe mua, — i thashë pa qejf. — Po më duket se shokët e kanë gjetiu syrin për brigadier. — Më erdhi zor të përmendja emrin tim, të përsëritja ato që më tha Seiti.

— Qiqra në hell! — foli përsëri Habibi. — Shokët e paskan syrin tek unë, kështu më tha Seiti. Po unë nuk do të pranoj që të heqin brigadierin.

— Po Seiti më tha edhe mua që shokët e kanë syrin tek unë, — thashë i rrëmbyer. — Kështu të paska thënë edhe ty?!

— Ja, se ç'na qenka, — tha Habibi. — Tani po e kuptoj mirë se ku e paska hallin Seit Qyreçi. . . Po ti e kupton?

— Oj, të kuptuar! — u përgjigja i inatosur dhe thashë: — Sikur ta kisha atë çast Seitin pranë, do ta kapja për fyti! Hajt, pa ka për ta parë ai! . . .

Nuk thonë kot: po dëgjove daullen, dasmën e ke prapa. Kështu, pas gjithë këtyre që ndodhën, brigadierit tonë na i vënë një goxha fletërrufe, që zinte

tre çerekë të tabelës së madhe, të vendosur për këtë punë. E ç'nuk thuhej në atë fletërrufe! Brigadier i ynë cilësohej si burokrat, mendjemadh, arrogant, dembel e të tjera, e të tjera. Në fund ishte shënuar me shkronja të mëdha: Seit Qyreçi.

Nuk vonoi shumë dhe në tabelë pamë një fletërrufë tjetër. Atë e shkruante Liria, një suvatore. Kur e lexoi Seiti atë fletërrufë, i kërcyen sytë si koka dardhe. Liria e mbërthente me shpatulla për muri. Ajo e quante intrigant e gënjeshtar. Madje i përmendte edhe origjinën, shkak ky për konceptet e tij të gabuara borgjeze. Seiti rridhte nga një famlje tregtarësh.

Mbledhja e brigadës për shqyrtimin e fletërrufëve u bë të nesërmen. Për çudinë time, Seiti dukej i qeshur, sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Sigurisht shpresonte në ndihmën tonë. «Shokët e kanë syrin te ti», më pëshpëriti në vesh, kurse Habibi i shkeli syrin me buzë në gaz. Edhe disa të tjerëve, që kishte pranë, u tha në vesh diçka.

— Seit, — i thashë unë me zë të lartë, që ta dëgjonte dhe Habibi, — shokët e kanë syrin te ti.

— Ashtu?! — qeshi Seiti. — Ju falem nderit që keni besim në zotësinë time! Jua shpërblefsha në gëzime!

— Qiqra në hell! — ia priti Habibi.

— E? — i tha i habitur Seiti.

Por s'mori dot përgjigje, se mbledhja filloi. Hajde, «dajak», hajde! As në ëndërr s'e kishte parë Seiti një dush të tillë. Një fytyrë i vinte, një tjetër i shkonte.

— Nuk të thashë kot që të gjithë e kanë syrin te ti, — i thashë Seiti. Po ai ishte bërë tym.

— Ne të dy, ama, për pak e morëm më qafë

brigadierin, — u ktheva pastaj e i thashë Habibit:

— Jo, more, nuk e hanim kaq kollaj ne atë kokërr ulliri!

Pata një ndjenjë admirimi për të dhe m'u duk vetja mjaft i vogël, por lëkundjet e mia nuk ia thashë atë çast. Kur ia tregova më vonë, ai qeshi me të madhe.

Seitit i dhanë atë që meritonte.

— Hajde tani, merrjani një këngë! — na tha kryetarja e komitetit profesional, kur mbaroi mbledhja.

Dhe unë e Habibi atë prisnim. Ia morëm me gjithë zemër këngës «Revolucioni marshon». Të gjithë na pasuan. Vetëm Seiti rrinte kokëvarur.

1971

45 MINUTA MBI ÇATI

Ora dy e pesëdhjetë minuta. Një burrë me pamje krejt të zakonshme dhe me veshje po të zakonshme hyri në ndërtesën ku ndodhej furra e shkrirjes. Kur u ndesh me afshin e nxehtë, ashtu pādashur e ktheu edhe një herë kokën dhe shikoi jashtë retë e dendura e të ngjeshura fort pranë njëra-tjetrës. Era e fortë nuk i linte të qeta për asnjë çast grumbujt e reve. Uli jakën e xhaketës dhe u drejtua për në vendin e teshave. Që andej doli i veshur me kominoshe dhe në mënyrë krejt të natyrshme eci drejt derës së furrës.

Atë ditë dhjetori, kur retë qenë dendësuar së tepërmi dhe era frynte si e marrë, ai qe në turnin e dytë dhe fillonte punën në ora tre.

Por atë mbrëmje dhjetori, me shkrirësin Qemal Lica dhe me shokët e tij ndodhi diçka që prishi ecurinë e punës së tyre.

Puna vazhdonte me ritmin e zakonshëm. Nata e kishte mbështjellë gjithë ndërtesën në gjirin e saj. Retë e dendura e të ngjeshura fort pranë njëra-tjetrës e shtonin edhe më shumë errësinë. Nga ato re të ngjeshura lëshohej shiu si i tërbuar. Era i rrë-

mbente rrëketë e shiut dhe i përplaste ku të mundte. Dukej sikur tufani e sulmonte ndërtesën pa ndërprerje.

Punëtorët e përqëndronin vëmendjen vetëm te puna e tyre.

— Si vete? — pyeti përgjegjësi i turnit, Idrizi.

— Shumë në rregull, — u përgjigj Qemali, ndërsa vështrimin e mbante tek ajo masë e madhe e zjarrtë, që shkrinte brenda në furrë. Temperatura kishte arritur 1500 gradë Celsius.

Disa pika shiu u lëshuan mbi qemerin e furrës, por nxehtësia i thau ato përnjëherësh. U vërsulën pika të tjera shiu, më të shumta, pastaj rrodhën çurka të pandërprera. Era, si duket, kishte shkallmuar llamarinat e çatisë së baxhës...

Qemali i mbërtheu sytë mbi qemerin e furrës, pikërisht në vendin ku binte shiu. Shkrirësit i rrahu fort zemra: munda e djersa e shokëve do të shkonin kot, 80 tonë brumë në furrë nuk do të ktheheshin në qelq për shkak të atij shiu që lagte qemerin. Qemeri i furrës, mbi të cilin vazhdonin të derdheshin currilat e ujit dhe që avullonte përherë e më shumë, dukej sikur i thërriste Qemalit për ndihmë. Po të lagej furra, qemeri do të shembej dhe puna, mund të ndërpritej për më se një muaj, derisa qemeri të rregullohej përsëri. Ky mendim kaloi në trurin e tij me një shpejtësi të rrufeshme.

«Në sulm!», i tha vetes dhe u vërsul për nga dera. Me përgjegjësin e turnit, Idrizin, u morën vesh vetëm me një vështrim. Me këta të dy u bashkua dhe Ramadani, brigadieri. Që të tre së pari iu vunë punës me nxitim për të ndërtuar një shkallë, që të mund të ngjiteshin në çati. Duart e tyre lëviznin si të qenë mekanizma elektrike. Të tre kishin vetëm

një mendim: të rregullonin sa më parë çatinë e baxhës që të shpëtonin furrën.

Shkallën e përgatitën dhe e vendosën në faqen e murit. Morën secili nga një llamarinë dhe u ngjitën lart. Kur i treti, Ramadani, po hipte te streha, disa punëtorë të tjerë po i ngjiteshin shkallës.

— Eeej, kthehuni! — u thirri atyre brigadieri. — Nuk kemi ku qëndrojmë të gjithë sipër çatisë. Mjaft jemi tre vetë.

— Zbrit ti, Ramadan, se do të ftohesh, zbrit ti e të vij unë, — u dëgjua një zë që nga poshtë.

— Jo, jo. Ju shkoni nëpër vendet tuaja. — Dhe Ramadani eci sipër llamarinave për te Qemali e Idrizi.

Në çatinë e baxhës ishin hequr tri copë llamarinë, aq sa morën të tre shokët, kur u ngjitën lart. Tufani vazhdonte me atë furinë e mëparshme. Ata qëndronin shtrirë dhe mbaheshin fort me duar se mos rrëshqisnin. Avulli që ngrihej përpjetë, nga shiu që binte mbi qemerin e nxehtë të furrës, sa vinte e shtoej.

Të tre shokët, që lart nga çatia e baxhës, mundën të shikonin për një çast shokët e tjerë poshtë, të cilët gjithë ankth i mbanin sytë përpjetë.

Vendosja e llamarinave në ato shina hekuri të ngushta, ku mezi mund të qëndroje edhe ditën, në kohë të mirë, qe shumë e vështirë.

Qemali e zgjati llamarinën që mbante në dorë; deshi ta vendoste në vendin e duhur. Erë e ngriti llamarinën dhe ia shkëputi nga duart. Ai u hodh ta kapte dhe u rrëzua vetë, ra shaluar sipër shinës së hekurit. Atje poshtë u ndie një «ah», që arriti tron-ditëse deri lart në çati. Qemali s'e lëshonte llamari-

nën nga duart dhe u kacavar me këmbë pas hekurit. Idrizi i vajti në ndihmë. Lllamarinën e tij ky e kishte vënë përfund trupit por, duke u zgatur që të mbante Qemalin, pesha e trupit i anoi nga vendi i mbetur pa mbulesë.

Ramadani e mbërtheu Idrizin prej këmbës së djathtë dhe e mbajti në vend. Shokët poshtë, që qëndronin si një masë e ngrirë, me forma të ndryshme, lëvizën si të çliruar nga një barrë e rëndë ndrydhëse e torturuese.

Qemali me Idrizin u ngritën dhe zunë vendet e mëparshme. Era e përplaste shiun si rrebesh mbi trupat e tyre. Pas asaj që ndodhi pak më parë, Qemali nxori mësim. E shtyu llamarinën rrëshqanas sipër çatisë, në mënyrë që era të mos mund ta ngrinte. E vendosi në vend dhe i hipi përsipër. Njëren pas tjetrës i vunë edhe dy të tjerat.

Shiut iu pre rruga. Mirëpo mbërthimi i llamarinave me bulona në shinat e hekurit qe i pamundur. Tufani ulërinte. E gjithë ndërtesa gjëmonte nga era, që përplasej si dallgë e furishme.

Të tre shokët, në heshtje, filluan t'i mbanin llamarinat e sapovendosura me trupat e tyre.

Poshtë puna vazhdonte përsëri me ritmin e zakonshëm. Pjesa e lagur u tha dhe avulli u pre. Por shokët poshtë, ndonëse të përqëndruar te puna që bënin, mendjen e kishin lart, te të tre shokët mbi çati, të cilët po përlesheshin me tufanin. Herë pas here hidhnin vështrimin andej, se mos shikonin ndonjë bulon që të lëvizte poshtë vrimës së ndonjë shine dhe, kur nuk shikonin gjë, e merrnin me mend se shokët atje lart e kishin pisk me tufanin. Zërat e tyre të shqetësuar, në ndonjë rast kur era

heshtte qoftë edhe për një grimë, arrinin deri sipër baxhës.

Vetëm kur u siguruan se uji nuk kalonte më nën llamarina, të tre shokët u kujtuan për veten e panë se ishin lagur e bërë qull. Qëndronin të tre barakas dhe duart i shtrëngonin pas llamarinave të mbërthyera, që era nuk kishte mundur t'i lëvizte dot nga vendi. Qemali në të djathtë, Ramadani në mes dhe Idrizi nga e majta. Era që vinte drejt grykës rrihte përpara trupin e shkrirësit dhe ia ngjishte fare pas trupit rrobat e lagura. Ai me të gjithë fuqinë i shtrëngonte nofullat, që të mos i dridheshin nga të ftohtët. Mendimi i shkoi te brigadieri. Ramadani kishte kaluar një të ftohtë para një viti. Qemali, duke u mbajtur vetëm me një dorë, me tjetrën hoqi peliçen e pambuktë, që kishte veshur sipër kominosheve dhe ia hodhi shokut.

— Mbaje për vete, se ty të kap era më fort aty,
— tha Ramadani dhe deshi t'ia kthente peliçen.

— Jo, jo, mbaje.

Përgjegjësi i turnit, kur pa këtë skenë, u tha dy shokëve:

— Ajo që na ngroh ne dhe që na mban edhe të lagur këtu sipër në çati, nuk janë peliçet dhe rrobat, se ato të gjitha janë bërë qull, por është ngrohtësia e zemrave tona...

Dy shokët e kuptuan sa të vërteta ishin ato fjalë dhe s'ngulën më këmbë për atë peliçe pambuku. Llamarinat lëviznin prej erës dhe kërcisnin. Shiu përplasej me zhurmë mbi çati dhe mbi tre punëtorët, që me trupat e tyre iu bënë mburojë furrës së shkrirjes.

Qemali përsëri mendonte për Ramadaniin... U

ngrit dhe u mbështet mbi bërryl, në ije, që t'i priste disi vrullin erës.

Tufani sikur e ngadalësoi pak forcën e mëparshme. Të tre shokët rrinin barkazi sipër llamarinave të pambërthyera dhe duart i shtrëngonin fort pas çatisë. Tani që shiu dhe era për një çast u vunë në dremitje, mendimet e tyre merrnin hov.

— Shokë, të mbërthejmë bulonat! — tha Idrizi.

Të tre u vunë në lëvizje. Lllamarinat i kishin vrimat të hapura. Por s'kishin vënë akoma as dy bulona në secilën llamarinë, kur tufani ia dha i fortë përsëri mbi çati me tërsëllëm. U shtrinë prapë në pozicionin e mëparshëm.

Shokët poshtë i hetuan lëvizjet e tyre dhe e ndienin veten më të lehtësuar. Kur pikasën se tufani po niste përsëri, shqetësimi ua përshkoi çdo qelizë.

Te streha e çatisë, ku qenë vendosur shkallët, llamarinat kërcitën. Ishin tre punëtorë të tjerë që vinin për të zëvendësuar shokët.

— Na e lini neve vendin tani, zbritni poshtë, shokë! — Ishte zëri i Fatmirit.

— Po kush ju tha juve të vini këtu? — foli Idrizi.

— Kush na tha? Po juve kush ju tha?

— Ne erdhëm të parët, — tha Ramadani. — Ju shkoni vazhdoni punën! Ne nuk ngrihem, se era i luan llamarinat nga vendi. Apo jo, Qemal?

— Ashtu është.

Fatmiri me dy të tjerët u munduan t'u mbushnin mendjen, por qe e kotë. Ata u kthyen.

Pas tre çerekë ore tufani ndaloi. Qemali, Ramadani dhe Idrizi i mbërthyen llamarinat pas shinave dhe zbritën poshtë.

Shkrirësi shkoi te dera e furrës. Brenda në fu-

rrë kishte mbetur edhe pak brumë pa e hequr. Afshin i nxehtë ia thau rrobat. Ky avull e bëri që t'i hidhte sytë mbi qemer. Atje çdo gjë ishte në rregull.

Qemali shikonte brumin e nxehtë që pakësohej në furrë, ndiente afshin e ngrohtë të tij dhe një ngrohësi që i buronte nga zemra.

1971

HALL ME TULLAT E BARDHA

Eh, tullat e kuqe! Vërtet lodheshe duke e bërë murin me to, por s'i kishe këto telashe që të hapin tullat e bardha. Tulla silikate ua kanë vënë emrin. E ç'më duhet mua si u thonë? Po të më kishin pyetur mua, tulla të sèkëlldisura do t'i quaja se, sa herë punoj me to, sèkëlldi më sjellin e çfarë sèkëlldie se!...

Se, që ta dini edhe ju, unë isha mësuar të punoja me tulla të kuqe. Ua kisha marrë mirë dorën. Tamam si ato zura t'i vendosja edhe tullat e bardha atë ditë kur m'i dhanë për herë të parë. Të bukura janë lanetet, të bukura fort: të bardha, të lëmuara, ta ka ënda t'i hedhësh hopa nëpër duar. E ia kisha marrë një të fishkëllyeri atë ditë, që shkonte përbrukuri me lëvizjet që bëja. Hop, rrëmbeja tullën silikate, hop me një frymë llaçin me mistri, hop vetëtimthi sipër llaçit bukuroshen dhe fiufiu fishkëllima. Kur do ti, me të mbaruar rreshtin e tretë, më doli përpara teknikja. Doli dhe shtrembëroi buzët. Ajo mblodhi buzët, mua fap m'u pre fishkëllima. M'u pre, se e di unë ç'do të thotë t'i shtrembërojë buzët ajo. Se, po shtrembëroi buzët, pisk e ke. E kisha provuar vetë, kohë më parë, me kornizën e dritares. Ngaqë ngutesha të tejkaloja normën dhe s'para vija

re punën që bëja, pjerrësia e kornizës së dritares më doli nga ana e brendshme, nga ana e dhomës, dhe kështu shiu do të kullonte brenda. Hej, ç'më gjeti mua atë ditë. T'u mblodhën të gjithë mjeshtrit e ndërmarrjes rrotull kornizës, si të që ndonjë gjë e rrallë, e t'ia filluan me kritika, thumba e romuze, sa jo vetëm balli, po tërë trupi m'u mbush me djersë.

Sidoqoftë, atëherë punohej me tulla të kuqe, që s'kishin huqe si këto tullat e bardha. S'ke ç'u thua, të bardha, të bardha, por e paskeshin pasur vërtet bishitin prapa, si të dardhës. Ja, sapo nisa të punoja me to, sapo bëra vetën tri sërë, teknikja shtrembëroi buzët.

E vështrova si i ngrirë. Ajo ma bëri me shenjë të afrohesha. Kaptova murin dhe i vajta pranë tërë siklet.

— Pa shiko ç'ke bërë? — më tha.

Hodha vështrimin te muri që kisha nisur të ngrija. Nuk e di se si, po edhe mua m'u shtrembëruan buzët: m'u bë sikur në ato tri sërë kishte plasur sherr i madh midis tullave, aq keq qenë ngërthyer njëra me tjetrën.

— Hall me këto tullat e bardha, — mërmërita dhe u përpoqa të dukësja i dëshpëruar.

— Ashtu?!

— Po, po, nazelie të mëdha. Nuk bëjnë pesë para, — sikur mora pak zemër, po fytyrën, ama, e pikëllova akoma më shumë.

Teknikja ngriti vetullat, më pa nga koka gjer te këmbët dhe m'u përgjigj:

— Mundet. Ndoshta vërtet nuk bëjnë as pesë para. E di çfarë?

— Hë?

— Pse s'merr nga ato të Harunit?

«Më duket se e hodha hendekun», fola me vete disi i lehtësuar dhe me shpejtësi hodha sytë nga Haruni, që po ngrinte një mur pak më tej. Po i hoqa vetëtimthi që andej, i kalova te teknikja, pastaj përsëri te Haruni, prapë te teknikja e te Haruni, që po vendoste njëren pas tjetrës me përpikmëri e aq bukur, sa ta kishte ënda të shihje tullat, tullat e bardha silikate.

«Ma punoi shejtanka!»

Unë nuk bëja, jo tullat e bardha.

E, si të mos mjaftonte kjo, erdhi e u mblodh gjithë brigada rrotull murit tim dhe ia filluan: bamp këtu e bamp atje, tamam në ato pjesë, ku tullat qenë ngatërruar aq keq njëra me tjetrën, sa s'e merrte vesh geni të zonë.

Pas kësaj ngjarjeje i thashë vetes:

«Vër mend, që të mos përvëlohesh prapë!»

Dhe, që të mos përvëlohesh nga qulli, zura t'i fryja edhe kosit. E çfarë të fryrë se. Rrija katër — pesë minuta me një tullë, veç e qaja, ama.

«Ja, kjo është punë që të kënaq, — thosha me vete. — Budalla paske qenë. Ngryse, or, ditën me 100-120 tulla, kurse zotërisë sate i hante kurrizi me dy metra e gjysmë kub me tulla të kuqe në ditë. Oh, oh, sa mirë!»

Ç'e do, kjo kënaqësi nuk zgjati as disa ditë. E ku të lënë rehat të gëzosh të tilla gjëra, e ku të lë plani, norma, rendimenti; jo një çerek metër kub, por tre çerekë duheshin bërë në ditë.

E ngrita zërin, e ngrita fort, bile:

— Qamet i zi! Si mund t'u bëkan tre çerekë metra kub në ditë? S'janë tulla të kuqe. Këto janë tulla të bardha, o shokë; o cilësi, o normë!

Dhe e ngrita, se kisha me vete edhe nja dy sho-

kët e mi. Por, në vend që të më dëgjonin, më tregonin me gisht Harunin. Të ishte vetëm Haruni, do që gjysma e së keqes por, si për inat, nga një u bënë shumë Harunë. Jo vetëm kaq. Unë ngulja këmbë në timen, ata djaj Harunë shtonin volumin, gjersa arritën të bëjnë një metër e gjysmë kub brenda tetorëshit.

Megjithatë, ata të tyren, unë timen. Ata flisnin e kërkonin të më mbushnin mendjen, ata përpiqeshin të më tregonin se mund ta arrija normën e tyre, po unë s'tundesha.

— Mirë, o byrazer, ju që jeni më të zotë shkoni më përpara. Unë nuk ju ndaloj. Po, sa për vete, kaq e kam takatin, kaq më jepet.

— Mor po, edhe xha Lazja, që u plak fare dhe tani u jep mësim nxënësve muratorë, bën më shumë, — ngulnin këmbë, pa u mërzhitur shokët.

— I lumtë! — u përgjigjesha edhe unë, pa u mërzhitur.

E pse të mërzhitesha? Në fund të fundit (këto të fshehta nuk ia thosha askujt), nëse punoja pak unë, punonin shumë anëtarët e brigadës sime dhe rroftë norma kolektive! Apo jo?

Përa pak ditësh më thanë:

— Sot do ta ndërtoni murin çift, bashkë me Harunin. Do të filloni nga të dy cepat e kundërt dhe do të takoheni në pikën e mesit.

— Si ta kërkojë e mira e punës, — u përgjigja dhe fillova t'i vendosja nga cepi im tullat silikate. Pranë nesh punonin shokët e brigadës dhe brigada të tjera.

Kur Haruni arriti me tullat e sërës së parë në pikën e mesit, unë doja akoma nja dy metra. Haruni më vështroi dhe foli:

— Sa të arrish ti gjer në mes, unë mund të pi rehat një cigare, Eh!

Unë nuk iu përgjigja. Folën të tjerët:

— Ke kohë të pish dy, Harun. Sot do të kalosh edhe normën e duhanit.

Më dogjën fjalët e tyre, po e mbajta veten dhe bëra sikur nuk i kuptova thumbat. Mirëpo ata s'pëshonin. Kur filloi radha e dytë e tullave dhe Haruni arriti në pikën e mesit, unë isha më afër tij, sesa kur vendosëm sërën e parë. Pa e kuptuar as vetë, i kisha lëvizur duart më shpejt, i nxehur, siç isha, nga thumbat e shokëve.

— O Harun, — i thirrën ata, — mendo edhe për ne, na e jep hua shokun tënd, që të mund të pimë edhe ne duhan, se na u ça hunda e shkretë, kur nuhatim erën e cigares sate.

— Jo, or, jo, — u përgjigj Haruni. — Ju mund të më quani individualist, po këtë radhë më pëlqen të mendoj vetëm për vete. Megjithatë, kur të vijmë në sërën e tretë dhe të pi cigaren rehat-rehat, atëherë do të vendos, t'jua jap shokun apo jo.

«Prit, se ke për ta pirë cigaren», shfryva dhe m'u ndezën krahët.

Punoja dhe me bisht të syrit vështroja Harunin. Kur ai arriti në pikën e mesit, edhe unë po vendosja tullën e fundit aty. Ai bëri sikur s'e vuri re; ndoshta priste sërën e katërt, por unë s'e lashë të pinte cigare as në të pestën, të gjashtë, gjer në fund.

— Eh, — i thashë, — u kënaqe me duhanin?

— Jo, — m'u përgjigj, por u kënaqa me punën tënde, se bëre po aq normë, sa dhe unë, sa edhe të tjerët. Tani pi një cigare nga të miat, — dhe vështroi andej nga i kisha sytë edhe unë, nga tullat e bardha, tullat silikate.

BRIGADA E SHAKAXHINJVE

Nikolla i gjeti punëtorët të veshur me rrobat e punës në «dhomën e pushimit», siç e quanin ata. Kjo dhomë që rregulluar me disa stola e tryeza. Në murin kundrejt derës qenë vendosur një sërë fotografish. Në krye të dhomës ishte rafti i ndihmës së shpejtë dhe sipër tij një bust mermeri i shokut Enver, i gdhendur me daltë. Të gjitha këto Nikolla i vuri re me një vështrim. Për këto nuk i kishin treguar. Gjithashtu ai nuk e dinte se bustin prej mermeri të shokut Enver e kishte bërë njëri prej ustallarëve të asaj brigade, Zefiri. Emrin Zefirit ia kishite dëgjuar, se ai që bërë i njohur në gjithë ndërmarrjen si specialist i zoti, po si fytyrë s'e njihte dhe nuk e dinte se punonte në atë brigadë.

Anëtarët e brigadës e kishin marrë vesh se atë ditë vinte tekniku i ri (pasi ai që ishte më parë kishite shkuar në hidrocentralin e Vaut të Dejës) dhe e pritën, që të takoheshin e të njiheshin me të.

Nikolla hyri në derë dhe pyeti:

— Këtu është brigada...

— E shakaxhinjve, — ia priti Faruku, të cilit

shokët i thërrisnin «shtatanik», pasi nuk i durohej asnjëherë pa folur.

Nikolla qeshi si i zënë ngushtë. Ata u ngritën dhe i dhanë dorën njëri pas tjetrit. Tekniku deshi t'ia mbante dorën më tepër se të tjerëve asaj flokëverdhës, por dora e tjetrit, që iu zgjat nga e djathta, e bëri që ta lëshonte.

Pasi u takuan, punëtorët u ulën prapë nëpër stola. I bënë vend edhe Nikollës. Njëri prej pjesëtarëve të brigadës, ai me kominoshe bojë bari, u ngrit të fliste. Tekniku mendoi se ai do të qe Besniku, brigadier. Vetëm këtë emër dinte. Ia kishin thënë në kantier. Por aty e mori vesh se ai që u ngrit për të folur, ishte Zefiri, i cili qe ngarkuar si anëtar i komitetit profesional të kantierit të prezantonte teknikun e ri me brigadën.

— Shoku që posa erdhi, — filloi Zefiri, — është gjeometri që do të drejtojë punimet në objektin tonë...

— Me leje? Një vërejtje, — kërcëu Faruku. — Le të kërkojë të falur për vonesën.

— Pusho njëherë, mor i uruar! — e qortoi një tjetër.

Nikolla shikoi orën. Ishte shtatë e dhjetë minuta. I kaloi një e rrëqethur nëpër trup e faqet iu bënë si t'ia kishte fërkuar njeri me gjethe thane. Nuk i kishte vënë rëndësi vetë asaj pune. E dinte se punëtorët shkonin në objekt me një makinë të ndërmarrjes, por i kishte ardhur më mbarë të shkonte me autobus. Sidoqoftë dita e parë, dhe i dukej si e pahijshme të takohej e të njihej në rrugë me punëtorët që do të drejtonte. Pastaj, edhe pse të vinte pak si vonë, ç'bëhej?...

Mirëpo ja ku të del ai Faruku e të faros me ato fjalë si farmak.

Zefiri harroi se çfarë duhej të fliste.

— E o, shtataniku na ngatërroi, — tha usta Veliu, një burrë sipër të pesëdhjetave. — E di, Zefir, unë kam një propozim, — vazhdoi duke u ngritur më këmbë. — Farukut t'ia mbyllim gojën me një shami, sepse, ndryshe, prapë do na ngatërrojë.

Krisi e qeshura. Nikolla për një grimë ndenji si i hutuar, pastaj e qeshura e përzjeu edhe atë me të tjerët. Tek shikonte të qeshnin gjithë ato fytyra, që sapo i shihte, harroi se një minutë më parë ndodhej në pozitë të vështirë.

Kjo e qeshur e shkrifëroi edhe Zefirin. Ai vazhdoi mendimin atje ku e kishte lënë:

— Unë shkova atje në kantier të njihesha me shokun teknik, po nuk u takuam. Drejtorja e kantierit e ka caktuar këtu përgjegjës për punimet, po për këtë duhet edhe aprovimi ynë, i kolektivit të brigadës.

— Epo, sikur të gjithë t'i nxirrni tani shamitë e të më lidhni gojën, nuk rri dot pa folur, — kërceu përsëri Faruku. — Ku e njohim ne, mor vëlla, që të japim aprovimin?

U ndien disa të qeshura, por i ndërpreu zëri i fortë i Zefirit:

— Faruk! Mos na e humb kohën kot!

Tjetri diç u bë gati prapë të fliste, por vërejti se sytë e të gjithëve i thoshin të heshte.

— Është e drejtë që ne nuk e njohim shokun teknik, — vazhdoi Zefiri, — prandaj dhe aprovimi nga ne kërkohet, pasi ta kemi njohur. Dakord?

— Dakord, — qe përgjigjja e njëzëshme.

— Atëherë në rregull. Projektet dhe instrumen-

tet teknike, besoj se të kanë thënë, do t'i marrësh në dorëzim nga kryeinxhinieri i kantierit, — iu drejtua Nikollës.

Pas kësaj, të gjithë me veglat e punës nëpër duar u drejtuan nëpër vendet e punës. Ndërtesa kishte mbaruar si karabina, brigada merrej me suvatimin e dhomave nga brenda dhe me shtrimin e pllakave.

Nikolla priti sa të fillonin nga puna, pastaj e thirrri brigadierin dhe i tha që së bashku të kontrollonin punimet.

— Me gjithë qejf, — qe i gatshëm Besniku.

Teknikut të ri i bëri përshtypje, sapo hyri në ndërtesë, cilësia e mirë e suvatimeve. Edhe muret nga jashtë ishin bërë mirë por, si i thonë fjalës, suvaja është si këmishë për ndërtesën. E, një këmishë të hekurosur ta pëlqen menjëherë syri, kurse, po qe rru-dha-rrudha... Por sidoqoftë duhej kontrolluar mirë; syri të gënjen. Mund t'i jetë dhënë lustër e bukur me përdaf dhe megjithatë të ketë shtrembërime. Mastari, plumbçja, terezia e ujit e thonë të vërtetën..

Ndërsa ai mendonte këto, brigadieri erdhi përpara tij me veglat që i nevojiteshin për të bërë kontrollin.

E filluan nga dhoma pranë hyrjes.

Nikolla i kontrolloi njëherë katër faqet e mureve dhe filloi për së dyti. Kjo me gjithë mend të çudiste. E vinte mastarin në të gjitha drejtimet: vertikal, horizontal, në mënyrë diagonale, qoshe më qoshe. E njëjta gjë: mastari puthitej plotësisht pas faqes së murit. S'kishte asnjë boshllëk ose ndonjë të ngritur të vogël. Dorë i thonë dhe gjatë fërkimit me mallë apo përdaf mund të bëhet ndonjë gabim. Mirëpo jo, dhoma ngjante si një kuti e madhe e prodhuar nga ndonjë fabrikë. Teknikut të ri iu ndeh një kënaqësi në

fytyrë. Kishte të bënte vërtet me njerëz të kujdes-
shëm, që ishin ustallarë të zotë, që e donin punën.

Vazhdoi kontrollin edhe nëpër dhomat e tjera. Mendoj njëherë se te dhoma e parë mund të ishin treguar më shumë të vëmendshëm, se në çdo fillim puna kapet më me qejf. Por jo, edhe në dhomat e tjera e njëjta punë, i njëjti kujdes. Nikollës i nxori krye, diku në një qoshe të ndërgjegjes, mendimi që të gjente qoftë edhe një të metë të vogël. Ky mendim e ndiqte nga dhoma në dhomë dhe, sa vinte, sikur rritej pak nga pak, po i kalonte caqet e një mendimi të shkrepur ashtu kot e po kthehej në një dëshirë. Epo duhej gjetur edhe ndonjë e metë që, në fund të fundit, të përlijte punën e tij edhe ai. Ndryshe, s'kishte kuptim; ç'punë do të bënte ai si teknik? Por ja që tekniku para tij dhe këta punëtorë kishin luftuar siç duhet kundër të metave. Megjithatë s'i mbushej mendja se në punët e ndërtimit mund të mënjanohen plotësisht të metat. Është çudi nganjëherë. Nuk i beson aq shumë një gjëje që e shikon vetë me sytë e tu dhe e aprovon me vetë ndërgjegjen tënde, por kapesh pas ndonjë mendimi që të ka ndjekur pas me vite. Kështu ndodhte në ato çaste edhe me Nikollën.

Mbaruan së kontrolluari dhomat e përfunduara dhe hynë në ato ku vazhdonte puna. Tani sikur u bë ca i padurueshëm. E vinte mastarin vetëm një herë në një faqe muri, e hidhte vështrimin përreth dhomës dhe kalonte në tjetrën. Në dhomën ku punonte Faruku, u ndal më shumë se në të tjerat. E shtynte diçka nga përbrënda, as ai vetë nuk e dinte tamam se çfarë.

Atij, Farukut, medoemos duhej t'i gjente ndonjë gabim. Mjaftonte që t'i tërhiqte një herë vërejtjen. Do të lindte pastaj që nga kjo vërejtje Faruku do të

kërcente përpjetë, atëherë teknikut i jepej mundësia ta qortonte mirë e mirë. T'ia bënte të qartë se, në fund të fundit, në atë objekt ishte ai, Nikolla Lisi, përgjegjës për punimet. Mirëpo në çast i ra ndër mend se nuk qe dhënë akoma aprovimi nga kolektivi i brigadës dhe iu bë sikur iu rrëzuan të gjitha ato që mendonte.

Me Farukun punonte edhe ajo leshverdha, Laura, kështu e kishte emrin. Mbi të gjitha, aty të bënte përshtypje pastërtia, sikur të qe mensë e jo një dhomë në suvatim e sipër.

— Ke qejf të rrish këtu, aq pastër është, — tha Nikolla.

— Epo, s'do as mend as kalem kjo punë, është dora e kujdesshme e femrës që vendos rregull e pastërti, — ia ktheu Faruku.

Të katër vunë buzën në gaz.

Kjo buzëqeshje nuk ia preu mendimin teknikut, që me çdo kusht të gjente ndonjë yçkël. E kontrolloi dhomën gati pëllëmbë për pëllëmbë po prapë asnjë vërejtje.

— Ju lumshin krahët! — tha dhe doli. Ç'të bënte, kot s'mund të fliste, se hajde të hyje pastaj në gojën e Farukut.

Kështu kaloi dita e parë.

Të nesërmen erdhi kryeinxhinieri i kantierit e i bëri dorëzimet. Atë ditë Nikolla u mor nja dy orë me përcaktimin e kuotës për shtrimin e pllakave ose, më mirë të themi, kontrolloi nëse ishin dhënë mirë kuotat. Çdo punë qe kryer me saktësi. Pjesën tjetër të kohës shkoi sa te një grup punëtorësh te tjetri, hipte e zbriste nga kati i parë në të tretin e anasjelltas; herë në heshtje, herë duke vërshëlyer. Ç'të bënte? Të rrinte në një vend, mërzhitej. Puna e tij qe të mbikë-

qyrte vazhdimisht cilësinë e punimeve, po dhe për këtë nuk qe nevoja... Të sillej ashtu kot, duke vërsjellyer, prapë sikur nuk shkonte. Një ditë edhe ngrysej në atë mënyrë, por jo disa muaj. Po punëtorët ia hoqën edhe atë siklet. Në mëngjesin e ditës së tretë, sipër tryezës, përpara vendit ku ai qe ulur ditën e parë, i kishin vendosur një palë vegla suvatimi dhe pranë tyre një copë letër, ku shkruhej: «Lodra zbatimëse për ata që mërzhiten». U mërzhit pak nga kjo shaka, por dhe mërzhitjen vetëm vetes ia tregoi. U kujtua shpejt se bënte pjesë në «Brigadën e shakaxhinjve».

I mori veglat dhe nisi të punonte me usta Velin, i cili atë ditë ishte vetëm dhe kishte nevojë për një ndihmës që të bënte përdaf mbrapa tij. Nikolla kishte mësuar të suvatonte që kur kishte qenë nxënës në teknikum. Ia kishte marrë dorën disi.

Mirëpo usta Veliut nuk ia dinte huqet. Ai e shikoi njëherë punën që bënte pas tij tekniku dhe hoqi disa viza në murin e porsasuvatuar. Ato viza thoshin që përdafi duhej përsëritur. Hera e parë që Nikolla lexonte një shkrim të tillë, po ishte shkrim i lexueshëm. Kur e mbaroi punën për së dyti, e pyeti ustanë:

— Xha Veli, po tani si të duket puna ime?

Tjetri nuk i dha përgjigje, vetëm i shpejtoi duart dhe e la Nikollën shumë mbrapa. Edhe këtë përgjigje pa zë tekniku i ri e kuptoi. Do të thoshte se «xhajë» qe ai që mbetej mbrapa në punë.

Kështu iu fut punës tekniku Nikolla Lisi. Punonte së bashku me punëtorët, lodhej e kënaqej. E shihte se çdo ditë futej më thellë midis atyre njerëzve. I pëlqenin puna e tyre, shakatë e tyre...

Pas disa ditësh vajti të punonte me Laurën, se-

pse edhe Faruku kishte shkuar në stërvitje. Që ta themi hapur, Nikollës i erdhi mirë që iu dha ky rast. Kishte vërejtur se vajza flokëverdhe sillej njësoj si të gjithë, punonte njësoj si të gjithë dhe bënte shaka si të gjithë. Duke punuar bashkë me të, i bënte vazhdimisht muhabet dhe i maste mirë fjalët para se t'i thoshte, në mënyrë që t'i jepte një farë rëndësie vetes. Ia solli fjalën rreth e rrotull e, më në fund, i tha se, po të donte ajo, ata mund të takoheshin në mbrëmje, pas pune.

— Po pasi të takohemi, ku ke ndër mend të shkojmë? — e pyeti Laura.

Ai s'e priste këtë pyetje. Mblodhi supet.

— Ku të duash ti, — tha, — shkojmë në kina-

ma.

— Mirë, — foli ajo.

— Po atëherë, t'i pres biletat unë?

— Jo, jo, atje e vendosim.

E lanë të takoheshin në orën shtatë. Ai vajti në vendin e takimit më shtatë pa pesë. Pas pak erdhi Laura me gjithë Farukun, të cilit i kishte futur krahun e majtë.

— I fejuari im, — ia prezantoi Nikollës.

Ai qeshi. Në të vërtetë e mori për shaka.

— Hë, mo, të ndaluar nga doktori e ke që nuk na uron? — foli Faruku, që kishte marrë një pamje serioze. Serioziteti i atij çasti binte në kundërshtim me fjalët për të qeshur që fliste.

Pastaj ai nxori një pako llokume nga një letër e bardhë, ku e kishte mbështjellë.

— Këtë për sot, — i tha. — Nesër në brigadë e ke pjesën bashkë me shokët.

Nikolla s'po dinte si të vepronte.

— Po si kështu?... Kur kështu?...

— Kjo punë është vendosur me kohë, sonte i erdhi rasti të bëhet e njohur, të shpallet, — ia priti Faruku.

— Biletat i kemi prerë për më 7 e gjysmë, — tha Laura. — Bëjmë një shëtitje të shkurtër, pastaj shkojmë në kinema.

Kështu u fut në jetën e brigadës së shakaxhinjve edhe Nikolla.

1971

GODINA 17

Kjo është godina që ndërton brigada jonë. Rreth nesh ngrihet një bllok i tërë ndërtesash, prandaj, për t'i dalluar nga njëra-tjetra, i është vënë nga një numër secilës. Çdo brigadë ka një ndërtesë më vete, kështu që edhe brigada merr numrin e asaj që ndërton. Pra, unë punoj në brigadën e 17-të të bllokut të ndërtesave të banimit. Ndërtesa jonë ngrihet fare afër rrugës. Njerëzit që shkojnë këndeje, sidomos banorët e lagjes, të cilëve u qëllon të kalojnë aty më tepër se dy – tri herë ditën, na njohin të gjithë si fytyrë ne, punëtorët e godinës 17. Disa na i kanë mësuar edhe emrat. Edhe ne jemi mësuar t'i dallojmë rrugëtarët që kalojnë pranë nesh, nëse janë apo jo banorët e kësaj lagjeje.

Rrugëtarët dinë vetëm numrin e ndërtesës, që e shikojnë të shkruar me bojë të zezë, në një copë dërrasë të mbërthyer në një binar, të ngulur në tokë. Dinë gjithashtu se ai ustai rreth të pesëdhjetave që punon gjithmonë në qoshen e majtë, nga ana e rrugës, quhet Kiço. E kanë dëgjuar kur i thërrasim ne të tjerët. Ashtu, kalimthi, na i kanë mësuar të gjithëve.

Brugëtarët veç nuk mund të dinë jetën e brigadës sonë, ndjenjat dhe mendimet, shqetësimet, gëzimet tona. Ata vërejnë, duke kaluar, murin që rritet tullë pas tulle e rresht pas rreshti, hedhin ndonjë përshëndetje dhe vazhdojnë rrugën për ku kanë punë.

— Jeta është e madhe, — më thotë Kiçoja, duke shikuar nga rruga.

Nuk i përgjigjem. Fjalët e tij më bënë edhe mua të mendoj, ma zgjatën fillin e mendimeve.

— Eej, ngrije spangon, mos m'i bëj sytë si pasnesër! — më thërret Kiçoja. — Unë të flas, ti hutolesh. Flet përbrenda, me veten tënde.

Kiçoja është më i moshuari në brigadë. Të folurit e ka pak si të rëndë, por ne ia kemi mësuar dhe nuk zemërohem. Ai edhe vetë e di këtë dhe disa herë e përsërit si me shaka:

— Mos m'i vini re të gjitha fjalët, se kanë filluar të më bien dhëmbët, prandaj nuk i mbaj dot tepricat brenda buzëve. Pastaj, shkollë nuk kam dhe i kam më të ngjeshura mbeturinat e vjetra.

Ndërtesa jonë përbëhet nga dy seksione me dy hyrje, secili. Në seksionin e parë, në fasadën pranë rrugës, punoj unë me Kiçon, ai në qoshen e majtë, unë në të djathtën. Në murin që lidhet me qoshen e Kiços punon Estrefi, një burrë me mjekër të kthyer si ganxhë, me një kapelë meshini, që dimër verë nuk e heq nga koka. Në të majtë të Estrefit i vendos tullat pak si me druajtje Idrizi, një djalë i ri, me një palë mustaqe si kalli elbi dhe që, me gjithë të thënat e shokëve, nuk bindet t'i presë. Në murin e mesit kemi lënë vetëm Tahirin, me kominoshet e mëdha, që i rrinë si thes trupit të tij të vogël. Ajo punëtorja esmere, që e nget karrocën e tullave duke kën-

duar, është Qanija, kurse ai punëtori me këmishë të nxjerrë sipër pantallonave, që përgatit llaçin, është Fetahu.

Ne të seksionit të parë jemi në garë me ata të të dytit, të cilët deri tani na e kanë fituar garën. Atje punon Pandi, me moshë rreth të tridhjetave, me flokët e rënë sipër ballit, me sy bojë qielli, që në çdo çast duken sikur shprehin diçka të re. Ka qenë dy vjet vullnetar në një kooperativë bujqësore mallore dhe po bën gati një muaj që është kthyer. Së bashku me Pandin ngre murin Emini, një butrë trupgjatë dhe i thatë, që rrallë nxjerr ndonjë fjalë nga goja, por që lëvizjen e duarve për të vendosur tullat e bën dendur. Midis Pandit dhe Eminit mundohet t'i ngjeshë tullat me grushtin e saj të butë Lefteria, një muratore e re në moshë e në zanat, e shëndoshë pak si tepër dhe që gjatë tetorëshit mbulohet në djersë. Prapa tyre është Dionisi, që flet gjithmonë me zë të lartë, dhe Muharremi, që nuk dëgjon dot nga veshi i djathtë. «Ma ka shurdhuar Dionisi duke bërtitur», thotë ai saherë duke qeshur. Besimi, kryetari i organizatës profesionale të brigadës, me ballin e gjerë dhe pak të rrudhur, punon në ndërtimin e armaturës së shkallës së bashku me Manolin, që e mban vazhdimisht lapsin e verdhë në veshin e majtë. Ndërsa ajo vajza brune, me flokë të zinj lëshuar supeve dhe pantallona të përveshura deri nën gjunjë, që lëviz sa në një vend në tjetrin, është teknikja jonë, Valentina dhe që ne e thërrasim shkurt Vali.

Brigada jonë është e re. Përpara ne punonim në për brigada të tjera dhe, kur filluan punimet në ndërtesën 17, u bashkuam dhe formuam brigadën e shtatëmbëdhjetë.

VAJZA ME PARDESY VISHNJE

Ajo kishte qëndruar tek puqet rruga që kalon pranë ndërtesës sonë me rrugën kryesore, rreth 20-30 metra larg nesh. E para e vuri re Qanija.

— Eej, kë kërkon ajo, mos të pret ty? — më thirri mua.

Ngrita kokën dhe vështrova. Ishte një vajzë me pardesy vishnje. Flokët ngjyrëgështenjë i kishte gufmuar si fole laraskash.

Rrinte në anë të rrugës dhe diç vështronte këtej në drejtimin tonë.

— E, mor Festim, ty të kërkon, e njeh? — përsëriti për herë të dytë Qanija.

— Ec, drej, mos u tall, po bjer tulla! Lëri njerëzit në punë të tyre!

Vazhdova punën. Sa njerëz shikojmë ne që ecin rrugës, apo presin në vend, burra me tava në duar, që i çojnë në furrën e pjekjes, gra me fëmijë në krah, pleq me bastun, plaka që kthehen nga pazari me çantat të mbushura me presh, qepë e karrota, djem të rihj me çanta studenti, vajza të bukura... Këto për ne janë gjëra krejt të zakonshme, prandaj edhe vajza me pardesy vishnje nuk më bëri ndonjë përshtypje të veçantë. Unë kam punën time, ajo të sajën. Duhet të vendos tulla shpejt e shpejt unë, se i kam minutat të shtrenjta. Një minutë e humbur, do të thotë disa tulla më pak në murin e ndërtesës. Nga kjo del pas-taj që...

— More ti, ç'ma ngul kokën ashtu si mushkë, — dëgjova Kiçon të më sokëllinte, duke i lëshuar fjalët grumbull, si kokrrat e misrit kur rrëshqasin nga ndonjë thes i grisur. E ka bërë zakon Kiçoja që të flasë nxituar; i mpleks e i ngatërron frazat me një-

ra-tjetrën. Ia kemi bërë vërejtjen për këtë dhe na e pati gati përgjigjen: «Nuk kam mësuar t'i përdor shenjat e pikësimit. Shikoje, bre, atë çupën atje, — vazhdoi, — ajo e ka një hall që rri atje. S'ka mundësi që të rrijë kot një vajzë atje, në mes të rrugës. Kushedi, njerëz jemi. E ka një gjë ajo, por, se çfarë ka, nuk e dimë...

Drejtova mesin dhe shikova tek kishte qëndruar vajza me pardesy vishnje. Ajo vërtet që s'i shqiste sytë nga ndërtesa jonë, diçka kërkonte me ngulm. Ishte e qartë: kërkonte ndonjë nga të brigadës sonë.

Në fillim, ashtu kot, sepse m'u duk që vështrimi i saj drejtohej mbi mua, por shpejt u binda se dikë kërkonte andej nga seksioni i dytë i ndërtesës.

E fundit e pa Valentina. Ajo po merrej me Dionisin, që e kishte bërë qoshen shtrembër dhe s'e kishte fare mendjen se çfarë shikonim ne. Sa vuri re Valin, që u ngrit në këmbë dhe e ktheu fytyrën nga rruga, vajza me pardesy vishnje ngriti dorën e djathtë. Teknikja jonë nuk e njohu dhe i hodhi një shikim, ashtu si pa interesim, vajzës që vazhdonte ta tundte dorën, gati me padurim.

Më në fund e morëm vesh se kë kërkonte ajo, që për një kohë na tërhoqi vëmendjen.

Valentina qëndroi gjatë, duke biseduar me shoqen e saj. Nga mënyra se si u përqaftuan me njëra-tjetrën; merrej me mend se kishin një kohë të gjatë pa u takuar.

Ne tani qëndronim të gjithë me mistri në duar dhe shikonim dy shoqet që posa u takuan. Duke gjykuar nga pamja, ato nuk duhej të ishin shoqe, në kuptimin e plotë të kësaj fjale.

Ato të dyja vazhdonin të bisedonin, ne i vështronim. Mistritë i mbanim të mbështetura mbi mur.

— Ç'bëjmë, more, se e humbëm të gjithë! — na përmendi Kiçoja. — Vazhdojmë, bre, punën...

Valentina u kthye dhe në fytyrën e saj vizatohej një shqetësim jo i zakonshëm. Tek ecte, kokën e mbante ulur dhe duart i rrëshqiste sa njërën-tjetrën pas pantallonave. Ndaloj përballë meje dhe Kiços dhe vërejti me kujdes rreshtat e murit që ndërtonim ne.

Kiçoja e la mistrinë mbi mur, vendosi duart në ije dhe ia hodhi sytë teknikes. Si unë edhe ai qemë të bindur se teknikja nuk e vërente murin për të dalluar aty ndonjë të metë.

— E, moj shoqja Vali, inxhinierë është ajo që të kërkoi? — foli Kiçoja.

Teknikja sikur u çirrua nga një mendim.

— Kush... inxhinierë... ëhë, jo, jo, është një shoqja ime... e kam pasur dikur shoqe... Erdhi sot të më takonte, se...

— Jo, thashë kot, — tha Kiçoja, duke i hequr duart nga ija, — pashë që ti, sa u ndave nga ajo, erdhe dhe ia mbërtheve sytë murit. Kushedi, mendova, mbase na ka diktuar ndonjë gabim që andej dhe të thirrri ty për të të tërhequr vëmendjen.

Ajo tani e mori vesh që ai bënte shaka.

Vali erdhi e u fut të punonte midis meje dhe Kiços. Mori mistrinë time; ajo shtronte llaçin sipër murit, unë vendosja tullat. Herë pas here lëshonte disa si psherëtima, ashtu siç bëjmë zakonisht kur kemi vapë dhe duam të çlirohemi nga zagushia.

— Nuk di si t'ia bëj atij drejt Dionisi, — foli pas pak. — E treta herë që bën punë të keqe. Ia kam prishur e jam e bindur që e bën se nuk di...

Në vend të fjalëve që do të thoshte më tej, lëshoi një psherëtimë. Dukej se e brengoste puna e Dionisit. Por nuk qe kjo e gjitha. Tjetër hall e bënte që

të psherëtinte aq shpesh. U mata t'i thosha: «Moj, po me Dionisin e rregullojmë ne hesapin, tjetër të keqe mos paç ti», kur më doli Kiçoja përpara:

— Kollaj është, xhanëm, për Dioniskën (ashtu e thërret ai atë, kur do që ta ironizojë). Mos të tha ajo çupa ty ndonjë llaf që të lëndoi, atë na thuaj!

— Ja, pra, — Valit ia preu lemza fjalët. — Sa po merresha me Dionisin, kur... siç e patë atë shoqen... Ka vite që s'jemi takuar...

SHOQJA E DIKURSHME

(Tregon Valentina)

Në vitin e parë të teknikumit ne ishim dy shoqë: Xhemilja dhe unë. Të dyja erdhëm nga rrethe të ndryshme, por aty, në shkollë, shumë shpejt u bëmë shoqë të ngushta. Përkim i bukur: të dyja ishim veshur njësoj, me triko të bardha, ashtu siç i mbanim zakonisht në fshat dhe fustane prej së njëjtës basmë. Të gjithë, kur na shihnin, na merrnin për motra. Disha nga shoqet e tjera të klasës sonë qenë shumë të dhëna pas veshjes. Më kujtohet njëra, Erifile e kishte emrin, dhe firifile ishte nga mendja. Ditë për ditë i ndërronte fundet. Dhe çdo fund do ta kishte pa derman më të shkurtër nga ai i mëparshmi. Bëri mirë që e la shkollën qysh në dymujorin e parë, sepse në dimër Erifilja me siguri do të merrte plevitin. Neve të dyjave na u bë qejfi që nuk e shihnim më. Na pat bezdisur. Sa na shihte, bërtiste: «erdhën provincalet».

Me Vitorinë u njohëm vitin e dytë. Vitin e kaluar ajo vazhdonte klasën e dytë të gjimnazit. Nuk

mundi ta merrte klasën atje dhe erdhi u regjistrua në klasën e dytë të teknikumit tonë. Nuk e di nëse dha provim, para se të regjistrohej, në lëndët profesionale apo jo. Më kujtohet se përmendte sa herë dashën e saj, që kryente një punë me përgjegjësi.

Ne të dyja vumë re qysh në fillim se Vitoria vishej thjeshtë. Mbase ky qe shkaku që ne u miqësuan shpejt me të. Qe shumë e dashur dhe kishte një giltërsi në shpirt, që të rrëmbente pas vetes. Kështu, ne u bëmë tri shoqe që s'ndaheshim nga njëra-tjetra. Në fillim shoqja jonë e tretë çalonte cazë në mësime, pastaj erdhi e ua mori dorën, ecte njësh me ne. Vetëm në një gjë na e kalonte Vitoria neve të dyjave. Ishte shumë e bukur, e them pa ngurrim se ishte vajza më e bukur në të gjithë shkollën. Por ne s'e kishim aspak zili për këtë, përkundrazi, kënaqeshim që e kishim shoqe. Pasi u njohëm mirë me të, as që do të na vinte mirë që Vitoria të qe shoqe e tjetërkujt dhe jo jona.

Babai im është murator dhe bashkë me dy muratorë të tjerë nga fshati ynë i sollën këtu në ndërmarrjen e ndërtimit. Nuk e di se si iu mbush mendja tim eti të largohej nga fshati, sepse ai më thoshte gjithnjë: «Kur të dalësh ti teknike, do të ndërtojmë një fshat të ri, me shtëpi të bukura. Do të ndërtojmë edhe një hidrocentral atje poshtë, te katarakti i lumit tonë. Pastaj do të ndërtojmë edhe një kinema...» Patjetër që e ka menduar se këtu ka pasur më shumë nevojë. Kishte shkuar vetë drejtori i ndërmarrjes për të marrë specialistë ndërtimi nëpër fshatrat e rrethit tonë.

Kështu që unë u bëra me shtëpi në Tiranë dhe nuk flija më në konvikt. Më erdhi keq që nuk do ta kisha më krevatin pranë shoqes sime, Xhemiles. Po

s'prishte punë. Unë do të flija në shtëpinë time, dhe Xhemilja kishte plot shoqe të tjera, që e donin njësoj si unë dhe ajo i donte njësoj si mua.

Pas kësaj, me Vitorinë, kur ktheheshim nga shkolla, shkonim së bashku me autobus një copë rruge dhe të nesërmen në mëngjes, cilado prej nesh që të dilte e para do të priste shoqen te stacioni i autobusëve.

...Pushimet e verës i kalova te familja e xhaxhait, në fshatin tim të lindjes. Me Vitorinë u takova pas tre muajsh, në fillim të vitit të tretë shkollor. Qe rritur e zbukuruar më shumë. Kishte qenë një muaj në plazh dhe fytyra i pat marrë ngjyrën e çokollatës. Mesin e shtrëngonte me një kollan të gjerë dhe flokët i mbante të shkurtër, si të çunave. Sepse m'u duk që ishte krijuar një distancë midis nesh. Ajo, si gjithmonë, vazhdonte të më qëndronte afër, të më fliste me dashmirësi, por as vetë s'e kuptoja pse nuk kënaqesha. Më shumë se për çdo gjë tjetër Vitoria më fliste për muzikën.

Qysh në klasën e dytë u apasionua pas muzikës. U përpoq dhe u regjistrua në një kurs muzike, që hapej për amatorët në një nga qendrat kulturore të qytetit.

Një muaj pasi filloi atë kurs, Vitoria ua vari mësimëve. Unë e Xhemilja i folëm që ta linte atë kurs, të mbaronte shkollën njëherë. Qe e pamundur t'ia ktheje mendjen. Më vonë, admirimin që kishte për muzikën e lidhte dhe me një drejtues muzike që e njohu atje, në kurs.

— Ai është njeri i madh, — na thoshte Vitoria, — njeh veprat e kompozitorëve të mëdhenj të botës.

— A është i bukur ai? — e pyeti njëherë Xhemilja.

— Ua, ta shohësh, moj Xhemo, sa i bukur është!

E pashë një natë kur shkua me mamanë në klinikën e dhëmbëve.

Aty nga ora dhjetë e gjysmë e natës nënës i dhembte dhëmballa në mënyrë të padurueshme. Babai nuk qe në shtëpi dhe e shoqërova unë deri në klinikë. Kur po ktheheshim, njerëzit nëpër rrugë qenë të rrallë. Përpara nesh një çift ecte me hapa të ngadaltë. Një e rrëqethur më kaloi nëpër trup, saqë edhe nëna e hoqi dorën që mbante te goja dhe më pyeti: «Ç'pate?» Atë çast e zotërova veten: «Mbërdhiva pak», i thashë. Nuk më erdhi mirë që e pashë shoqën time, Vitorinë, aq vonë, natën, me një djalë që i kishte hedhur dorën për mes. Prandaj asaj i vinte gjumë, i mbylleshin sytë në orët e mësimit. Ajo na fliste neve për muzikë të huaj që dëgjonte në magnetofon, për filma të huaj që shihte në televizor, na tregonte edhe përmbajtjen e atyre filmave, por neve, mua dhe Xhemiles, nuk na pëlqenin. Ata filma bënin fjalë për njerëz të pasur me zemër të mirë e për gjëra të tjera, që ne nuk mund t'i kuptonim e t'i besonim. Të them të drejtën, neve na pëlqenin edhe magnetofoni, edhe televizori, por jo ajo muzikë dhe ata filma që na përmendte Vitoria.

Megjithëse pak vjedhurazi, e pashë atë djalin që pushtonte Vitorinë për mes. Vura re që ishte i bukur. Por ç'e do bukurinë, kur nuk ishte i mirë. Derisa e pushtonte për mes, vetëkuptohej që e donte. E kur e donte, pse të mos kujdesej që Vitoria të mësonte? Por ai nuk e donte mirë, e donte keq dhe, derisa e donte keq, ishte njeri i keq. Këto të gjitha dhe shumë të tjera ia thashë Vitorisë të nesërmen. Ajo në fi-

llim i mori si me të tallur fjalët e mia. «Të kanë bërë sytë ty; Vali, sikur më ke parë mua», thoshte. Ky qëndrim i saj më nevríkosi dhe fillova t'i tregoja hollësira: formën e ngjyrën e kostumit të shokut të saj, trikon e fundin që kishte veshur vetë Vitoria, mënyrën se si ia kishte hedhur dorën ai për mesi.

Asaj i mori fytyra një shprehje mospërfillëse:

— Ohu, kam gajle unë! — tha.

Isha e vendosur që ta kundërshtoja.

— E pse s'ke gajle, — i them, — apo sepse të flas për të mirën tëndë?

Shprehjes mospërfillëse ia zuri vendin një ngërdheshje e fytyrës. Pastaj qeshi me të madhe, sa unë u tremba.

— Ha, ha, ha, e kush dashkërka që të më mësojë, pa! Po ti, moj e shkretë, dje i hape sytë. E kujt i jep mend se, mua! Do të bëje mirë që të mësoje nga unë. Edhe unë, me kë harxhoj frymën! Aq di ti, aq thua. Kujton se e gjithë bota është në ato mësimet që ti i mëson përmendsh, si papagal. Jeta është e madhe.

— E si e kupton ti këtë jetë të madhe? — më kishte hipur edhe mua që të mos i lëshoja rrugë.

— Si e kuptoj?! — Ajo u dha krahëve mbrapa. — S'do as mend, as kalem kjo çështje. Të mos ndrydhem, por t'i shijoj të gjitha ëmbëlsitë që ka jeta.

— Po shkollën?

— Përrallis ti, përrallis. Eh, ç'të paska vdekur mendja! Shkolla është vetëm sa për të zënë një punë, që të marrësh rrogën, moj tutkune!

Mendova t'ia vërtitja nga ana tjetër:

— Mirë, — i thashë, — ty s'të duhet shkolla dhe ta zëmë se ashtu është. Po ai shoku yt, që të mësoi muzikë, vetë më ke thënë që ka studiuar shumë, është me shkollë të lartë. A nuk vini në kundërshtim të thellë të dy?

— Ehu, ç'na fut nëpër thekra tani! Lërna, për kokën tënde, se do të na presësh oreksin.

Si e pa që s'më theu dot, ajo po tërhiqej.

— Edhe diçka tjetër, Viçori: pa mendo, sikur të mos ishe kaq e bukur sa ç'je, a do të të donte ai shoku yt?

— Moj, dashkërke llogari të thella ti! Sa tuhafe që bëhesh. Më do, e dua. Pse, mos do t'i kërkoj fletëgaranci? — Tha këto edhe iku e bezdisur.

Në katërmujorin e parë Vitoria ngeli në katër lëndë. Nga gjysma e marsit e la shkollën. Dhe atëherë e pashë atë dajën e Vitorisë, që erdhi disa herë në drejtori të shkollës e bisedonte për punën e së mbesës. Ama, dajë! Vinte mbasi e pat marrë ferra uratën, si i thonë fjalës. Gjatë dy vjetve s'qe dukur asnjëherë të pyeste, pale si i ka punët kjo mbesë që vazhdon shkollën, si vete me mësim. Jo vetëm daja, por edhe i ati dhe e ëma nuk e morën ndonjëherë këtë mundim të vogël! Babai im, për shembull, vinte dy herë në muaj e takohej me mësuesit e mi. Edhe kur ishte në fshat, ai mbante vazhdimisht lidhje me ta nëpërmjet letrave.

Sidoqoftë ardhjet e dajës së Vitorisë në shkollë dhe bisedat me drejtorin nuk bënë që Vitoria të kthehej sërishmi. Më vonë dëgjuam se Vitoria qe futur në punë, daktilografiste në një zyrë. Unë e shihja atë rrallëherë në qytet, matesha t'i flisja, por ajo bënte sikur s'më shikonte; qëllimisht kthente kokën mënjane ose ndërronte drejtim. Po asnjëherë nuk e shihja me atë djalin që e pashë atë natë. Medoemos që ata takoheshin, por jo ditën.

Dhe ja, ku u takova me Vitorinë pas katër e kusur vjetësh. Ajo erdhi vetë. Dhe e mora vesh pse. E hoqën nga puna si daktilografiste, pasi atë detyrë

do ta kryente një tjetër nëpunëse e asaj zyre. Don-
te ta ndihmoja unë për të gjetur ndonjë vend.

— Mos këtë nevojë diku për ndonjë magazinie-
re, për shembull, — më tha.

— Po te ne magazinierja e kantierit është me
teknikum.

Vura re që s'i erdhi mirë, po nuk e dha veten.

— Kam shumë shpresë te ti, Vali, — më tha edhe
kur iku.

Ajo akoma s'ka nxjerrë mësim nga jeta.

I TRETË ARRITI NË MAJË

(Tregon Fëstimi)

Dy burra, njëri me flokë të thinjur dhe tjetri me
moshë më të re, qëndruan përballë meje e Kiços. Për
një hop vështruan murin e katit të parë, që ishte në
mbarim.

— Shumë të bukura duken këto ndërtesa me tu-
lla të bardha, — tha ai me flokë të thinjur, — por si-
kur po ecet ngadalë. Apo e kam gabim...

— Jo, nuk e ke gabim, — ia pret Kiçoja, — por
punët e mira bëhen avash-avash.

Ata të dy dolën nga ana e brendshme, ku puno-
nim ne.

— Më të mira janë këto tullat e bardha nga të
kuqet? — pyeti ai më i riu, që mori një tullë në dorë
dhe e vërente.

— Ou, njëqind herë më të mira, — ia priti Kiço-
ja.

— Ashtu ë, po nga se?

— Po ja, më të forta janë, të prera standard i ke; pastaj, ajo që na hyn më fort në punë neve, atje ku t'u biesh me çekiç, thyhen.

— Të ftohtët sikur e përçojnë më shumë këto lloj tullash?

— Jo, e ke gabim, — i them unë.

— Pse e kam gabim? Motra ime ka marrë një hyrje para një viti në një pallat me tulla të bardha. Kur është ftohtë, i sjell fëmijët në shtëpinë time.

— Nuk është faji i tullave, por i muratorëve, që nuk i kanë zënë mirë me llaç boshllëqet midis tullave. Kanë vrapuar vetëm pas sasisë, siç duket...

— Po, po, po, — tha flokëthinjuri. — Por edhe tani... sikur ngadalë ecet.

— Eee, dëgjove, shoku brigadier? — m'u drejtua Kiçoja, si u larguan të dy vizitorët. — Kopaçe për kurrrizin tonë janë ato.

— Kërkesat e popullit, — thashë, — kanë të drejtë.

S'i vura veshin se ç'tha. E njoh mirë Kiçon. Me fjalë ta bën ters ai, me punë të del përpara. Mendoj: duhet shpejtuar ritmi i ndërtimeve. Këtu kishim ngecur. Përpara ne kemi punuar me tulla të kuqe dhe ecnim mirë me to. Kurse tani, me tulla silikate, për të njëjtën sasi pune harxhojmë më shumë kohë. Cilësia mirë, por... njerëzit duan më shumë shtëpi. Ky problem shqetësonte gjithë brigadat e bllokut tonë. Kishte brigadierë që ankoheshin përditë në drejtorinë e kantierit, bile edhe të ndërmarrjes, se duhej rritur vlera për metër kub e murit me tulla silikate, sepse nuk realizohej norma. Sipas normave ekzistuese një murator duhet të bëjë 0.75 m^3 , kurse ata mendonin që të ulej deri 0.60 m^3 . Duhej thyer ky koncept. Po si? E bisedova me Paandin këtë problem,

— Të luftojmë ne të dy që të arrijmë të paktën metërkubshin, — shfaq mendimin.

— Ta bëjmë masive, — tha ai. — T'i hedhim të gjithë në lëvizje.

Të këtij mendimi qenë edhe teknikja me Besimin.

Sulmi filloi të nesërmen. Qysh në mëngjes Vali u foli shokëve. I pari kundërshtoi Kiçoja.

— Ia thashë edhe dje Festimit, por ai bëri sikur s'më dëgjoi, s'i erdhi mirë. Do të na bëni rezil, do të na prishni cilësinë.

Zëra të tjerë mbytnin njëri-tjetrin. Nuk merrej vesh kush fliste e kush dëgjonte.

Ndërkaq vëreja Kiçon.

— Ama, e tunde! Të lumtë! Fundja, shokët e mirë për këso rastesh duhen. — Ai e kuptoi ç'desha t'i thosha.

— Ç'më shikon ashtu?! — tha. — Hiç mos më shiko! Mirë, mirë; sa hendeqe kam kaluar unë! Eyy-haa! E ngremë sasinë sot, edhe prishim murin nesër.

— Mirë e ka Kiçoja.

— S'do mend që e ka mirë.

— Po është i vojtur ai, ehuuu...! Në fjalët e usta Kiços mbështetemi ne, — deshi t'i vinte kapakun Dionisi.

— Kush tha që jam i vuajtur? — Kiçoja u ngrit nga stoli. Nga shtrëngimi i nofullave një damar i kërcëu në anë të zverkut, sa një kokërr lajthie. — Mos kam ardhur të të shtrij dorën ty? E kemi llafin te puna, që të bëhet si është më mirë e nuk e kemi të vuajtja ime.

Në atë kohë u ngrit Pandi:

— Ç'do gjë e re ngjall dyshime, — tha. — Janë krejt të natyrshme dhe logjike këto. Bëjmë gabim po

të mendojmë ndryshe. Jo bëhet, jo s'bëhet, po, si është më mirë: të bëhet, apo të mos bëhet? Këtyre debateve nuk u shmangesh dot. Por veç duhet inkurajuar iniciativa për të arritur rezultate më të larta. Si ta shpjegojmë më saktë këtë, — vijoi dhe e kaloi vështrimin në fytyrat e të gjithëve. — Ta zëmë se tre vetë kanë marrë për detyrë të ngjiten në majë të një mali të lartë, ku s'janë ngjitur ndonjëherë.

I pari thotë: «Nuk shkohet kurrë atje, kurrë. Është e pamundur». Dhe ndalet në vend.

I dyti: «Prit, të shohim njëherë që të venë të tjerët, pastaj shkojmë dhe ne.» Edhe ky gjithashtu qëndron në pritje.

I treti niset i vendosur. Rrugës lodhet shumë, djersët i kullojnë curg, por, më në fund, arrin në majë të malit.

Tani me cilin jemi ne? — pyeti Pandi, duke na shikuar të gjithë njëherësh. — Me cilin je ti, Kiço?

— I lumtë atij që arriti majë malit! — Kiçoja i tha këto si përfundim i një dialogu me vetveten.

Pasoi një heshtje. Gjithkush shikonte ngultazi në një pikë të caktuar. Ato që tha Pandi, mund t'i thoshte edhe Valentina, apo Besimi, mund t'i thosha edhe unë, por nuk do të kishin po të njëjtin efekt. Ne e njohim të gjithë atë, ashtu siç njohim komshiun që kemi në të njëjtën shkallë e në të njëjtin kat.

Heshtjen e prishi Dionisi:

— Shoku Pandi na solli këtu një shembull shumë të mirë, — filloi ai, — shembull ky që na bën të gjithë të mendojmë thellë. Në vazhdim të tij edhe unë do të tregoj një shembull tjetër, me qëllim që mendimi ynë këtu të dalë më i pjekur.

Ka qenë një teqe e përmendur andej nga anët tona...

— Ama me teqe e nise, o, — ia priti Manoli.

Dionisi e shikoi me qortim dhe i buzëqeshi:

— Prit, dëgjo, ke për t'u kënaqur... Në këtë teqe, — vazhdoi, — vajti një udhëtar që s'pat shkelur më parë në ato anë. E pritën mirë, me mish e raki, hëngri sa deshi dhe në fund tha: «Kjo teqe rroftë e përparoftë, u ngjittë lart e më lart, por në majë mos arrihtë!» «Ç'thua kështu»; — i tha babai i teqesë, përse të mos arrijë deri në majë.»!? «Sepse pastaj do të zbresë në anën tjetër», — përfundoi rrugëtari.

Kështu është, shokë, — e mbylli Dionisi, — çdo ngjitje ka edhe zbritje, prandaj duhen bërë hesapet mirë.

Përsëri heshtje, një heshtje nervoze. Ne sapo mundoheshim të ndiznim zjarrin, kur Dionisi i hodhi përsipër një kazan të madh me ujë. Vështrimet e të gjithëve shigjetonin Dionisin, ndërsa ai u buzëqesh-te të gjithëve, duke i dhënë fytyrës një panje prej babaxhani.

— O Dionis, fol më troç! — kërceu Besimi. — Cila është ajo ana tjetër që thua ti?

— Ka parasysh veten Dionisi, — ndërhyri Vali, — që e bën qoshen shtrembër dhe, kur e kontrolloj unë, e prish gjithë murin.

Dionisit iu mbarua e qeshura e shtirur, si prej babaxhani.

— S'do mend, kur thua të vërtetën, kështu e pëson, — dhe shikimin që e kalonte nga njëri te tjetri donte ta përdorte në vend të shkopit, për t'u mbështetur:» Hëni bre, hapeni gojën, për ju po flas», thoshte zëri i tij i brendshëm.

— Pse, kush gënjeu, që vetëm ti thënke të vërtetën? — s'm'u durua pa ia përplasur. Se ç'më shtynte t'i flisja më rëndë, ta shaja që ta mbante mend tërë

jetën, por e mblodha. Nuk duhej të merrja zjarr ash-tu. Aty ishin të gjithë shokët.

— Sikur kaluam nga tema, — dredhoi Dionisi, — dhe po flasim vetëm për mua.

— Brenda temës jemi, — tha Pandi, — me konceptet.

— S'është punë koncepti kjo, është punë mundësish. — Mënyra se si i shoqëronte fjalët me mimi-kë Dionisi, të jepte përshtypjen se ai qe më i singër-ti ndër të gjithë. — Ja, të gjithë shokët me mish e me shpirt punojnë, por kaq kemi mundësi të japim. Le të flasë edhe usta Kiçoja, ai është me përvojë, por e di që s'bëhet më shumë, prandaj nuk ndihet.

— Edhe kaq sa është norma, nuk realizohet, — foli si nëpër gjumë Tahiri.

— Ç'ke që e kruan kurrizin me mua, o i biri... — Kiçoja i çakërriste sytë, sikur donte ta përpinte Dionisin. — Oj, kush na kundërshtoka këtu! Dioniska, që e do teknikën te koka dhe Tahiri, që, në murin e mesit bën aq mur, sa fare kollaj mund ta marrë në kominoshet në mbrëmje, kur lë punën. Këta të dy le të rrinë, ne më shumë do të punojmë.

— Gati, vallahi, bilahi, unë përgatis llaç me çimento sa të doni, — tha Fetahu.

— Ou, edhe unë jam gati t'jua shemb skelat me tulla, — e pasoi Qanija.

— Dhe tani në sulm! Ta kemi parasysh, se nuk është vetëm kjo majë për të ngjitur. Synimi i gjithsecilit të jetë: sot të bëj diçka më shumë se dje, — e mbylli Pandi.

U ngritëm të gjithë. Dionisi i hiqte këmbët bravnë. Mbrapa tij Tahiri shkante si një ka i lidhur për brirësh. Filloi puna. Kiçoja, në kundërshtim me natyrën e tij, heshtte. Në rreshtin e parë unë vura 4-5

tulla më shumë nga ai. Djersët e mbuluan, jo prej lodhjes, po nga inati. U kthye me rrëmbim të ngrinte qoshen. Vinte vërdallë. Nuk gjente dot plumbçen. Prej nxitimit e kishte shtyrë me këmbë, nga skela poshtë. I thirri Qanijes që të merrte nën skelë dhe t'ia jepte.

— Ehë, u plake, s'ta mban më, — i tha ajo, duke i dhënë plumbçen.

— Bjere, moj korbeckë e dreqit, mos na çaj kokën!

Ndërsa vuri tullën e parë dhe u përkul mbi mur ta peshonte me plumbçe, i ra hekuri i drejtimit nga ana e jashtme.

— Pthu, jazëk! — shau nëpër dhëmbë.

— Ama ti, Kiço, do një punëtor në dispozicion që të të mbledhë veglat, se të bien, — e thumboi Qanija.

— Hiqmu, mullënjë e zezë!

Në rreshtin e tretë ma kaloi me dy tulla. Në rreshtin e katërt gjashtë tulla më shumë nga unë.

— Hiqe cigaren, që ma mban si hosten në gojë, se të mori frymën, — më bërtiti. — Në darkë, kur të vesh te plaka, zgërlaqu në minder edhe pi duhan rahat.

E hodha cigaren. Ia kalova me tri tulla. Në rreshtin e gjashtë u takuam mu në mes të murit. Punonim në hyrjen e dytë të seksionit të parë. Hyrjen tjetër e kishim përfunduar një ditë më parë deri në rrafshin e brezit të parë të betonit.

— O burra! Ta mbarojmë sot këtë faqe muri, — i them Kiços.

— Deri më drekë, mor i humbur!

Drejtoi pakëz mesin dhe shikoi shokët e tjerë.

— Pandi me Eminin na e paskan kaluar, — tha duke kruar kokën. — Oj! Edhe Dioniska me revan

ia paska marrë. Shiko?! I kapka tullat si të jenë kokoshka. Hë, qen misri, hë! Ama, edhe Vali çekan i qëndroka. I ndihmoka Muharremi, shejtanka!

Ndërkaq unë e mbarova të gjithë rreshtin vetëm.

— Ma hodhe, — tha. — Unë të vura zjarrin për një cigare që ndeze...

Estrefi me Idrizin ndodheshin tre rreshta mbra-pa nesh.

— Ej, tunduni, se mbetët tek ura e Lanës, — u thirri ortaku im atyre. — Apo shikoni Tahirin, që po e zë gjumi sipër murit?

— E kemi faqen e murit më të gjatë ne, — tha Idrizi.

— Me gjithë boshllëkun e dritareve po. — Ku të lë Këçoja të justifikohesh.

— E dua për gjithnjë trupin unë e jo vetëm për sot, — foli Tahiri, ca si me vonesë, duke gromësitur dhe herë pas here u hiqte hundëve ndonjë të fërkuar me mëngën e kominosheve.

— Po, po, mos e mundo trupin, se mbase hapet ndonjë muzeum dëmbelësh e të të kemi në gjendje të mirë, — ia dha përgjigjen Këçoja.

Estrefi ia nisi i pari së qeshurës me hi-hi-hi-të e mëdha, pas tij u kurdis Idrizi. Edhe Tahiri qeshi me vete.

— Eee, shikoni si iu varën jargët Tahirit, -- bërtiti Qanija.

— Ah, qerrata, prapë ma kalove, — foli Këçoja si me vete, kur më pa që vendosja tullat në pjesën e tij.

Teknikja erdhi dhe kontrolloi murin. Dukej e kënaqur.

— Më mirë se ditët e tjera, që është punuar më

ngadalë se sot, — tha. — Pra, shoku xha Kiço, — dhe i vuri dorën në sup, — duhet ndryshuar koncepti: «Punët e mira bëhen avash-avash». Vetë po e vërtejtojmë se edhe punët e mira mund të bëhen shpejt.

Kiçoja diç u mat të fliste, por, sikur ta kishte gjuhën me fre, e ndaloi brenda buzëve. Nuk i vjen mirë atij kur ia përmend të metat; i ngjan sikur i lëndon plagët. Kiços i pëlqen më shumë autokritika, sesa kritika. Autokritikën, të shumtën e rasteve, e bën indirekt.

— Ma nguli një kunj kjo mua. — foli pas pak, ndërsa vetullat e trasha i përziheshin me njëra-tjetrën. — Ma nguli, por ç'e do se as që jam i zoti ta heq, pale... — Ndërsa fliste, sytë i mbante mbi mur dhe duart i shpejtonte në vendosjen e tullave si një mekanizëm elektrik. Gjente ku ta shfrente dufin.

Vali i ndiqte lëvizjet e tij me një vështrim të çiltër. Sepse atë ditë asaj i pat rënë një hije serioziteti, ndryshe nga herët e tjera! Ndofta nga ato që ndodhën në mëngjes, ose ngaqë puna mori një hov më të vrullshëm. Momente kthese në punë dhe në temperamentet e njerëzve. Kiçoja heshtte, i përqëndruar vetëm në vendosjen e tullave. Edhe Vali heshtte, me vështrim të përqëndruar vetëm në lëvizjen e duarve të Kiços. Unë, gjithashtu në heshtje, mendoja për ata të dy, Kiçon e Valin...

...Ajo erdhi teknike në brigadën tonë qysh kur filluan të gërmoheshin themelet në godinën e shtatëmbëdhjetë.

Ne e njihnim atë si teknike të kantierit tonë, kurse këtu do të punonim së bashku.

— Markë e dobët, — më tha Kiçoja, ndërsa të dy vendosnim piketat e para të themeleve. E njihja

qysh përpara Kiçon. Edhe herë të tjera kishim punuar bashkë.

— Nga e çmon ti?

— Po ja, femër po qe, markë e dobët është.

Më erdhi edhe inat, edhe për të qeshur me të. Dëshja t'i jepja shkas muhabetit vetëm për ta ngacmuar.

— E ke gabim, — i them. — Të vjen mirë ty sikur të të thotë njeri për vajzat e tua «markë e dobët»?

— Oj ky, ç'na kandiska tani. Po një lloj marke janë këto të gjitha, o t'u mbylltë!

— Ashtu?! Harrove kur ta mblodhi ajo infermierja?

Ma kishte treguar vetë Kiçoja. Kishte qenë i sëmurë me temperaturë dhe nuk donte t'i bënte gjilpërat që i kishte dhënë mjeku. Mirëpo vajza e madhe, infermiere (Kiçoja ka dy vajza), e detyroi dhe ia bëri injeksionet, pa marrë parasysh kundërshtimet e të atit.

— E, ma mblodhi, — tha, — e do puna, s'ke ç'i bën...

... Këto më erdhën ndër mend, ndërsa vëreja Kiçon që punonte me shpejtësi, pa nxjerrë asnjë fjalë dhe Valentinën, me vështrim të përqëndruar në duart e tij.

— Markë e fortë, — i them qëllimisht Kiços.

— Kush, tullat? — tha teknikja. S'e dinte ajo ku rrihte çekani.

— E ka gjetkë, i paudhi, — ndërhyri ortaku im. — Po, sa më shumë të piqet, më e fortë bëhet marka, — përfundoi.

Vali, që s'kuptonte nga ky muhabet, u mjaftua me një të mbledhur të supeve. Kur ia tregova, s'e mbajti dot të qeshurën.

Na tërhoqi vëmendjen një grindje që krisi andej

nga seksioni i dytë. Muharremi po bënte fjalë me Dionisin. Të dy mbanin një hekur drejtimi në dorë dhe asnjëri nuk ia lëshonte tjetrit.

— Mua do të ma hedhësh ti? — bërtiste Muharremi.

— Ore, luajte nga mendtë, o! — Dionisi fliste shtruar dhe pa u ngutur, si njeriu që ka të drejtë.

— Pse e shtrembëron hekurin vetë, unë ta paskam fajin, që kërkon të më marrësh timin?

— Po ti, more... e shtrembërove kastile hekurin tim me këmbë dhe e fute në pjesën time që të më dalë muri i shtrembër...

Valentina shkoi me vrap atje. Ndërkaq ndërhy në Pandi e Besimi dhe e qetësuan gjendjen.

— E bën qëllimisht ai, — tha Kiçoja për Dionisin, — për të penguar punën. Sa u largua teknikja andej dhe ia plasi sherrit. Është një qen bir qeni, që... Nuk duhet t'ia ndash kopaçen nga kurrizi atij.

Dionisi ishte një çiban i keq, një vemje në trupin e brigadës sonë.

Unë e Kiçoja e mbaruam murin në orën dymbëdhjetë pa katër minuta. Po të ecnim me ritmin e mëparshëm, do të na duhej më shumë kohë për ta kryer po atë punë. Kiçoja dukej çuditërisht i çelur. Nuk mbahej. Fluturonte nga entuziazmi.

— Ua kemi kaluar të gjithëve, — thoshte dhe nga gëzimi fërkonte duart pareshtur.

Po nuk qe ashtu. Teknikja bëri matjet dhe na raportoi të nesërmen në mëngjes. Vendin e parë e zuri Emiri.

— Po të ecet me këtë ritëm, plani i muajit realizohet disa ditë para afatit, — vuri në dijenë teknikja.

— Dhe pastaj na merr makina e zezë e na çon të kodrat e Sharrës, — lëshoi Dionisi.

— Ti të vdesësh që sot, se, po të rrosh, do të na shtrembërosh hekurat, — ia priti Muharremi...

— Ama jo, — i doli përpara Kiçoja. — Për ne hiç mos të të hajë merak. Puna na e shton më shumë shëndetin.

Dionisi e dinte ç'e priste, megjithatë s'pushonte së shpuari vrimat.

RRËMIM NË KUJTESE

Vajza me pardesy vishnje erdhi përsëri të takoj me Valentinën. Sikur i kishte ikur pak ajo druajtja e ditës së parë, që e bënte të ndalonte atje tej, në anë të rrugës.

Ajo u afrua dhe na tha:

— Puna mbarë!

— Mbarë paç! — ia kthyem përshëndetjen.

Qanija, e nxitur nga kureshtja, doli nga ana e brendshme për të parë kush ishte. Vështrimet e të dyjave u kryqëzuan.

— I thërrisni pak Valentinës, — tha e porsaardhura dhe e largoi shikimin nga sytë e bardhë të Qanijes, e cila përfitoi nga kjo shmangie dhe ma bëri me shenjë: «alamet vajze».

I zënë ngushtë, kafshova buzën e poshtme.

«Të turpëron në këso rastesh kjo», thashë me vete.

— Më erdhi në ndihmë Kiçoja.

— Ç'më rri aty, moj tutkune! — i bërtiti Qanijes.

— Hë de, ik, foli Valit të vijë! Oj, m'i bën sytë si kukuvajkë!

Vajza me pardesy vishnje e ktheu kokën mënjanë, për të fshehur të qeshurën që i erdhi padashur

në buzë. Pastaj e treti shikimin në një drejtim të paccaktuar.

Diçka më kujton fytyra e kësaj vajze. Kujtim i largët, i mbuluar nga cipa e harresës gjatë disa viteve. Fytyrë e njohur, po ku, kur e kam njohur? I nxitatë gjitha vatrata e kujtesës. E shtyrë nga vështrimi im, edhe ajo nisi të më shikonte. Ndofta edhe unë, i kujtoja diçka, një fytyrë të njohur dikur, por të paccaktuar.

Kiçoja u ul nga ana e brendshme e murit dhe më foli me zë të ulët.

— Po ç'bën, mor i humbur, se të ranë sytë së shikuari. Hape gojën mor, t'u kyçtë me tutius, t'u kyçtë! Bëji një muhabet, të paktën, që të mos rrijë si mbi gjemba.

— Ehë, mua s'më jepet, — ia ktheva, duke u ulur edhe unë nga ana e tij. — Kryeje më mirë vetë këtë detyrë fisnike!

— Oj, gallofi, — tha dhe e pa të udhës të ngrihej.

Vajza me pardesy vishnje filloi të bariste.

— Mos u mërzit, — i foli Kiçoja, — se ja, tani vjen shoqja Vali. Po ti, shoqe e ke, apo të afërme?

— Shoqe, shoqe e kam. — Ndaloi ecjen. U kthye nga ne.

Edhe zëri m'u duk i njohur. Dalngadalë cipa e harresës po largohej dhe po më ngjallej fytyra e një shoqeje të fëmijërisë. «Ah, mor Kiço — them me vete, — sikur ta bëje njëherë të qeshte, atëherë do të bindesha plotësisht.»

Dhe Kiçoja ia pat gati, sikur të më kishte dëgjuar.

— Mój, unë i fola këtij timit përpara, por edhe ti s'po ia ndake sytë. Mos ratë në sevda ju të dy?

«Vitoria», sa s'thirra, kur vura re të qeshurën e saj.

Erdhi Vali. Të dyja shoqet biseduan gjatë. Më shumë bisedonte ajo tjetra, që mua më shembëlente shoqen e fëmijërisë, Vitorinë. Vetëm emri më ngatërronte. Unë e mbaja mend Vitori, kurse Vali e thërriste Violeta. Gjatë bisedës, vija re se asaj i merrte fytyra lloj-lloj pamjesh. Herë pas here e hidhte vështrimin nga unë. U largua si e brengosur, por, megjithatë, nuk harroi të na thoshte: Mirupafshim!

Erdhi edhe herë të tjera. Druajtja pothuajse iu largua fare. Vinte na jepte dorën, bisedonte me ne lirisht. Na pyeste për punën, për pagën, a lodheshim shumë. Shkurt, vajza me pardesy vishnje u bë e njohur me ne. Matesha disa herë t'i thosha që më ngjante me një shoqen time të fëmijërisë, Vitorinë, por se ç'më pengonte. Ndofta ajo shprehje e saj e zakonshme: «E rëndë është, e rëndë puna e krahut, për zotin». Të paktën atë «për zotin» të mos e thoshte. Sidoqoftë nuk i dhashë të kuptonte se s'më pëlqente kjo shprehje. Pse, kot. Se mos e kisha shoqe në punë dhe nuk ia bëra samarin copë. Një njohje e thjeshtë që kjo. Mirëpo... Edhe çështjet e ndërlikuara, nga e thjeshta e zënë fillin.

Një mbasdite e takova rastësisht në autobus.

— Vetëm je? — më pyeti, duke më dhënë dorën.

— Vetëm, siç më sheh, — ia ktheva.

Nuk e prisja këtë takim, po, meqë u takova, më erdhi mirë. Koha kishte filluar të ngrohej, dhe ajo nuk e kishte veshur pardesynë ngjyrë vishnje. Kishte një triko deve bojë mjalti, që i shkante shumë. Fundi në ngjyrë të kaltër i rrinte pak mbi kupat e gjunjëve.

Zbritëm nga autobusi dhe ecëm bashkë një copë rrugë.

— Kishe ndonjë plan për të shkuar gjëkund?
— më pyeti Vitoria.

— Jo, ashtu kot, pa ndonjë qëllim të caktuar. Po ti?

— Edhe unë...

Vazhduam të ecnim. Për të thyer heshtjen dhe për të shuar atë kureshtjen time të parë, nisa t'i tregoja asaj për shogën time të fëmijërisë, Vitorinë. Ne ishim moshatarë dhe shtëpitë i kishim afër, gati-gati puqur me njëra-tjetrën. Vitoria kishte një vëlla më të madh, që atëherë vazhdonte shkollën unike në qytet. Unë isha djalë i vetëm. Kisha vetëm nënën. Babai më qe vrarë gjatë një përleshjeje me diversantët. I ati i vërsnikes sime punonte në kadas-trën e rrethit tonë. Ne të dy ishim si motër e vëlla. Bashkë luanim, bashkë shëtitnim, bashkë shkonim e mblidhnim luleshtrydhe rrëzë korijes dhe lule lëndinave. I fola për ditën e verës, si e festonim ne në fshatin tonë, për ndjenjat e gëzimit tona dhe për shumë kujtime të tjera, gati të harruara të fëmijërisë sime e të Vitorisë.

Ajo u dha e tëra pas këtij rrëfimi. Kur unë ndaloja, ajo kthente kokën, m'i ngulte sytë dhe më vështronte në fytyrë, sikur aty do të gjente ato që unë lija pa thënë.

— Mos je Festimi i nëno Nurkës ti? — tha.

Edhe ajo, si duket, po rrëmonte në kujtimet e fëmijërisë.

— Po, dora vetë, — Nuk isha gabuar. Vitela e sotme e Valit qenka Vitoria e vogëlisë.

Fytyra i mori një gjallëri të çuditshme.

Po të mos kishim qenë në rrugë, në prani të gji-

thë atyre njerëzve, me siguri do të më kishte përqa-
fuar.

— Si u bëmë kështu, — tha, — s'njohim njëri-
-tjetrin, si të humbur. — Dy pika lotë i riguan nëpër
faqe. Ndjeva se shoqja ime e fëmijërisë kishte një
dhembje, dhembje që u prek nga kujtimet dhe e bë-
ri t'i derdheshin ato dy pika lotë. Kishim vite që s'i-
shim parë, qysh kur ishim gjashtë vjeç. Atëherë i
ati kishte tërhequr të shoqen dhe të bijën në qytet...
Unë me nënën time ikëm më vonë nga fshati, kur
unë mbusha njëmbëdhjetë vjeç, dhe erdhëm në Ti-
ranë...

— Çfarë ke, Vitori?

Papritmas u drodh. Me sa dukej, ajo ishte lar-
guar nga ky emër. Njëkohësisht ne tani ndodheshim
edhe afër, edhe larg njëri-tjetrit.

Qysh prej atij çasti, unë vendosa ta thërrisja me
emrin e saj të vërtetë: Vitori.

TREGON VITORIA

— Unë do ta mbaj mend jetën time në moshën
shtatëmbëdhjetëvjeçare. E di si e përfytyroj veten
gjer në këtë moshë? Si një fëmijë që ecën vetëm këmb-
badorazi, që bën si t'i thonë dhe shkon ku ta dërgoj-
në. Kisha dëgjuar shumë të flisnin për bukurinë ti-
me, por kjo s'më bënte shumë përshtypje, më dukej
e zakonshme, pa shumë rëndësi. Vetëm kur mbusha
të shtatëmbëdhjetat fillova ta ndieja kënaqësinë e
kësaj bukurie. Kjo më dha edhe njëfarë krenarie, fi-
lloi të më pëlqente vetja. Dhe mendoja se kisha të
drejtë.

Se mos harroj edhe diçka tjetër, pasionin për mu-

zikën. Po unë nuk doja muzikë sidokudo, muzikë të zakonshme, si u pëlqen të gjithëve. Doja muzikë të rrallë, që të mos e kishte dëgjuar tjetërkush përpara meje. Kjo ndjenjë për muzikën erdhi m'u shtua në moshën shtatëmbëdhjetëvjeçare, pasi kisha kryer klasën e dytë të teknikumit.

Në vitin e tretë u regjistrova edhe në kursin e muzikës. Por, të them të drejtën, në fillim m'u duk si hallvë e ftohtë. Ehu, atje na mësonin notat, ashtu siç na bënte mësuesja e muzikës në shtatëvjeçare, bënëim ushtrime me fisarmonikë. Unë doja tjetër gjë të mësoja dhe, mundësisht vetëm unë, jo të gjithë, sa djem e vajza ishin atje në kurs. U mërzita, u pendova dhe desha të dilja. Pesë me hiç qe ai kurs. Mirëpo nuk qe e thënë...

... Ishte hera e tretë, apo e katërt që veja në kurs. Pasi mbaruam për atë mbasdite dhe po dilnim, Ariani, njëri nga mësuesit e muzikës (ne kishim tre të tillë) më tha që të ndaloja më mbrapa. Të më kishte thënë ndonjëri prej dy të tjerëve, edhe mund të mos e kisha pritur, por Arianit s'më vinte mirë t'ia prishja. Ai kishte një fytyrë tërheqëse dhe një shikim të embël, që të bënte menjëherë për vete. Mua sidomos, qysh në fillim, nuk m'i kurseu këto shikime. Sigurisht ngaqë isha e bukur. Nuk më vinte inat që s'm'i ndante sytë. Përkundrazi, ndieja kënaqësi. I bukuri shikon të bukurën. Edhe muzikën ai donte të na e zhvillonte ndryshe nga të tjerët. Na e tha vetë, me gojën e tij, qysh ditën e parë.

— E di unë se ç'duhet të mësoni ju, por s'ke ç'i bën, programi...

Kështu që e prita dhe dolëm bashkë. Unë nuk dija se ç'krah duhej të mbaja duke ecur me një djalë dhe qëndroja në krahun e majtë. Ai më vuri dorën

në sup me delikatesë dhe më nxori nga krahu i djath-të i tij.

— A të pëlqen shumë muzika?

— Si s'më pëlqen! Unë prandaj erdha në kurs. Qeshi.

— Pse, kështu mësohet muzika?! Ky vetëm emrin ka kurs.

Unë e thashë vetë më parë, që s'më tërhiqte ky kurs. Po mirë, ku duhej të mësoja atëherë?

— Mos ki merak, — më qetësoi Ariani. — Do të kujdesem unë të të jap mësim në mënyrë të veçantë.

Ecnim anës trotuarit. Dëgjoja e përpirë Ariani, që fliste për muzikë dhe për njerëz të mëdhenj, të shquar në këtë fushë. Nuk e di pse m'u duk vetja e vogël, e vogël dhe doja që të rritesha mundësisht brenda sekondës, prandaj i afrohesha më pranë Arianit.

... Ajo ka qenë nata e parë që u ktheva vonë në shtëpi. Derën e gjeta mbyllur, më vinte shumë zor. S'isha mësuar të trokisja ndonjëherë në derën e shtëpisë sime.

Trokita, në fillim ngadalë, pastaj me grusht. Ma hapi derën nëna. Nuk më foli, vetëm më shikoi me qortim. Në kuzhinë prisnin zgjuar babai dhe vëllai i madh. U bë një gjyq i vogël për mua atë natë. Më shumë nga të gjithë qe zemëruar Hatibi. Nuk u linte radhë prindërve të flisnin. Unë u përpoqa të shpjegohesha, sigurisht duke thënë gënjeshtër, por ata ma prenë shkurt: «Në qoftë se e bën edhe një herë si sonte, vonohesh pa marrë leje, pa lajmëruar, nuk ke më vend në këtë shtëpi!»

Rashë në krevat pa ngrënë darkë. Deri në mëngjes nuk vura gjumë në sy. Njëra pas tjetrës më rro-

tulloheshin përpara syve fytyra e Arianit, që buzëqeshte ëmbël dhe fytyra e Hatibit, që më kanosej.

Të nesërmen shkova te daja. Atje ishte jastëku që mbështetja kokën, sa herë më dhembte. Jo te vetë daja, por tek e shoqja e tij, Nysreti. Edhe kur isha e vogël, sa herë që kisha ndonjë nevojë dhe nuk ma plotësonin të shtëpisë, vrap e te nusja e dajës, veja ankohesha. Ajo ishte për mua njeriu më i mirë në të gjithë farefisin tonë. Dhe i dëgjohej fjala. As vetë daja nuk ia prishte, as edhe të shtëpisë sime. Ajo ma kishte kthyer dhe emrin nga Vitori në Vite-la, megjithëse gjithë të tjerët me emrin e parë më thërresin.

Kështu që, të nesërmen e natës së parë erdha vonë në shtëpi, vajta t'i qaja hallin hallë Nysretit, si isha mësuar ta thërrisja. Nuk ia tregova shkakun e vërtetë. I thashë se vajta me një dy shoqe në kinema, në orën tetë deri në dhjetë. Ajo erdhi bashkë me mua. Bisedoi me nënën dhe vëllanë e madh. Babanë nuk e gjeti aty.

— Mos e ndrydhni vajzën, — u tha. — Lëreni të mësohet e pavarur, të jetë e zonja e vetës.

U hëngrën shumë ndërmjet tyre. Nëna fliste më rrallë. Tek-tuk çeku e kundërshtonte hallë Nysretin edhe Marjeta, nusja e vëllait, që i gjeti në bisedë e sipër, kur erdhi nga dyqani i ushqimeve. Hallë Nysreti u zemërua me ta.

Me Arianin vazhdoja të takohesha çdo natë, me përjashtim të disa rasteve, kur ai më thoshte: «Jam i zënë me punë». Dhe takoheshim gjithmonë në mbrëmje vonë. Ariani kishte një magnetofon, ku kishte incizuar shumë këngë dhe melodi që mua më pëlqenin shumë. Përveç magnetofonit Ariani kishte edhe një album të madh me fotografi. Aty kishte gru-

mbulluar fotografi artistësh. «Po ti je më e bukur, sepse mban freskinë me vete», më thoshte sa herë gjithë ëmbëlsi. Ato ishin me të vërtetë të bukura, por mua më tërhiqte më shumë mënyra se si viseshin dhe e mbanin veten.

Në kurs veja vetëm sa për të kaluar kohën. Ç'më duhej. Për muzikë kisha Arianin dhe magnetofonin. Edhe mësimet e shkollës i mori lumi. Sepse më dolën fare nga qejfi! Periudha më e ndritur në mësimet për mua qe klasa e dytë e teknikumit të ndërtimit. Edhe atëherë nuk do t'i kisha ato përparime, por që lloi që zura shoqëri me Valin e Xhemilen. Atyre të dyjave u binin sytë mbi libra. Xhemoja e uruar ishte tamam si një qengj, e urtë, e dashur, vetëm se cazë si e druajtur. Vali qe ndryshe, shpuzë, në të gjitha drejtimet. Ama, e tepronte me gjithë atë seriozitet. Sikur nuk i përshtatej. Pastaj, të dhënit shumë pas mësimëve, sidomos vajzat i bën tekayte. Se mos është ndonjë gjë joshëse, që të të ngjallë kënaqësi të mësuarit, detyrim është. Tek e fundit, kur s'ke ndonjë gjë tjetër më të bukur me se të merresh, studion tekstet e shkollës. Mua s'më bënin dobi.

E lashë fare shkollën. Se mos qe edhe ndonjë shkollë për të qenë! Mbaroje teknikumin dhe pale nga syrdiseshe pastaj. As që mund ta merrja me mend se si mund të largohesha nga Tirana. Jo, jo, më mirë pa atë shkollë dhe brenda në Tiranë. Do të gjeja ndonjë punë sa për të marrë rrogën, si gjithë të tjerët.

Përsëri te nusja e dajës. Midis dajës e së shoqes u zhvillua një debat i ashpër në lidhje me punën time. Unë dëgjoja.

— Nuk është mirë kështu, — thoshte daja. — Duhet të vazhdojë shkollën. Kemi bërë gabim që e kemi llastuar e përkëdhelur deri tani.

— Ohu, edhe ti! — ia bënte e shoqja. — Gjithnjë në një vrimë i bie fyellit. Dynjaja bëjnë çmos për njerëz që s'i kanë gjë fare, dhe jo ti, s'qenke i zoti të rregullosh tët mbesë.

Daja u përpoq që unë të mos e lija shkollën, por, si nuk doli gjë, më rregulloi në punë si daktilografiste; indirekt kishte ndërhyrë edhe Ariani. Nuk qe punë e keqe. Mbi të gjitha, tani merrja rrogën time. Hatibi s'më thoshte dot: «Nuk shpërblen dot as sakrificat që bëjnë të tjerët për ty», siç bënte kur veja në shkollë. Jeta për mua mori tjetër drejtim: Shtëpi — punë — takim me Arianin.

Dalngadalë zura të mendoja se nuk isha më ajo e para, kisha ndryshuar shumë.

Pasi mbushëm vitin që u njohëm, u grindëm për herë të parë. E pse u grindëm? Kot fare, duke diskutuar rreth një filmi. Unë kundërshtova mendimet e Arianit, dhe atij i erdhi rëndë, prandaj edhe më pyeti:

— Sigurisht, edhe ti nuk bën shumë dallim prej heroinës së filmit.

I dola përpara dhe e ndalova.

— Hiç mos u çudit, — tha. — Sot ti merr guxim të më bësh kundërshtimin e parë, nesër të dytin, më vonë mund të kalosh më tej. Kështu vijnë këto, me radhë. Dhe harron pastaj se unë të hapa sytë...

Më mirë të më kishte qëlluar me pëllëmbë fytyrës, sa të më thoshte ato fjalë.

U largova prej tij e zemëruar, duke qarë.

Të nesërmen u takuam përsëri e përsëri u grindëm.

Pak nga pak na u bë si ves: nuk mund të rrinim pa u takuar me njëri-tjetrin dhe as pa-u grindur kur takoheshim.

Ndërkaq njerëzit e farefisit tim u vunë në lëvi-

zje, të gjithë të shqetësuar. E kishin marrë vesh dashurinë tonë.

— Në qoftë se duheni, shpalleni fejesën. Dashuritë e gjata s'kanë përfundim të mirë.

Ky ishte thelbi i të gjitha këshillave që më jepnin. Deridiku kisha filluar t'u jepja të drejtë, po, që t'i thosha Arianit «fejohemi», kurrën e kurrës...

... Erdhi koha që punën e daktilografistes ta bënte një nga nëpunësit dhe mua më hoqën nga puna. Më dërguan në prodhim. Kjo s'më pat vajtur ndonjëherë ndër mend.

Kësaj radhe daja s'pranoi të më ndihmonte. Çudi si ndryshojnë njerëzit. I këputi një të sharë së shoqes, që, si gjithmonë, zuri të ndërhynte dhe t'i lutej, sa që ajo vetë e di si doli nga dhoma.

— Filloje nga e para, çupë e dajës, me kazmë. Duhet ta çash vetë një copë rrugë në jetë, sepse deri tani ke kaluar mbi gjurmët e të tjerëve.

Ishin çaste shqetësimi për mua. Iu luta edhe Arianit të ndërhynte për ndonjë punë tjetër. Ai mblidhte supet. Të jepte përshtypjen se nuk i interesonte dhe aq ajo punë. E ndieja se midis nesh ndihej ftohësia.

Nuk kisha aspak dëshirë të paraqitesha te zyra e punës në këshillin e lagjes. Por, së fundi, shkova edhe aty.

— Në ndërtim, — qe përgjigjja.

— Ku? Në llaç?

Ai hoqi syzet dhe më shikoi si i habitur.

— Ç'është gjithë kjo përbuzje për punën, moj vajzë?

— Ehu, për t'u mbushur mendjen të tjerëve ju duket kollaj juve. Pa shko vetë njëherë dhe puno në llaç, po ta mbajti! — Isha bërë furtunë.

Ai çuditërisht qëndronte gjakftohtë. Më tregoi duart e tij.

— I shikon këto? — tha. — Kanë filluar të punojnë në kovaçanë qysh kur ishin të njoma. Tani punën e zyrës nuk e bëjnë aq me qejf, por i detyroi ekzema.

— Po shumë mirë që ke punuar, ti burrë je.

— Si, pse, pak gra punojnë në ndërtim?! Edhe vajza ime mbaroi gjimnazin, po atje, në ndërtim e gova, për ideal! Ta shikosh tani, gjithë shëndet e gjallëri është.

E përplasa derën dhe ika gjithë nerva. Koka më ziente, shkoja nga më çonin këmbët. Për të dhënë mend, të gjithë të vetmit janë. Kështu mburren disa: «Kam punuar edhe unë, ja me këto duar». Ke punuar, po tani më zhulatesh aty në zyrë dhe pret e përcjell njerëzit. Ashtu mburret edhe daja im: «Bari delesh kam qenë». Ke qenë bari delesh po tani ke goxha punë. Edhe Ariani e përmend sa herë: «Jam rritur i varfër, jetim, se babai më la qysh gjashtë muajsh dhe iku në kurbet». I ati, vërtet, iu copëtua kurbeteve, derisa la edhe kockat andej, po kursimet, që i ka hequr nga goja e tij, ia dërgoi të birit, që bredh me mua si i do qejfi. Të gjithë në rregull e kanë për vete. Hatibi është mësues historie në shkollë nate. Të shoqen e ka llogaritare. Edhe nëna ime, që punon kuzhiniere, ankohet çdo mbrëmje: «U lodha». Posi, zor i madh fort, po ajo gjellë ka gatuar gjithë jetën, edhe kur ishte në fshat. Dhe pastaj të gjithë më bëjnë moral mua. «Duhet t'i shtrohesh punës. Je mësuar e përkëdhelur, e llastuar ti. Duhet të derdhësh djersë...» Nga të gjithë, e di kush më çudit me qëndrimin e tij? Im atë. Ai, në moshën dyzetetëvjeçare, mbaroi Institutin Bujqësor edhe tani, megjithëse ka mbushur mo-

shën për të dalë në pension, akoma punon në një kooperativë të bashkuar malore. Po edhe kjo ka arsyen e vet. Babai e ka pasion bujqësinë.

Këto mendime më vërshonin në tru dhe më dukej sikur nuk ecja mbi pllakat e trotuarit, por sipër këtyre mendimeve.

Shkova të bisedoja me Valin, që e kam pasur shoqe në teknikum. Për të kisha dëgjuar fjalë të mira, bile edhe në gazetë pata lexuar që e lavdëronin dhe do të ketë aq kredi, thashë me vete, sa të më rregullojë ndonjë copë punë për të qenë. Mirëpo, mundim i kotë, as atje nuk doli gjë.

— Po deshe, hajde puno në brigadën time, — tha Vali, — do ta kesh më lehtë se në ndonjë brigadë tjetër...

Tani e kuptova se sa boshe paskan qenë ato mendimet e mia, jeta ime, krenaria ime e dikurshme. E pse krenohesha? Sepse isha e bukur! Hajde, hajde, ç'bu-dallallëqe! Vali, për shembull, nuk është e bukur, po unë vete i kërkoj ndihmë. Ajo është gati të më ndihmojë brenda mundësive. Nuk më mban fare mëri ajo, që dikur e nënvleftësoja, dhe nuk më krenohet. Edhe unë do të isha teknike, njësoj si shoqja ime, po të kisha vazhduar shkollën. Por ç'e do, të shkuara të harruara... Megjithëse nuk u harrokan!

KUJDES NGA DIONISI, VITORI!

(Tregon Festimi)

Vitoria erdhi dhe filloi punë në brigadën tonë. Do të transportonte tulla me karrocë në seksionin e dytë.

Atë ditë në brigadë ka pasur njëfarë qetësie. Kështu ndodh gjithmonë te ne, kur vjen ndonjë pjesëtar i ri në brigadë. Prandaj edhe Kiçoja ditën e parë që erdhi Vitoria foli më pak se kurdoherë. Edhe shakatë e romuzet midis njëri-tjetrit qenë më të kufizuara. As Qanija nuk këndonte atë ditë. Gjithkush punonte pa u ndier. Kjo qetësi u vendos në mënyrë të vetvetishme, si për të ndihmuar punëtoreshen e re që të mund të përqëndrohej vetëm në punë dhe te vetvetja, derisa të ambientehej.

Vazhdonim të punonim në katin e dytë. Kishim marrë në brigadë edhe dy punëtorë të tjerë, Kostaqin, një djalë të ri, dhe Avniun, rreth të dyzetepesave. Këta kishin ardhur gati dhjetë ditë para Vitorisë. Në katin e dytë furnizimi që më i vështirë, pasi kryhej me skela; vinçi akoma s'na kishte ardhur.

Vitoria e shtyn karrocën e parë sipër dërrasës së ahut, që që shtruar mbi soletë, disi e druajtur, e ngathët, e pasigurtë në vetvete. Pa bërë as pesë-gjashtë hapa, karroca i doli nga dërrasa, ajo nuk e mbajti dot dhe tullat u derdhën sipër soletës. Kjo u tremb. Ta shihje se ç'pamje i kishte marrë fytyra atë çast dhe si i rrotullonte sytë nëpër të gjithë punëtorët e ustallarët e brigadës, të vinte edhe keq, edhe për të qeshur.

— Nuk ka gjë, jo, — i tha Besimi dhe u afrua t'i ndihmonte për të ngritur karrocën. Pastaj vendosi edhe një dërrasë tjetër pranë së parë, që rruga e karrocës të bëhej më e gjerë.

Javën e parë Vitoria e pati shumë të vështirë. Duart i dhembnin, se iu hëngrën nga tullat, pothuaj të gjithë gishtërinjtë i lidhte me fasha. Sa herë që kapte karrocën, dridhej. Dorezat nuk i mbante dot. Di-

tën e gjashtë nuk erdhi në punë. Thamë se kaq munda t'i duronte vështirësitë. Nuk na vinte aspak mirë që të largohej. E biseduam me njëri-tjetrin dhe vendosëm që të dërgonim Valentinën në shtëpi të saj. Ajo shkoi bisedoi me të dhe të nesërmen, ditën e shtatë, Vitoria erdhi. Duart i qenë shëruar pak, krahët e mesit nuk i dhembnin shumë dhe ndihej më e lehtësuar.

Dalngadalë zuri të mësohej. I kaluan druajtja e ngathtësia, mirëpo shakatë, romuzet që i hidhnim në shoku-shokut sikur nuk i honepste dot. Sidomos zemërohej kur i thërrisnin ustallarët:

— Hajde, tulla!

S'e kishte të lehtë të ambientehej.

Me mua mbante tjetër qëndrim, bisedonte më e shpenguar, më me ngrohtësi, megjithëse edhe unë s'bëja dallim nga të tjerët, isha njësoj si të gjithë shokët. Po me mua ndryshonte puna. Nuk qe çudi se, po të mos ishim unë e Valentina që dolëm të njohur me të, ajo mund të mos qëndronte në brigadë.

— Çudi ç'njerëz! — më thoshte Vitoria për shokët e brigadës, kur bisedonim duke dalë nga puna. — Dinë vetëm të punojnë si hamej e të flasin si pa të keq, ç't'u vijë për mbarë.

— S'ke faj ti, s'e nuk i njeh, — ia ktheja. — Janë shumë të mirë, të gjallë e gjithë humor.

— Humor i trashë, — fliste, duke përveshur buzët.

— Po shiko, se këtu përfshihem edhe unë. Po ty të vjen zor ta thuash këtë, ngaqë dolëm të njohur, — thashë me të qeshur.

— Jo, jo, me gjithë mend. Edhe ty, si mua, halli të ka prurë në ndërtim. Ke një nënë plakë që duhet

mbajtur me krahët e tu. S'të kanë lënë kusuret të vazhdoje shkollën e të dilje inxhinier, doktor... të zije një punë më të mirë.

Më inatosi. U përmbajta vetëm sepse mendova që grindja do të ndikonte për keq tek ajo, do të dëshpërohej e do të largohej nga puna. Por megjithatë i thashë se mua puna s'më ka penguar aspak për të vazhduar shkollën, kam mbaruar gjimnazin e vazhdoj Fakultetin e Inxhinierisë, në vitin e tretë.

— Se, që ta marrësh vesh ti, shoqja Vitori, unë i dua këta shokë, këta punëtorë që ti i përbuz, njësoj si veten time, në mos më shumë. Dhe, po të mos i kisha këto ndjenja, këtë dashuri për punën e për shokët, si njeri, me siguri do të isha më i vogël nga ç'jam. Unë dhe të gjithë ne nuk i çmojmë njerëzit nga puna që kanë, por si e kryejnë atë punë. Nuk i shikojmë shokët nga pozita apo profesioni që kanë, por nga marrëdhëniet, nga sjellja në shoqëri.

Ajo ndofta nuk e priste gjithë këtë ligjëratë dhe më vërejti si me habi, po vura re se nuk i bënë shumë përshtypje fjalët e mia.

— Është e qartë, — tha mospërfillëse, — derisa ha bukë me Pandin, s'do mend se njësoj si ai do flasësh.

— Pse, ç'ke për të thënë për Pandin? — e pyeta.

— Aman! Ai të merr frymën me gjithë atë optimizëm që ka. — Pastaj u mendua për një çast. — Vetëm çuditëm me të: ku i gjen gjithë ato forca? Dy vjet ka shkuar e ka punuar në fshat vullnetar. Sigurisht vështirë e ka pasur. Tani erdhi përsëri këtu dhe s'pushon një çast. Më thoshte një ditë, se edhe gruas i ndihmon në punët e shtëpisë. Mirëpo, ç'e shtyn, xhanëm, ku i gjen gjithë ato forca?

«Pozitivja ka filluar ta brejë përbrenda, po e vë në lëvizje dhe e shtyn që të thellohet», mendova.

— Pandi është i zoti t'i gjejë forcat te shokët.

— Po pse, ç'kanë bërë shokët për të?

— Shokët kanë qenë gjithmonë me të.

— Oh, ç'na e mbushe mendjen! Ai ka qenë dy vjet në malësi, ju, shokët e punës, ishit këtu.

— Ai dhe të tjerët që shkuan vullnetarë, s'kanë qenë kurrë vetëm. Edhe atje ku shkoi, gjeti shokë të tjerë.

— E ç'fitoi Pandi për vete nga këto që thua ti?

Kishim qëndruar buzë trotuarit dhe merrnim e jepnim me njëri-tjetrin. Dy rrugëtarë, që kaluan pranë nesh, na vërejtën me vëmëndje. Kushedi, kanë kujtuar se jemi ndonjë çift dashnorësh që grin-demi. E ula zërin.

— Dëgjo këtu, Vitori! Të gjitha këto dyshime dhe çoroditje në mendime, ty të vijnë sepse i kap çësh-tjet përciptazi. Pastaj, disa nga fjalët që më the mua tani, ngjajnë si të huajtura nga Dionisi, nuk janë të tuat. — E kisha vënë re se i hahej muhabeti me të.

— Mirë që e përmende vetë; disa herë jam matur të të them, por e kam harruar. Dionisit kot i bini më qafë. Ai është më me kulturë, këtu...

— Atë kulturë që ka, ta hajë me bukë. Ti vetëm një gjë ki kujdes: Dionisi nuk është njeri i mirë... Kujdes nga Dionisi, Vitori!

Ndërkaq u ndava me të, sepse do të shkoja për punë vullnetare në lagje. Si bëra disa hapa, se ç'më shkrepri dhe u ktheva të shikoja Vitorinë. Ecte kokulur. Kushedi ç'mendonte.

NJË DITË ME SHI

Andej nga ana e detit vetëtinte pareshtur. Nuk më pëlqente ky shi. Të nesërmen do të betononim shkallën e katit të dytë. Duhej bërë medoemos ajo punë.

Pikat e para të shiut filluan kur isha duke ngrënë bukë. Padashur e lëshova pirunin sipër pjatës.

— Ç'pate, — më foli nëna.

— Filloi shiu, — iu përgjigja, duke e marrë përsëri pirunin.

— S'po të marr vesh, mor bir, se ç'ngjet me ty. Po shiu atë punë ka, sikur kemi njeri përjashta.

— Kemi betonin, moj nënë.

— Hajde, hajde, se nuk i dihet gjer nesër. Ishalla ndërron moti e bëhet kohë e mirë.

«Ashtu qoftë», thashë edhe unë, por asnjërit s'na u dëgjua fjala. Shi u ra gjithë natën dhe të nesërmen vazhdonte e, me sa dukej, s'donte të pushonte gjithë ditën.

Si zakonisht, shkova herët, sepse mbaj çelësin e dhomës ku lëmë rrobat e punës. Njëri pas tjetrit erdhën të tjerët.

U ngrita të shikoja nga dritarja. Pikat e shiut që binin në një pellg të vogël para ndërtesës, po bëheshim më të shpeshta. Pranë meje qëndroi edhe Valentina, duke shikuar në të njëjtin drejtim.

— Vështirë të bëhet betonimi i shkallës, — tha ajo.

Unë e shikova, pa ditur ç't'i thosha. Betoni që porositur të vinte, kurse shiu s'po pushonte.

— Do të shkoj të flas në telefon që të mos e sjellin betonin, — foli përsëri teknikja dhe u nis për nga

dera. Në atë çast u ndie boria e një makine. Pas saj një zë:

— Eeej! Godina shtatëmbëdhjetë, ku e doni betonin?

Valentina ndali në vend.

— Ama, e gjetët. Betonohet bukur në shi, — dëgjova zërin e Kiços.

— Po deshe, — u hodh Dionisi. — Vjen e ta shkar-kon makinën aty ai dhe çan e ikën. E preu se do të la-gesh ti!

— Nuk kam hall se lagem, po uji i shiut e lan çimen-ton e mbetet vetëm zhavorri, — kundërshtoi Ki-çoja.

— Aty është e keqja, — tha Vali me zë të ulët, si-kur të fliste me vete. — As rregullat teknike s'e le-jojnë betonimin në shi.

— Eee! Ka njerëz godina shtatëmbëdhjetë, apo jo? — u dëgjua zëri i shoferit. Dolëm me Valentinën dhe Pandin. Pas nesh erdhën Besimi, Manoli, Emini.

— Shyqyr që u dukët, — thirri shoferi. — Më ngjirët së bërtituri.

— Për betonimin e shkallës e ke sjellë? — pyeti teknikja.

— Marka 170 është, — foli shoferi si pa kokëçar-je. — Ju, po të doni, shtrojeni për kalldrëm. Unë zba-toj urdhrin e përgjegjësit tim.

— Po të të kishin urdhëruar ta mbushje me bal-të e ta sillje këtu, ashtu do të bëje? — ia prita unë.

— Edhe me ç'të duash do ta sillja, — foli me zë të vrazhdë dhe më shikoi egër.

Më inatosi sjellja e tij, po e mblodha veten, kur e pashë të zhyer gjithë baltë, Me sa dukej, do t'i ki-shte mbetur makina në ndonjë llucë, do të qe lodhur dhe prandaj ishte i mërzitur.

— Pse mërzhitesh ti, ne s'të kemi gjë borxh, —
kërceu Besimi. — Punën ta bësh siç duhet dhe pa e
prishur gojën.

— Je më qejf ti, o vëlla, tani dole nga furriku.

Besimi nuk gjeti me ç'fjalë t'i përgjigjej.

— Ky beton nuk bën për shkallën, — tha Vali. —
Është larë krejt nga shiu. Tani as marka 90 s'ka mbe-
tur. Ta përdorim për shtresë në dhomat. Lajmëro në
«Nyjen e betonit» që të mos përgatisin tjetër për ne,
— i tha shoferit.

— Oho, s'kthehet më, — u përgjigj ai. — Sa të
vete unë, e gjej gati makinën tjetër.

— Unë kështu të them, — bërtiti ajo e nxehur. —
Nuk lozim këtu. S'është e mundur të bëhet betonimi
i shkallës në këto kushte.

— Kot më hakërrrohesh mua, moj shoqe. S'marr
vesh unë nga punët teknike. Për timon, po.

— Mirë, më prit këtu, mos ik sa të vij unë, — dhe
bëri për nga zyra e përgjegjësit të sektorit, ku kishte
telefon. Erdhi pas disa minutash.

— Si t'ia bëjmë, — tha, — ata të «Nyjes së beto-
nit» nuk binden që ta kthejnë. Do të na shkojnë kot
pesë makina beton.

— Hajde nisemi, — i tha shoferit, që e kishte
shkarkuar makinën dhe priste tekniken tonë. — Po
vij të bisedoj vetë me të.

— Dale, prit, — foli Pandi. — Të mundohemi
mos gjejmë ndonjë mënyrë ta bëjmë sot betonimin.

Të gjithë shikuam atë. Edhe shoferi, që pak më
parë qëndronte i mërzhitur, e shikoi me interes Pan-
din. Shiu vazhdonte të binte rrëmbyeshëm. Rrëketë
e ujit na kalonin nga flokët, nëpër fytyrë dhe fute-
shin nën jakat e këmishëve, nën zverk. Por e harru-

am shiun, kur dëgjuam Pandin të thoshte se mund të bëhej betonimi, edhe pse binte shi.

— Hë, mo Pandi, si do t'ia bëjmë? — S'më durohej sa të merrja vesh ç'propozonte ai.

— Po ja, të përpiqemi të gjithë të gjejmë mënyrën, — u përgjigj.

— E dini, mua më ka rënë diçka në mendje, — foli Manoli, duke hequr lapsin e trashë nga veshi dhe me të në dorë u drejtua për nga rrampa e shkallës.

U afruam të gjithë pranë tij.

Ai bëri një skicë. Vizatoi shkallën dhe një mbulesë me letër katramaje, të mbërthyer në disa lista. Këtë e lidhte pastaj me një mbulesë tjetër si «U» deri te vendi ku shkarkohej makina. Mendonte që atje të ngrihej një tendë tjetër.

— Ide e shkëlqyeshme, — thirri Besimi.

— Po mirë, makina zbuluar do të rrijë? — u hodh shoferi.

— Mos u bëj merak, — tha Manoli, — do të mendojmë dhe për të.

Shkuam katër vetë dhe morëm dy topa letër katramaje. Më parë mbuluam makinën. Shoferi mbeti i kënaqur. Hyri në kabinë dhe u nis duke kënduar.

— Tani të ndajmë forcat, — tha teknikja. — Manoli, Besimi dhe Estrefi të merren me mbulesën, ne të tjerët të hedhim betonin brenda në dhomën që do të shtrojmë.

Kur shkova për të marrë lopatat, dëgjova Dionisin që po ankohej nga reumatizmi. Vetëm ai dhe Victoria kishin mbetur pa u lagur.

— Dioniskë, të erdhi vdekja më duket. Të ka zënë përdhësi në kokë, — i bërtiti Kiçoja. — Hajde, se të del tani nga betoni.

— Pa më lër rehat edhe ti, për kokën tënde. Unë kam keq shpirtin, ti ç'më 1lafos.

— Mor, do të vish të punosh, apo jo?

— Ehu, edhe ti, Kiço! Sa i mirë je zakonisht, aq i keq bëhesh nganjëherë. Jam sëmurë, mor vëlla, më beson apo jo?

— Mos e fol atë fjalë, ore! Ty të të besoj unë?!

— Pse i bini në qafë një njeriu gjithmonë, — foli Vitoria. — Kush është më i fortë, punon në shi, kush s'mundet, s'punon dot.

— Shyqyr, moj çupë, që i dole krah Dioniskës.

Në dhomë hyri Valentina, që mbante një lopatë në dorë. Kur e pa atë ashtu të lagur dhe të bërë qull, u ngrit edhe ajo. Për Dionisin pastaj u bë e pamundur të rrinte brenda në dhomë. Doli nga dera duke mbajtur kërbishten me dorë.

Betoni ishte zbrazur afër dritares dhe e hodhën shumë shpejt brenda. Ndërkaq edhe skuadra e Manolit e mbaroi mbulesën.

Erdhi makina tjetër me beton. Lopatat e përcillnin njëra pas tjetrës nëpër karroca, në skela e drejt në armaturë. Mbas dy orë e gjysmë shkalla e katit të dytë u mbarua së betonuari dhe brenda rregullave teknike.

Kur dolëm nga mbulesa prej letre katramaje, shiu, që vazhdonte njësoj si më parë, na lante djerstët sikur donte të na hiqte, bashkë me të, shenjat e lodhjes.

Vitorinë e futëm që të mësonte për muratore. U caktua të punonte midis meje dhe Kiços. Ortakut tim nuk i erdhi mirë që të kishim midis një ndihmëse.

— Ehë! — thoshte. — Mos i bini, bre, murit më qafë. Pse, duart e saj do të plotësojnë metrokubshet?

— Po duart e saj shtyjnë karrocën, o Kiço.

— Ama, tani ma zure gojën. E di unë sa me qejf e ka ajo këtë punë. Në rastin më të parë, sa të gjej një punë tjetër dhe të lë shëndenë.

U mundova shumë që t'ia mbushja mendjen. Më në fund u bind, sepse qe vendimi i brigadës që Vitoria të punonte bashkë me ne.

Ditën e parë ndihmësja jonë nuk mundi të vendoste as pesëdhjetë tulla dhe pothuajse të gjitha Kiçoja ia lëvizi nga vendi. E vija re që ajo mërzitej shumë, sidomos nga të bërtiturat e tij. Psherëtimat i nxirrte si t'i kishte lidhur me ndonjë fije spango, dhe anën e kësaj spangoje ta tërhiqte Kiçoja duke bërtitur:

— Vëri mirë ato tulla, se nuk janë rruaza, që t'i vendosësh ashtu, hark, si në gjerdan.

Të nesërmen Vitoria kapi karrocën dhe s'guxonte në asnjë mënyrë të vendoste tulla në mur.

— E bëre një punë të mirë, — i thashë Kiços.

— Ama, ç'dërdëllis edhe ti! Po pse, ore, unë ia mbajta duart? Ja ku është muri dhe le të vijë të punojë. Po të bëjë mur, ama, të drejtë, jo të rrumbullakët, se e kemi shtëpi banimi, jo oxhak fabrike.

— Duhet durim në këto punë.

— Mos ma thua j mua këtë, po asaj çupërlinës që, hem s'di, hem zemërohet. Pastaj, pse të bëjmë llafe kot ne të dy. Gratë janë të zonjat për të qëndisur, po jo për të bërë mur.

Ec e mbushja mendjen Kiços, po deshe. Kur i hipën në kokë atij, e ka si mushka.

— S'ka, mor vëlla, era e llaçit nuk e duron dot erën e livandos, — thoshte.

Mirëpo ndodhi diçka, që e bëri ta ndryshonte edhe këtë mendim.

Në brigadën tonë erdhi të bënte punën fizike Peço Guri, një shok që punonte në Këshillin Qendror të BP. Kiçoja e njihte Peçon, Bashkë kishin qenë partizanë. E kishte pasur komisar kompanie. Sa e pa që hyri në dhomën tonë mëngjesin e ditës së parë, iu hodh në qafë, u përçafuan si miq të vjetër.

— Po këtë, për se e ke marrë, apo për govatë llaçi? — i tha Kiçoja Peços, për kapelën republikë që mbante në kokë.

— Akoma s'i ke lënë këto ti, a derëbardhë! Na, se po ta dhuroj këtë kapelë, — dhe ia vuri në kokë. Kiçoja e ngjeshi deri te veshët dhe pastaj u drejtua për nga pasqyra. Mori një pozë që, sa e shikoje, të merrte gazi.

— More, po ta shtoka me gjithë mend paraqitjen, u dukërkam alamet burri kështu, — tha duke shikuar veten në pasqyrë. — Po jo, kjo nuk shkon për këtu. Unë e mora vesh që do të vije te ne për punë fizike dhe të prisja me kominoshe, kurse ti më paske vënë një kapelë sa një saç.

— E kam marrë edhe pajën e punës fizike me vete, — tha Peçoja, duke nxjerrë kominoshet nga çanta që mbante në dorë. — Do të punojmë bashkë, o usta Kiço, të më mësosh zanatin.

— Eh, edhe kjo m'u desh mua. Pak e kam këtë, — dhe me dorë tregoi Vitorinë. — Po na edhe një peshqesh tjetër.

— Pse, nuk ke besim tek unë?

— Për laps e për agjitacion po, të than, pa për mistri jam vetë unë.

Filluam nga puna. Midis meje e Kiços punonin edhe Vitoria me Peçon. Vitoria, që ishte nga ana ime,

nuk ndihej, përqëndrohej e gjitha në punë, por pak e druajtur, e pasigurtë në vendosjen e tullave.

— Ej, shoku Peço! Ç'ma bën murin ashtu dhëmbë-dhëmbë, sikur hap tarraca, — bërtiste Kiçoja. — Fute, mor, atë tullë më brenda se më luajte spangon! Po ti, mor, pse ma kyç gojën ashtu, — më hakërrohej mua. — Nuk e shikon atë çupën, që ta ka bërë rreshtin e tullave si kular? — Zbriti nga skela dhe doli nga ana tjetër, përkarshi nesh. I rrudhi buzët. — S'është punë kjo, jo! — Hipi lart dhe i prishi dy rreshta në pjesën e të dy ndihmësve.

Vitoria vuri duart kryq dhe qëndroi si e ngrirë. Ishte në mëdyshje: të vazhdonte të punonte, apo jo.

— Mos u mërzit. Durim e këmbëngulje, — i dha zemër Peçoja. — Këta dy rreshta ndreqeshin edhe pa u prishur fare. Si thua ti, Festim?

— Po edhe ndreqeshin...

— E di unë, e di, prandaj them. Usta Kiçoja është cazë konservator në dhënieën e zanatit e do që të na mërzisë.

— S'kam ndër mend t'ju mërzis po t'ju kalis.

— Po kështu të thyhet vullneti fare, — foli Vitoria, që deri atëherë s'e kishte hapur gojën.

— Kujdes, mos u ngjish shumë pas murit, se mos të prishet hekuri i tutave, — e shpotiti atë Kiçoja. — Bela me këta të rinjtë e sotëm, iu drejtua Peços. — Edhe në punë, të hekurosur e të krekosur i ke.

Vitoria mbeti e zënë ngushtë dhe, megjithëse që bërë me llaç te gjunjët, nuk e shkundi si zakonisht.

Kiçoja punonte shumë i shqetësuar. Brengoset së tepërmi kur ka pranë një njeri që i duhet ta kontrollojë herë pas here.

— Të mos bëjmë gjë tjetër ne, — shfrynte herë pas herë, — po të shikojmë ndihmësit, se mos na e bëj-

në murin me bark të fryrë, si të burokratëve.

— E ke bezdi, kur mëson të tjerët, — ia priste Peçoja. — Harrove se ç'kemi hequr kur mësova shkrim e këndim.

— Lëre, lëre, — tha Kiçoja, i prekur nga ky kujtim. — Çfarë kohe ka qenë atëherë! Kërciste pushka e të digjte baroti, dhe lapsin e fletoren s'i ndaje nga dora.

Mistria i shpëtoi nga dora dhe i ra poshtë, nën skelë. Si duket iu kujtua diçka e dhembshme nga koha e luftës. Nuk mund ta merrja me mend se ishte kaq i ndjeshëm.

Nuk i erdhi mirë që e pamë ashtu. Qëllimisht nuk i tha ndonjë punëtori t'ia sillte mistrinë, po zbriti vetë nga skela dhe e mori, sa t'i kalonte ajo tronditje që e kishte pushtuar.

— Kemi pasur një shok shumë të mirë, që u vra, — na tha mua e Vitorisë Peçoja me zë të ulët, — Lefter Toçi e kishte emrin. Me Kiçon duheshin pa masë. Ai e mësoi të shkruante. Kur u vra Lefteri, Kiçoja ndënji tri ditë pa vënë bukë në gojë.

Ndërkaq erdhi Kiçoja. E zotëronte disi veten. Pas kësaj, të katër vazhduam të punonim në heshtje. Vëreja Vitorinë, që mundohej t'i shpejtonte duart dhe në të njëjtën kohë mendohej thellë. Kushedi ç'mendonte me vete. Kështu janë njerëzit: punojnë dhe jetojnë bashkarisht, por secili mendon veças.

— Sa e çuditshme, — më tha pas një heshtjeje të gjatë. — Këtu në punë i njeh njerëzit. Ky Peçoja qenka njeri i mirë.

Ortaku im dhe ndihmësja jonë sikur e ndienin veten larg njëri-tjetrit. Kiçoja s'kishte besim se mund ta honepste dot Vitoria punën e ndërtimit. «Është e ashpër kjo punë për atë lëkurë të butë», thoshte.

Nga ana tjetër, edhe Vitoria mpihej e ndrydhej kur dëgjonte të bërtiturat e tij. I hipte një farë zemërimi dhe pranonte më mirë të mbante tulla me karrocë gjithë ditën, sesa të vendoste tulla nën mbikëqyrjen e usta Kiços... Mirëpo ditën e nëntë Vitoria e bëri një copë mur shumë mirë, aq, sa s'dallohej fare nga ai i Kiços. Atëherë ortaku im s'u përmbajt. E zuri për supesh dhe e puthi në ballë, si ta kishte vajzën e tij. Atëherë Kiçoja u kujtua edhe për diçka tjetër.

— Ore, po paskemi qenë të humbur ne, — tha. — Si nuk i ka rënë ndër mend asnjërit për Tahirin, që e kemi lënë të punojë gjithnjë vetëm dhe asnjëherë nuk e ka realizuar normën?

Mua këto fjalë më erdhën si një e pickuar gre-rë. «Hajde brigadier, hajde», thashë me vete. «Prit sa të të zgjojnë të tjerët nga gjumi».

Qysh atë ditë Tahiri punoi midis Estrefit dhe Idrizit. Dhe a e dini çfarë? Qysh ditën e tretë mundi të bënte po aq mur dhe aq mirë, sa edhe shokët...

Një mbrëmje shkuam të gjithë së bashku në kinema. Biletat na i mori Pandi. Unë e kisha vendin pranë Vitorisë. Kur po bëheshim gati të uleshim, pashe Idrizin që më qëndronte përpara dhe sikur deshi të më thoshte diçka, por s'kishte kurajë.

— Mor po fol, — i them, — ç'hall ke?

— Jo, mo, s'është ndonjë gjë kushedi çfarë; po deshe, t'i ndërrojmë biletat bashkë...

S'm'u ndenj pa vënë buzën në gaz. Idrizi u ul pranë Vitorisë. Ajo i buzëqeshi atij.

Të nesërmen nga kantieri ynë do të niseshin vullnetarët për në hekurudhën Elbasan-Prrenjas. Bashkë me ta do të shkonin edhe Vitoria me Idrizin.

Ishim gati në përfundim të katit të tretë dhe fronti i punës ishte ngushtuar disi, sepse s'kishin ardhur akoma hekurkthyesit për armaturën e shkallës së këtij kati, që pastaj të kryenin betonimin më tej e të vazhdonin në katin e katërt.

Një ditë, në mëngjes, kur po ndaja forcat, Dionisin e caktova të dizarmonte armaturën e katit të dytë.

— Bah, në asnjë mënyrë nuk e bëj këtë punë, — më kundërshtoi.

— E përse?

— Pse nuk e bën vetë ti, po më cakton mua?

— Po ç'të keqe ka, pse nuk do ta bësh ti?

— Si, ç'të keqe ka? Bën sikur nuk e di ti. Harrove se në ç'kushte është betonuar kjo shkallë?

— Në kushte normale është betonuar, — ia ktheva. — Megjithëse atë ditë ra shi, ne i morëm të gjitha masat që të mos futej asnjë pikë ujë në beton.

— Kjo vlen vetëm sa për të justifikuar veten, — vazhdoi ai. — Unë nuk e bëj dot këtë punë. I kam shpatullat të dobëta, edhe për peshën e betonit që mund të më bjerë kurrizit, edhe për përgjegjësinë.

— Nuk ka për t'u shkëputur asgjë. Edhe përgjegjësinë e mbaj unë.

— Jo, nuk e zbatoj! Bëj çfarë të duash!

Ky debat vazhdoi gjatë. Ndërhynë edhe shokët.

— S'bën mirë që kundërshton. Urdhri i brigadierit është ligj, nuk kthehet.

— Bëjeni vetë, ju ç'keni me mua, — ua kthente Dionisi.

— Ç'është kjo grindje e kotë, — tha Valentina. — S'kemi pasur herë tjetër raste të tilla në brigadë.

— Lëre, mor Festim, se e dizarmoju unë, — foli Manoli.

— Edhe unë, — u hodh Emini.

— Edhe unë, — pasoi Estrefi.

— Jo, jo, jo, — qe përgjigjja ime e prerë. — Se ç'më pat hipur edhe mua që, ose të shkonte fjala ime, ose s'ka.

Dionisi hoqi rrobat e punës, veshi të tjerat dhe iku i zemëruar. «Në djall», thashë me vete. «Punë e madhe se u zemërove ti».

Pas ndonjë ore erdhi prapë bashkë me kryeinxhinierin e kantierit, shefin e planit të kantierit dhe një inxhinier të ndërmarrjes. Kushedi ç'mund t'u kishte përrallisur atyre, derisa i bindi t'i venin pas.

Unë e fillova vetë dizarmimin e armaturës së shkallës. Kisha për të hequr edhe dy binarët mbështetës, të vendosur nga pjesa e jashtme e sheshpushimit, kur erdhën ata.

— Prit, Festim, mos vazhdo më, — thirri kryeinxhinieri.

— S'ka gjë, mor vëlla, mos u shqetësoni kot, — thashë dhe e futa levën për të hequr binarin.

— Prit, mor ti, dëgjon si të thonë, apo jo, — foli kryeinxhinieri për herë të dytë.

Ndalova. Prisja ç'do të më thoshin.

Shokët e tjerë të brigadës u bënë kureshtarë dhe u grumbulluan rreth shkallës, sikur ç'të kishte ndodhur.

— Je e bindur se e ke mirë shkallën, që lejove dizarmimin e saj? — pyeti kryeinxhinieri Valentinën.

— Po si s'jam e bindur, — u përgjigj ajo. — S'është kjo e para shkallë që kemi betonuar.

— Për është betonuar në shi, apo jo?

— Ashtu është, po ne i morëm të gjitha masat...

— Këtë do ta shikojmë tani, — tha ai i vrenjtur. — Dërgoni ndonjë të lajmërojë shefin e sektorit.

Shkoi Qanija. Pas pak shefi i sektorit erdhi.

— Po pse s'më vure mua njëherë në dijeni, pastaj të shkoje në kantier, iu shkreh ai Dionisit.

— Tani është vonë, duhej bërë më parë kjo punë, — tha kryeinxhinieri. — Tani, Festim, vazhdo dizarmimin, por avash e me kujdes, qëndro anash, — më foli mua.

Zura të veproja sipas urdhrorit të tij. Edhe mua sikur m'u lëkund ajo siguria që kisha në vetvete pak më parë. Tërë ata njerëz shikonin lëvizjen e duarve të mia. Dashur padashur më lindi dyshimi se diçka do të kishte në këtë mes.

E zbërtheva njërin nga binarët dhe e tërhoqa fundin e tij në drejtim nga vetja. Dërrasat e mbërthyera u lëkundën të gjitha së bashku dhe u përkulën, mbetën të varura. Shikova pjesën e betonit që mbeti e zbuluar nga dërrasat. Nuk kishte asnjë vrimë të vogël, dukej si të qe lëmuar me mistri. U afruan edhe të tjerët. Më shumë nga të gjithë e zgjaste kokën Dionisi, si t'i kishte vënë vetes për detyrë me çdo kusht që të gjente ndonjë gabim. I zbërtheva një nga një dërrasat e armaturës së sheshpushimit të shkallës. Të gjithë në heshtje më ndiqnin me vështrime.

— Vazhdo rrampën tani, — tha kryeinxhinieri.

Ajo ndjenjë pasigurie dhe dyshimi, që m'u krijua pak më parë, sikur u fashit. «Derisa sheshpushimi doli mirë, në rregull është puna», thashë me vete. «I njëjti beton është përdorur, dhe gjithë shkalla në të njëjtat kushte është betonuar». Vazhdova punën më i çelur se më parë. Duke hequr njëren dërrasë pas tjetrës, më shtoheshin besimi dhe siguria. Mirëpo dy dërrasat e fundit ranë vetë, pa pritur që unë të fusja levën: u rrëzuan nga pesha e një cope be-

toni që u shemb bashkë me to. Nga tronditja kërceva përpjetë, dhe leva që më shpëtoi nga duart ma dërrmoi gishtin e madh të këmbës. Dhembja s'mundi ta frenonte tronditjen time. U hodha një sy shokëve, me shpresë se do të gjeja ngushëllim, po ata ishin vetë për t'u ngushëlluar. Vetëm ai, Dionisi, e hiqte veten si më i zoti ndër të gjithë dhe si më i meçuri, më i pagabueshmi.

— Të mos rrimë sikur po e qajmë këtë punë, — prishi heshtjen zëri i inxhinierit. — Tani brigada të vazhdojë punën. Secili në vendin e mëparshëm. Do ta gjejmë shkakun e shembjes së asaj cope betoni dhe fajtorin...

— Fajtori gjendet kollaj, — kërceu Dionisi. — Ai që ka betonuar në atë vend. Ne të gjithë i mbajmë mend vendet tona dhe të shokëve.

Te vendi ku u rrëzua copa e betonit, kishte punuar Pandi.

— Nuk është e vërtetë, — bërtiti kryeinxhinieri gjithë zemërim. — Përfitohet nga mungesa e Pandit. Është praktikë e vjetër kjo. Në çdo rast, kur del ndonjë punë jo e mirë, hileqarët ua ngarkojnë fajin shokëve që janë larguar, që nuk ndodhen të pranishëm. Ne do ta thërrasim dhe Pandin këtu.

Pandi erdhi po atë ditë.

— Edhe te dikush tjetër të ndodhte, unë kam faj e përgjegjësi, — tha ai.

Nga analiza që iu bë betonit, doli se ajo pjesë që ishte shkëputur, qe përzier me një sasi vaji lubrifikant.

U bënë diçka supozime. Mund të kishte ndodhur që betoni të qe përzier me vaj qysh në vendin e përgatitjes. Por, po të kishte ndodhur kështu, do të qe përzier gjithë betoni dhe jo vetëm një copë e vogël.

Ndoshta që tharë ndonjë sasi e vogël betoni dhe mund t'i ishte hedhur ujë i përzier me vaj nga ndonjë pellg i afërt. Asnjërit nuk i kujtohej nëse mund të kishin pasur beton të tharë atë ditë. Makinat erdhën shpejt, sa mbarontë njëra, shkarkohej tjetra. Atëherë mbetej dyshimi i tretë: vaji të ishte hedhur me dashje sipër betonit. Fajtor mbetej ai që pat punuar në atë vend dhe praktikisht Pandi.

— Unë jam fajtor, — tha ai. — Dreqi e merr vesh si ndodhin këto gjëra.

Ne ishim të bindur se Pandi nuk e kishte bërë me dashje atë punë të keqe. Po si mund ta vërtetonim këtë bindje tonën? S'mjaftonte vetëm mendimi. Duheshin argumente. Dhe argumentet mungonin.

Përjashtim nga të gjithë shokët e brigadës bente Dionisi. Ai bërtiste:

— Ja, ç'do të thotë të rendësh pas sasisë. Janë punë me zarar këto, mor vëlla, duhen bërë me mend në kokë. Është kollaj ta heqësh veten i zoti në fillim e të mburresh: «Ne s'pyesim për asgjë. Edhe në mes të shiut betonojmë...» Po ja ç'na del në fund se!

Kishte hak ai. I vajti uji vetë në vijë kësaj here.

Neve na bëri shumë përshtypje qëndrimi i Tahirit ato ditë. Rrinte i heshtur, gjithnjë i menduar, asnjëherë s'e hapte gojën.

Mëngjesin e ditës së tretë, pas shembjes së asaj cope betoni të shkallës, Tahiri i kishte sytë të enjtur. Dukej sikur s'kishte fjetur gjithë natën.

— Kam diçka për të thënë në brigadë, — m'u drejtua mua në prani të të gjithëve.

— Hair ishalla! I qenka hapur goja murgut dhe dashka të na shtrojë probleme të rëndësishme, — thumboi Dionisi, duke u shtënë sikur gajasej së qeshuri.

Tahiri s'ia vuri veshin. Priti sa erdhën të gjithë shokët dhe filloi:

— Fajtor për atë punën e keqe, që e njolloosi emrin e mirë të brigadës sonë, jam unë.

— Ç'është ky rrëfim tani, — nuk duroi pa folur Dionisi dhe qeshi si me histeri.

— Avash, se do të të këputet rripi i pantallonave, — *ia prit Tahiri dhe vazhdoi* i qetë: — E thashë, fajtor jam unë dhe ai atje, — drejtoi gishtin nga Dionisi. — Edhe ai është, po më shumë unë...

— Hë, mo, ç'dërdëllis ti? — Dionisi s'po e përmbante dot veten. Duart padashur i dridheshin kur fliste. — Ç'të duhen këto gjëra, kush ta vë veshin ty, mor i shkretë!

— Dionis! Prit ta dëgjojmë, pastaj ta japim ty fjalën, — i tërhoqa vërejtjen.

Atë ditë, kur betonuam shkallën, — vazhdoi Tahiri, — unë hidhja beton me lopatë. Pranë vendit ku ngjishte. Pandi me vibrator u hap armatura dhe betoni po derdhej. E lashë lopatën dhe i shkova në ndihmë për të mbajtur dërrasat e sapozbërthya.

— Mbaje pak, ndihmoje dhe ti, Dionis, — tha Pandi dhe vetë shkoi të merrte gozhdë, sepse nuk kishim asnjëri pranë. Dionisi erdhi nga ana tjetër e shkallës duke mbajtur një kovë me vaj në dorë. Atë kovë e futi nën mbulesë qysh kur filloi betonimi. «E gjeta në kornizën e jashtme të dritares. E ka harruar ai shoferi i autovinçit që vendosi soletat. Gjynah, pse të prishet. Kur të mbarojmë këtu, e çoj brenda në dhomë», — më tha pa e pyetur. Dhe, kur erdhi të më ndihmonte për të mbajtur armaturën, ndërsa Pandi kishte shkuar për të marrë gozhdë, unë s'e pata mendjen t'i thosha ç'e donte atë teneqe që e gjezdiste sa në një anë në tjetrën. E vendosi kovën sipër

një dërrase, që e kishim hedhur mbi shkallë dhe që na shërbente për të vënë këmbët. Unë qëndroja në skelë anash. Duke dashur t'i liroja vend Dionisit, që të kishte ku të shkelte për të më ndihmuar, e luajta dërrasën me bërryl dhe vaji nga kova u derdh sipër betonit.

— Përzieja, që të mos duket vaji, mos e luaj më shumë, se e hëngre, të piu e zeza, — më murmuriti Dionisi.

Tahiri mori frymë thellë, sikur u lirua nga një barrë e rëndë.

— . . . Ja kështu ka ndodhur. Ishim vetëm ne të dy, unë dhe Dionisi. Shokët e tjerë, ca nga shiu, ca nga puna e lodhshme, s'vunë re gjë. Pandi erdhi pas pak me gozhdë në duar. Unë s'e mendoja se do të bëhej kështu.

— E, si ju duket juve? — mezi priti Dionisi. — A u besoni këtyre që thotë ky?

Donte të na pyeste të gjithë njëherësh, po sytë i hodhi nga unë.

Tunda kokën në shenjë pohimi.

— I besojmë. Tahirin ka dy ditë e dy net që e bren ndërgjegjja e s'e lë të qetë. Sot gjeti forca të thotë të vërtetën.

— U mendua dy ditë e dy net që të sajojë gënjeshtren. — Dionisi rrinte nën vështrimet tona tamam si një dhelpër, që i janë drejtuar majat e sfurqeve dhe i bëhen gati ta mbërthejnë përtokë.

— E shoh që ky është një kurth i përgatitur, — tha. Mjekra i dridhej si një copë llamarinë që e luan era. — Nuk i kishte të tijat Tahiri ato që tha. Një tjetër mendje më e hollë i ka kurdisur, po do ta gjej të drejtën, ta dini. — Dhe iku duke folur me vete, si i luajtur mendsh.

— Nga na u shpif ky dreq, — m'u duk sikur thashë me vete, po kisha folur me zë, sa e dëgjuan gjithë të tjerët.

— Koka bën, koka pëson, — tha Kiçoja. — Të kam thënë qysh në fillim, që mos na e mbaj atë sëmundje në brigadë.

Dionisi brodhi zyrë më zyrë: ankohej për vete dhe shpifte për ne. Andej dikush ia mblodhi rripat dhe u detyrua të thoshte të vërtetën.

Disa ditë më vonë puna e tij u shqyrtua në një gjyq shoqëror me të gjithë kolektivin e kantierit, ku merrnin pjesë edhe banorë nga lagjja e tij. E pësoi. I dolën lakrat sheshit. Edhe në lagje ishte grindavec i madh. Në të gjithë ndërmarrjen tonë kishte ndërruar kushedi sa brigada dhe kurdoherë qe larguar si i padëshiruar.

— S'mund ta heqim, — na thanë më pas. — Këtu, në gjirin e klasës punëtore, mund të edukohet më kollaj.

Dionisi ishte bërë sa një grusht.

NË PIKNIK

(Tregon Festimi)

Kemi ardhur në një vend të bukur e piktoresk, që quhe «Çarjet e Selitës». Ndoshta jemi ne të parët që organizojmë një piknik në këtë vend, po do të dëshironim që të kishim këmbën e mbarë e të vinin brigada e qendra të tjera pune të kalonin këtu kolektivisht një ditë të bukur pushimi.

Ne, punëtorët e brigadës sonë, na solli këtu Pandi. Ai ka qenë vullnetar në këto anë dhe qysh atëherë e kishte bërë ndër mend që piknikun e parë me

shokët e punës ta bënte këtu, ku kemi ardhur ne sot. «Çarjet e Selitës» janë disa livadhe të gjera në një pllajë. Nga shirat që kanë rënë pas kositjes, ka mbarë bari i ri, i njomë. Kur e shikon gjithë këtë gjelbërim në përtëritje, tani, në fund të gushtit, të ngjallet një kënaqësi që të pushton gjithë trupin. Në njërin anë të livadheve shtrihet një brez pylli prej drurësh të mëdhenj ahu. Aty-këtu, midis aheve, ka disa sheshe të vogla, të mbuluara nga hija e përjetshme. Në fund të pyllit janë tri burime në të njëjtin vend, që rrjedhin nga një mëmë dhe kanë ujë të bollshëm. Njëri nga burimet, ai i mesit, e nxjerr ujin nëpër një koritë druri, kurse dy të anës janë rregulluar me mur dhe me tuba hekuri. Siç na tregoi Pandi, koritën e drurit në burimin e mesit e kanë vendosur barinjtë. Vitet e fundit pastaj, kur erdhën vullnetarët për hapjen e tokave të reja, i ndërtuan dy të anës dhe të mesit e lanë ashtu si e kishin ndërtuar barinjtë. Përreth këtij burimi gjenden plot burime të tjera të vogla. Prandaj them që këtu është vend i bukur, me shumë burime dhe gjithë gjelbërim... Nga njëra anë e livadheve ngrihet Mali me Gropa, kurse nga ana tjetër, Mali i Jeknit. E pyeta Pandin nëse e dinte pse i kishte mbetur ky emër, «Jekën», këtij mali.

— Jekën, në shqip do të thotë i vetmuar, m'u përgjigj ai.

— Dhe vërtet, Jekni ngrihet si karakoll midis Dajtit dhe Malit me Gropa.

Këtë piknik e organizuam me rastin e përfundimit të punimeve në mesin shtatëmbëdhjetë. Afatin e dorëzimit e kishim më 31 tetor, kurse ne e mbaruam qysh në fund të gushtit.

Kanë ardhur të gjithë anëtarët e brigadës me pjesëtarët e familjeve të tyre.

Me të ndaluar makina, i ati i Besimit, një plak rreth të gjashtëdhjetave, zbriti me të shpejtë, para të gjithëve dhe nisi të bridhte livadheve.

— Dua të mbushem me këtë ajër të pastër, — thoshte.

— Korba, u xhindos plaku sot! — ia bënte e shoqja me shaka. — I kujtohet jeta e çabanllëkut. Kështu e ka kaluar të shumtën e jetës ky, brigjeve e pllajave.

Të gjithë, varg njëri pas tjetrit, me çanta e rrjeta ndër duar, u grumbulluan te burimet.

U ulëm në sheshin rreth tyre, nëpër hijet e aheve, dhe filluam të hanim mëngjesin.

— U, sa oreks që paskërkam, — thotë nëna ime. — M'u dukërka ky byreku me qepë që gatova prëmë, sikur të jetë gjella më e mirë në dynja! Rrofshi, more djem, që na sollët këtu! Këto pyje, burimet e livadhet na nxjerrin mallin e Ormanit, të fshatit tonë, moj Fatiko, — i flet nënës së Vitorisë.

Po edhe unë vetë kisha më tepër oreks se zakonisht.

— Nënë Nurka, — i thirri Vitoria, — mos e ki mendjen te muhabeti, se ta mbaroi Festimi byrekun e të la që të lëpish gishtat,

— Ulu, mor bir! Mos e fut tërë atë copë, se do të të çahet goja, — më tha nëna me shaka.

— Jo, po bëj muhabet me nënë Fatikon ti, — ia ktheva, — se nuk u kënaqe gjithë kohën në autobus.

— Epo shyqyr që u takuam, mor bir, se afër jemi, po, ç'është e drejta, nuk jemi bërë mukaet për të shkuar te njëra-tjetra.

Pas buke i vëllai i Qanijes filloi t'i binte fisarmonikës, kurse vetë Qanija i binte dajres.

— Or, po prisni të na vejë buka në vend, — foli Kiçoja.

Ndërkaq Pandi, Valentina, Besimi ia nisën valles. Vitoria e rrëmbeu Idrizin për dore dhe u futën të dy midis valltarëve.

— Çohuni edhe ju, — na tha Peçoja.

— Ç'bën, o ditëzi, se më këpute krahun! — i ankohej ajo.

— Moj, po hajde të kërcejmë, lëri nazet, — i thoshte ai.

Morën dhe nënën time për dore. Pës tyre nëna dhe babai i Vitorisë. U futën të gjithë në valle. Fisarmonika i lëshonte tingujt si të donte edhe ajo të mernte pjesë në këtë gëzim me të gjithë forcën e saj. Qanija i binte dajres aq, sa të krijohej përshtypja se nga çasti në çast do ta çante. Sheshi gjëmonte. Ngjante sikur gëzimi shpërthente nga zemrat tona dhe fluturonte sipër aheve.

Ishim duke kërcyer, kur u dëgjua zhurma e një lodre që binte nga qafa përkarshi livadheve.

— Erdhën, — thirri Pandi.

Ishin fshatarët e kooperativës, ku ai pat qenë dy vjet vullnetar. I kishte lajmëruar me telefon se ne do të vinim në piknik dhe ata erdhën ta kalonin me ne një ditë pushimi.

U takuam me ta si shokë, si miq, si njerëz që punojmë për të njëjtin qëllim dhe, merret me mend, se ia kaluan shumë mirë.

1971

KRUSHQ PA NUSE

Tregim humoristik

Gotat e rakisë rrokulliseshin njëra pas tjetrës. Njëri nga dasmorët, nga të palës së nuses, ia mori këngës: «Në bash t'qejfit të muhabetit». Me veten time gjykova se ky mik tregohej i nxituar që na bëri këtë të papritur. Ajo këngë në vazhdim thoshte: «Na vjen kafja për me u pi», kurse ne, ashtu siç i kishim zënë, donim nga një vinç secili dhe mezi të na shkulte prej rakisë. Megjithatë disa të tjerë e pasuan këngëtarin qejfli. Por ne, pjesa më e shumtë, heshtim, si të na kishte ardhur radha për të nusëruar. Faji nuk qe yni dhe asnjë fije përgjegjësie nuk mbanim, sepse të tilla këngë janë të panjohura në krahinën tonë.

Tani, ta marrim pak shtruar, që të mund të marrim vesh ç'themi. Ata që do të lexojnë këta rreshta, duhet të njihen më mua, që po ju rrëfej këtë histori. Quhem Besho Trebeshi. Jam qejfli i këngës, i rakisë e i muhabetit unë, më njohin e më dinë gjithë krahina. Ndaj më ftojnë në të gjitha dasmat e gostitë që bëhen.

Në dasmën që përmenda më parë, kisha shkuar krushk nga ana e dhëndrit në fshatin Kokërdhok.

Tetë krushq gjithsej dhe unë nëntë. Në shtëpinë e nuses na pritën sa s'ka ku të vejë më mirë. Për pak sa s'u mallëngjeva në çastin e mbërritjes te porta. Dolën gratë e këndonin:

*Ç'janë gjith' ata kalorës,
edhe Beshua bashk'me ta,
në Kokërdhok ç'i shpunë,
i pritnë me donoma.*

E kam tipin kështu unë, prekem shpejt në të tilla raste. Shyqyr që nuk vazhduan më tej gratë e Kokërdhokut, sepse, ndryshe, do të më kishin parë duke nxjerrë shaminë.

Kur hymë në odën e krushqve, pjatat e mbushura me meze dhe shishet e rakisë, me gryka të hapura, ma ngrohën zemrën dhe më bënë ta ndieja veten si veshka në mes të dhjavit.

Tani të mos e ngatërrojmë fillin e muhabetit e ta lidhim atje ku e këputëm. Hë, po, e kishim atje, tek ajo kënga që nuk njihet në krahinën tonë. Po u përzien të gjitha tani: edhe njerëzit, edhe zakonet, edhe muhabeti. Po shumë mirë u bë, s'ka përse të na mbetet qejfi. Ai që e mori atë këngë quhej Sefedin dhe, me sa mora vesh, kishte gjezdisur në shumë krahina të vendit, Po, në fund të fundit, mirë bëri. Paçka se unë s'e ndiqja dot në atë këngë. Këngët vendshë, me iso, kam qejf unë.

— Hajde, gëzuar, o shoku krushk! — m'u drejtua me gotën plot i zoti i konakut. — Sa rrofsh, këto punofsh! E heqshi këmbën zvarrë, që të na martohen të gjithë beqarët.

— Gëzim paç! — u zgjata që t'i përplasnim gotat. — Për kështu të ardhçim ngahera.

U rrëkëllyen gotat, dhe nga rakia, o burra, pirunjtë në mish...

Pas kësaj mori udhë një muhabet i shtruar, ashtu pleqërishte.

Këtë muhabet e ndërpreu një djalë i ri, që filloi të këndonte:

Të djelën që me saba

Ishte edhe ai nga pala e nuses. Po na e hidhnin ata të vendit me të kënduar. Por këtij desha t'ia prisja këngën në mes e t'ia merrja ashtu si e kam zakon vetë. Ai po e prishte edhe melodinë. E merrte nxituar, si të merakosej mos i mbarohej pjata me meze. Ndërkaq këngëtari vazhdonte:

Humbi Kostandineja....

Kjo nuk qe kënga që dija unë, që më bënte të kapardisesha aq shumë kur ia thosha. Qe një këngë tjetër, e re, deri atëherë e padëgjuar:

Bredhin fshati posht' e la.

— Ç'u bë Kostandineja?»...

Ngjarja për të cilën bënte fjalë kjo këngë, pat ndodhur gati një muaj më parë, në një fshat tri-katër orë larg nga Kokërdhoku. Kostandinën e kishin fejuar e ëma dhe i ati me mblesëri. Mirëpo ajo na donte një djalë në fshatin fqinj. Ishte traktorist në Kooperativën e tyre. Dha e mori Kostandina me prindërit, po s'nxori gjë në dritë. Morën vesh krushqia, u sëmboi dhe u ngutën për celebrimin. Po s'donte Kostandina. Eh, bela, o' shok, kur vajza i del zot

vetes. Jo, nuk ka ndonjë të keqe, xhanëm, po bie fjala. Atëherë krushqit vendosën: «T'i martojmë!» — thënë. Dhe u çaktua e shenjta ditë e martesës. Vajza i kundërshtoi të atit. Ai, si përgjigje, ia preu shkurt:

— S'ka gëk-mëk!

Erdhi dita e dasmës. Erdhën edhe krushqit, hëngrën e pinë, kënduan e kërcyen gjithë darkën e së shtunës. Të dielën në mëngjes, kërko nuse, nuse hiç...

Te pylli e panë ca gra:

— U var Kostandineja!

e dridhte zërin djali që ia kishte marrë këngës...

Atë të diel fshati zjeu. Secili thoshte si ia priste mendja...

Te lumi e panë ca gra:

— U mbyt Kostandineja!

Çibuku i babait të Kostandinës e nxirrte tymin pareshtur. Dhe shtrëngonte kokën me duart e tij të mëdha plaku i ngratë.

Pamjen pak të vrenjtur dhe disi ironike të atij që këndonte e zëvendësoi buzëqeshja:

Të hënëen që me saba

u gjend Kostandineja

Dasmorët u vunë të këndonin të gjithë së bashku. Harruan që detyra e tyre që të bënin vetëm iso. Kjo i dha shkas atij që ta ngrinte më shumë zërin:

Mori burrin me sevda,

nuse Kostandineja.

Gotat u përplasën me njëra-tjetrën. Pirunët u vërsulën mbi meze.

Të gjithë së bashku, tok me mezet përtypnin edhe mendimet që la pas kënga e sapokënduar.

Kali që krushqit kishin marrë për të hipur në të Kostandinën, që kthyer bosh. Hera e parë që shiheshin krushq të ktheheshin pa nuse.

Fatmirësisht unë nuk u ndodha në atë dasmë. Shyqyr që pata një gosti tjetër te një kushëri i gruas. Do të kishte qenë turp i padurueshëm që unë, pjesëtar i gëzimeve në gjithë krahinën, të isha me ata krushq që u kthyen pa nuse.

U interesova të mësoja se kush që ai djalë që këndoi këngën e Kostandinës. Mallkova veten që kërkova një shpjegim të tillë. Gjumi im i asaj nate i ngjante atij të një lepuri të strukur në një ferrë, pasi e kanë ndjekur qentë gjithë ditën.

E nesërmja u gdhi një ditë e bukur, nga ato që vjeshta e dytë i dërgon rrallë e për mall. Por agimi i kësaj dite të bukur kokave tona të trullosura nga pija u dhuroi edhe këtë lajm:

— Nusja ka ikur.

E kishte rrëmbyer një shok i atij djali që këndoi këngën e Kostandinës.

Ashtu marramendësh, siç isha, kërkova të gjeja një vrimë, ku të futja të paktën kokën, për të mos parë ç'bëhej përjashta.

Për fat nuk e kishim marrë dhëndrin me vete.

Gjatë kthimit vetëm një mendim më lehtësonte disi:

Të paktën, nuk ishim ne të parët krushq që ktheheshim pa nuse.

1978

160

NJË DITË ME DHEMBJE DHËMBALLE

Dhembja e dhëmballës më filloi aty nga ora pesë e mëngjesit. Dhe ishte pikërisht kjo dhembje që më zgjoi më herët se zakonisht. Doja të mos ia vija veshin shumë. Dhëmballa punën e saj, unë timen. U ktheva nga ana e dhëmballëve të shëndosha, me mendje që të flija afërsisht edhe një orë. Por dhëmballa punonte. Dhe sytë e mi s'bindeshin të mbylleshin për gjumë.

Kam qenë në dijeni prej kohësh për fillimin e kësaj dhembjeje. Paralajmërimin ma kishte bërë vetë dhëmballa e brejtur. Megjithëse jam me përvojë (nga 32 dhëmbë e dhëmballë, 22 më kanë mbetur), tregohem i ngathët për t'i mjekuar. Kujtohem për të vetëm kur dhembja arrin në palcë. Atëherë s'mbetet gjë tjetër, veçse dара. Dhe pothuaj të gjitha shkuletet i kam bërë pas orës dhjetë të natës.

Pasi u binda se dhembja do të vazhdonte, u ngrita, të paktën të mos rrija shtrirë vetë. Gruaja hapi sytë dhe më vuri re që po mbaja nofullën me dorë.

— Filloi avazi! — tha. — Mos e zgjat, merr leje nga puna dhe shko në klinikë!

«Mirë e ke ti, moj zemër... Po të ishte aq kollaj...»

Kështu thonë ata që s'e kanë provuar klinikën. Unë e di ç'do të thotë të të lëshojë goja avull dhe të të gjëmojë tërë koka nga zhurma e frezave. Dhe ke parë ti, kur shkon te dera e klinikës, të pushon dhe mbja e dhëmballës! S'thonë kot: e keqja me të keqe ikën.

Sidoqoftë, i duhej dhënë një farë zgjidhjeje, «duhej bërë derman», thonë plakat.

Mëngjesin e kisha të zënë me punë të shumta. Pasi u caktova detyrat shokëve, u nisa për në kantier. Teknikja e objektit kishte më se një muaj e sëmurë. Mbete duke bredhur gjithë muajin. S'ke ç'i bën, të zë ndonjëherë rrota bishtin: je brigadier, detyrohesh të bëhesh edhe teknik. Nuk e zëvendësuan teknikën e sëmurë. Dërguan më në fund një njeri për të bërë matjen e punës. Ishte tamam periudha kur mbyllen borderotë. I dërguari nga kantieri vetëm sa nxori zërat e punës së kryer. Dhe më duhej të nxirrja urdhër-pagesën me normisten.

I hipa biçikletës dhe, o burra, te normistja. Kur mbarova atje, thashë me vete se puna e parë ishte shërimi i dhëmballës.

Njërën këmbë në pedalen e biçikletës, tjetrës vetëm gishtërinjtë i mbështeteshin në tokë.

— Prit, prit, mos ik, — më thirri inxhinier Feriti. Ndalova.

— Mirë që të gjeta. Jemi caktuar në komisionin e cilësisë. Biçikletën e ke. Ky është një favor i madh, se do të bredhim në gjithë ato objekte. Hajde tani të marrim edhe nja dy të tjerë, që të kenë edhe ata biçikleta.

— Pse, sot duhet kryer kjo punë?

— Sot, thotë! Tani! Që këtë minutë, që këtë sekondë, bile!

I tregova për dhembjen që më mundonte.

— Hajde, hajde, se nuk të dhemb shumë, e shikoj unë, s'pyet ti për aq. Është kështu apo jo?

Më erdhi ligsht të vazhdoja ankimin. M'u duk vetja qaraman.

— Kur është formuar ky komision cilësie?

Sikur i erdhi befaz kjo pyetje, sepse e vura re që iu tendos mjekra.

— Ka kohë. Si, s'qenke lajmëruar ti? — Kuptohet haptazi që dredhonte.

— Bjeri drejt, më mirë. Sot ta mblodhën, si kryetar komisioni që je, sot kërkon të mbledhësh anëtarët. Dhe, kë të gjesh, përłaje.

U gëlltit njëherë me zor.

— Shiko, të mos sorollatemi kot. Kjo detyrë na është ngarkuar nga organizata e Partisë dhe drejtoria e kantierit. Nesër duhet raportuar.

S'kishte faj. Ç'të bënte ai, nëse mua më dhembte dhëmballa? I kërkova leje një çerek ore, sa të mjekohesha te dentisti.

— Punë e kotë, — m'u përgjigj. S'na pret koha. Dhe punë shumë kemi. Pasdite je i lirë.

— Nuk jam i lirë as pasdite. Harrova që jemi në komisionin e kategorizimit?

— Nuk kam harruar. Të jap leje unë pasdite.

U nisa pas tij. Isha i detyruar të bindesha. Ai që kryetar i dy komisioneve, ku unë merrja pjesë si anëtar. Dhe i kishte rregulluar punët që të dy komisionet të vepronin në një ditë.

Në atë të pasdites mirë, më patën zgjedhur dhe e dija, por në të paradites e hëngra se mbaja biçikletën me vete. Veç të tjerash, na edhe dhembja e dhëmballës!

Gjetëm edhe dy të tjerë me biçikleta dhe i morëm

në komisionin e cilësisë. Shko objekt më objekt, bëj vërejtje e cakto detyra. Bllokun e shënimeve ma la në mua në dorë.

— Shënoji ti vërejtjet e konstatimet, të vjen përdoresh, — më tha kryetari, inxhinier Feriti. Dhe, kur vuri re se unë herë pas here fërkoja faqen në vendin ku duhej të ishte dhëmballa e sëmurë, shtoi: — Mos e mbaj mendjen atje. Pi dy aspirina njëherësh, se të lehtësojnë.

Ia dëgjova fjalën. Bleva tri pako aspirina në farmacinë më të parë. Pas një gjysmë ore isha qiçër.

Paraditën e kalova mirë, por aty nga ora tre nisën përsëri ngacmimet, megjithëse më pak, aq sa mezi e vlen të përmendet.

Punët e komisionit të cilësisë mbaruan në orën 4.30. Më pesë fillonte komisioni i kategorizimit.

— Tani ke leje me peshë për te dentisti, — më tha kryetari i të dy komisioneve.

— Nuk ndiej edhe shumë shqetësim, — ia ktheva. — Sidoqoftë, i kam edhe dy pako aspirina me vete.

— Mirë, atëherë, prapëseprapë në komisionin e kategorizimit mos rri. Përpilo raportin e komisionit të cilësisë. Shënimet vetë i ke mbajtur. Futu në zyrën time dhe jepi.

Po bëhesha gati të shkoja, kur më lajmëruan se më kërkonte shefi i kuadrit, Dhimitri.

Nga ato që dëgjova prej tij, u dëshpërova. Sa mirë bëri që më vuri në dijeni.

Ai u vrenjt dhe ma preu shkurt:

— Nuk ta shtrova për aprovim. Si kryetar komisioni të urdhëroj të kryesh detyrën që të ngarkohet! Qartë? Kundërshtimet s'më pëlqejnë.

Unë bëra tamam ashtu siç nuk i pëlqente atij. E kundërshtova.

— Si kryetar, ju keni të drejtë të më tërhiqni vërejtjen, në qoftë se mungoj, ose në qoftë se prish rregullat gjatë kohës që vepron komisioni. Në asnjë mënyrë nuk ju bindem që të mos marr pjesë në komisionin e kategorizimit, ku më ka zgjedhur kolektivi. Qartë? Hedhjet e pritjet s'më pëlqejnë.

Kishim qëndruar përballë njëri-tjetrit. Ai më lëshoi rrugë.

U mblodhën shokët e komisionit. Pranim të hyn-te i pari që do të jepte prova atë pasdite. Ndërkaq shikoja fytyrat e tre anëtarëve që kisha përreth. I njihja dhe më njihnin mirë.

Inxhinier Feriti, në krye të tavolinës, diçka shë-nonte. Përpara mbante një tog letrash. Ai, sikur s'kishte kohë t'i jepte rëndësi shqetësimit që shprehej në vështrimin tim. Shokët e tjerë s'dinin gjë. Me Dhimitrin këmbeja vështrime.

Hyri i pari. Kishte kategorinë e katërt dhe kërkonte të pestën.

Kryetari i komisionit tha emrin e tij. Pastaj hapi librin, ku shënoheshin kërkesat për secilën kategori dhe nisi ta lexonte.

E njihja këtë punëtor. Kishim punuar pranë e pranë, kur u ndërtua Shkolla e re e Partisë. Ia thoshte zanatit. Po provat janë prova dhe...

Kryetari i komisionit lexoi aprovimin e brigadës. Pastaj unë i bëra tri pyetje atij që jepte prova. Katër pyetje të tjera ia bënë shokët e tjerë. Mirë u përgjigj.

Dhëmballa po i shtonte dhembjet. Nxora dy kokrra aspirina dhe i gëlltita.

Kryetari e ndërpreu atë që po përgjigjej. Në emrin e tij u kërkoi leje anëtarëve të tjerë të komisionit për mua, pasi nuk isha mirë.

— Jo, jo, s'ka gjë. Do të qëndroj...

Por ai shpejtoi të më ndërpriste dhe vazhdoi:

— Ne s'jemi aq pa mend, sa të detyrojmë një të sëmurë të rrijë patjetër. Ja, jemi gjithë këta këtu. Na, të të jap edhe unë një copë letër për një dentist që e njoh, e kam shok. Është në klinikë ai tani...

— Po nuk qenë të gjithë anëtarët, nuk e quaj të rregullt veprimin e komisionit, — ndërhyri shefi i kuadrit. — Kam urdhëresë të posaçme.

Inxhinier Feriti tundi kokën në shenjë mospajtimi. Vetullat po i lëviznin sa lart-poshtë, S'ia kisha vënë re herë tjetër këtë shenjë nervozizmi.

I treti që jepte prova atë pasdite, vazhdoi të përgjigjej. Inxhinier Feriti me siguri s'dëgjonte asnjë fjalë. U ngrit, doli jashtë dhe u vonua për më se dhjetë minuta. Dhe, kur u kthye, sa u ul, filloi të vizatonte figura pa kuptim, pastaj i griste letrat e i hidhte në kosh.

Dhëmballa më lehtësoi pak. Kryetari më hidhte herë pas here ndonjë vështrim me bisht të syrit.

— Me kaq e mbyllim për sot, — tha, kur mbaroi së përgjigjuri i treti.

— Kemi edhe një, — u hodh shefi i kuadrit. — Ç'ta shtyjme kot për një të vetëm?!

— Detyrohemi ta shtyjme, shoku Dhimitër, sepse nuk mund të punohet kur kemi këtu njerëz të sëmurë.

— Për mua të mos shtyhet, — foli unë. — Qëndroj. Sikur jam më lehtë tani.

— Je më lehtë tani, por rëndohesh pak më vonë. Dalim tani. Ti shko te dentisti. Unë do të interesohem të të ndihmoj.

— Unë mendoj të përfundojmë edhe me Xhemil

Kamnikun, — ngulmoi Dhimitri. — S'besoj se vonohemi më shumë se gjysmë ore.

— S'ke ç'mendon, Xhemil Kamniku s'është këtu. I thashë të ikte e të vijë nesër, — foli nxituar inxhinier Feriti.

S'kishte përse të rrinim më dhe dolëm.

Pasi ke ndenjor tri-katër orë brenda, është mirë të bësh pak shëtitje.

— Hajde, — foli inxhinier Feriti, — të të çoj, eja të vemi bashkë në klinikë.

— S'ka gjë, shkaj edhe vetë.

Nga gjithë klinikat e dhëmbëve, vetëm ajo e shërbimit të natës duhej të qe hapur. Për atje u drejtova edhe unë...

Inxhinier Feriti më priste në krye të shkallëve. Dukej i mërzhitur.

— Ters! Qenke pa fat! Këtë që shërbeka sonte, për herë të parë e shoh. Si do të bësh, do të rrish? — më pyeti, pasi u mendua një çast.

— Meqë erdha, po hyj. Ç'ta zgjas kot.

Atij nuk i bëhej për të ikur. Diçka bluante.

— Si të duash. Po e ke me mëdyshje, ikim, të çoj unë deri në shtëpi. Nesër po takoj atë shokun tim dhe...

— Jo, jo, do të rri. Nesër kushedi ç'punë tjetër më del përpara dhe mbetem prapë. Pastaj, mund të më zejë dhëmballa natën dhe kush e duron. Ti, po deshe të mos më lësh vetëm, rri.

Fytyra i mori një shprehje keqardhjeje:

— S'mund të rri dot. Bile, edhe kaq, u vonova shumë.

Ndoshta ngaqë kujtonte se mos ia përsëritja kërkesën për të ndenjor, u drejtua nga shkallët dhe i zbriti me të shpejtë...

— Kjo dhëmballë të ka lënë shëndenë e të ka marrë të keqen, djalë i mbarë. Do ta heqësh? — më tha dentisti, një burrë me syze e flokë të thinjur, sapo më hapi gojën.

— Po, po.

Më bëri gjilpërën dhe ndezi një cigare. Desha edhe unë ta ndizja. Futa dorën në xhep dhe mora paqetën, por ai më ndaloi.

— Nuk bën, — më tha. — Si të mbaroj unë, ti vepro me tënden.

Desha t'i kërkoja të falur por buzët, mishi i dhëmbëve me qiellza nisën të më mpiheshin.

Dentisti e shtypi cigaren në taketuke dhe me dorë në dorë erdhi e u ul në ndenjësën pranë meje.

Më në fund ndjeva diçka që u shkëput me mundim dhe një dhembje therëse që e pasoi.

Dentisti flaku dhëmballën e shkukur.

Pastaj më lëshoi një letër në dorë.

«Recetë», mendova dhe i hodha një sy: Një ditë pushim.

— Ke nevojë për qetësi. Dhe gojën ta shpëlash herë pas here me ujë të kripur. Nesër në mbrëmje do të vish përsëri tek unë.

Në mëngjes u ngrita përsëri herët. Raportin e pushimit e futa në një kuti të vogël, ku zakonisht mbanim latat e druve. M'u desh të shkoja patjetër në punë. Të djeshmen s'kisha qenë gjithë ditën.

Si bëmë pesëminutëshin, shokët u drejtuan nëpër vendet e punës, kurse unë u mora me detyrat e lëna përgjysmë një ditë më parë.

Mbasdite, në orën katër, sapo mbarova vizitën në klinikë, u nisa për në komisionin e kategorizimit. U djersita së nxituari me biçikletë. Anëtarët e tjerë të komisionit qenë mbledhur më parë.

Inxhinier Feriti u vu sërish, si mbrëmjen e kaluar, të vizatonte figura pa kuptim në togun e letrave që kishte përpara. I griste letrat, i hidhte në kosh dhe ia ngulte sytë shefit të kuadrit.

Pasi i kaloi nervozizmi i çastit, ai u mundua të ishte i sjellshëm.

— Hë, si ndihesh tani? — m'u drejtua mua. — Nuk të dhanë raport mbrëmë?

— Po, më dhanë pushim, por s'më ka bezdisur shumë.

Ra heshtje. Ndihej vetëm maja e stilografit të tij që shkarraviste nëpër letra.

— Përse nuk bëni pushim, kur jeni edhe me raport mjekësor?

— S'kam ndonjë gjë të madhe. Në punë kam qenë gjithë ditën.

Ai iu kthye shefit të kuadrit:

— Shikoni, shoku Dhimitër, është puna juaj kjo. Mbani përgjegjësi për shëndetin e punëtorëve.

— E di vetë ai punën e tij, edhe shëndetin...

— Unë, si kryetar komisioni, nuk të lejoj të qëndrosh i sëmurë, — m'u drejtua përsëri mua.

— Po që se ndihet i sëmurë, e lejojmë, edhe në qoftë se shtyhet komisioni dy-tri ditë, — kërceu Kristaqi, njëri nga anëtarët e komisionit. — Por ama... për shkakun e Xhemil Kamnikut... të mos luajë nga vendi.

— Puna e Xhemilit ka mbaruar, nuk ka në rregull dokumentet, — tha shefi i kuadrit.

— Si nuk i ka në rregull?! — kryetari i komisionit brofi në këmbë. — Pse s'na e the qysh më parë këtë!

— Sot e verifikova. Vërtetimi i paraqitur prej

tij, si i lëshuar nga komisioni i ndërmarrjes ku punonte ai, është i falsifikuar.

Inxhinier Feriti u ul si ta qëllonte dikush prapa gjunjëve.

— Duhet vënë në dijeni tjetri, — tha, — s'na e ka borxh ta sorollatim kot. — U ngrit dhe doli jashtë.

— As ne s'ia kemi borxh të merremi me fletushka të falsifikuara, — thashë unë.

Ndezëm nga një cigare. Dhembja në vendin e dhëmballës së prishur më kishte pushuar.

1978.

NJË VAJZË NË GJURMËMUSHKË

Një makinë doli te vendi që quhet «Qafa e Këmborës». Shoferi i ra borisë.

— Shiti, Shit Mustaqja, — thamë ne, gati së bashku dhe drejtuam trupat t'ia bënim me dorë. Prisnim që ai të nxirrte kokën nga kabina dhe të na përshëndeste duke tundur flamurin e shoferit të dalluar.

Boria binte pa ndërprerje. Si kaloi qafën, makina doli. Që andej zbriti një pasagjer. Shoferi i dha plaçkat, që duhej të ishin një valixhe e një çantë. Pastaj i tundi dorën në shenjë përshëndetjeje pasagjerit dhe u nis. Makina u fut në rrugën që dredhonte midis pyllit. Kur arriti te «Tri burimet», boria u dëgjua edhe tri herë me ndërprerje të shkurtra. Ky sinjal do të thoshte se na kishte sjellë një shok të ri.

Njeriu që zbriti nga makina e Shitit u nis në drejtimin tonë. Qëndronim në këmbë e shikonim. Donim të mësonim kush ishte e përse vinte. Për një kolektiv të vogël si yni, gjashtëmbëdhjetë vetë gjithsej, në atë vend të largët, midis pyllit, ishte një gjë e rrallë ardhja e një njeriu të ri. Kur vinin shokë përgjegjës nga kantieri apo ndërmarrrja, e merrnim vesh sapo dëgjonim borinë e gazit të Isait te «Qafa e Këmborës».

— Qenka shoqë, — tha Stefani, pa e përmbajtur habinë. Ai thirri fort, aq sa ajo me siguri do të kish-te dëgjuar.

— Po kjo ç'do këtu?

— Mjaft, Stefan, mjaft e çorre fytin!

Ajo që vinte, kishte veshur një bluzë në ngjyrë vishnje dhe pantallona bezhë. Flokët i kishte të prerë shkurt. Valixhen e mbante në dorën e djathtë, kurse çantën (një çantë e zezë, nga ato që mbajnë zakonisht sportistët) e kishte hedhur në supin e majtë.

— Puna mbarë dhe mirë se ju gjej! — foli, kur u afrua pranë ndërtesës.

— Mbarë paç! Mirë se vjen! — zërat tanë u përzien me njëri-tjetrin.

— Mirë se të pru zoti! — foli më nge usta Demiri, një burrë me qeleshe, sipër të pesëdhjetave, nga një fshat një orë e gjysmë larg objektit të punës.

Vajza vuri dorën e majtë si strehë dhe ia ktheu:

— Pse, Zot e quajnë atë shoferin me mustaqe si timon biçiklete? Më paska rrejtë, ai tha se e kishte emrin Shiti.

Asnjëri s'e vuri re që usta Demirit i shpëtoi çekiçi nga dora. Qeshëm me shakanë e vajzës që sapo kishte ardhur. Nuk e dinim ç'ishte ajo e për se vinte, megjithatë pamja e saj i ngjante një flladi të freskët, që fryn papritur në mes të zhegut të vapës.

Ajo e lëshoi valixhen në tokë, pastaj hoqi çantën nga supi dhe e la sipër valixhes.

— Kush është brigadier Laudini?

Shikimet e shokëve ranë mbi mua. Dhe unë e quajta të tepërt të thosha: «Unë jam Laudini».

— Shko, se të doli emri, — tha Mihallaqi.

Ajo erdhi nga ana e brendshme. Zgjati dorën dhe u ngjit në skelë.

— Irini Livari, — u prezantua.

Unë s'ia thashë emrin, i bindur që ajo e mësoi se isha Laudini.

— Gëzohem që njihemi, Irini. Po të, ç'është e mirë ju solli këtej maleve?

Çiltërsia e saj më bëri të flisja shpenguar.

— Pse, ore, era më solli? Ç'më bëre ti, flutur?

— Nejse, s'ka gjë. Krahasimi me fluturën është i goditur për vajzat, — më erdhi në ndihmë Lulëzimi.

Irini u dha dorën shokëve që ndodheshin afër. Nga xhepi nxori një zarf, ku shënohej: «Shokut Laudin». Ma lëshoi në dorë dhe shkoi të takohej me të tjerët. Xha Demiri ia zgjati dorën si me përtesë, por ajo e kapi në sup e i tha:

— Mos u tut prej shakasë së një goce, hej burrë malësie.

Në letrën brenda zarfit ishin shkruar gjithsej pesë rreshta me një shkrim të imtë. Drejtori i kantierit më njoftonte se Irini Livari caktohej teknike zbatimi te ne.

Ky njoftim pasohej nga një porosi e vogël: «Të tregoni kujdes për të, si vajzë e re, e sapodalë nga bankat e teknikumit. Asaj i nevojitet patjetër ndihma juaj, sidomos jotja, si brigadier dhe e Lulëzimit, si komunist.»

Drejtori me siguri do të ketë pasur ndonjë punë të ngutshme në kohën kur i kishte shkruar letrën Irinit, ndryshe, ai do të na kishte shpjeguar edhe ndonjë hollësi, të na udhëzonte pak më shkoqur. E mira e të mirave ishte që Irini të shoqërohej prej

ndonjërit nga nëpunësit e kantierit. Sidoqoftë letra me pesë rreshtat për mua kishte formën e plotë të një urdhri. Vetëm duke e parë nga kjo anë, si urdhër, isha i detyruar të bindesha. Ndërsa, po të më pyesnin, s'do të isha dakord, që, nga gjithë kantieri ynë, ku punonin mbi njëzet e ca teknikë, të dërgohej në këtë vend të largët një vajzë kaq e re.

Këto vërejtje ia thashë edhe Irinit. Ajo u mundua të më sqaronte.

Të gjithë të rinjtë e të rejat e klasës së saj në mbledhjen e organizatës kishin vendosur që asnjëri të mos rrinte në qytet, por të shkonin në objekte të vështira... Irini pat zgjedhur objektin tonë.

Drejtori i kantierit që munduar t'i mbushte mendjen të priste dy-tri ditë dhe do ta sillte vetë. Ajo s'kishte pritur. Me çantën në krahë e valixhen në dorë, kishte dalë në rrugë, i kishte hipur makinës së Shiitit dhe erdhi te ne.

Në fjalët e saj vihej re hapur entuziazmi rinor. Aty për aty e krahasova me një zog që i zhvillohen krahët para se t'i marrë formë të plotë gjithë trupi. Më erdhi edhe keq që më lindi ky mendim, pikërisht në fillim të njohjes me të.

«Nuk duhej t'ia lejoje mendjes të gjente të tillë krahasim», thashë me vete.

Sidoqoftë, një gjë ishte e qartë: kolektivi ynë arriti numrin shtatëmbëdhjetë.

Duke kaluar nëpër shela, Irinit ia kapi pantallonat një gozhdë. Ajo druhej t'i jepte rëndësi kësaj «gjëje të vogël», megjithatë harronte dhe e kapte me gishta vrimën e hapur në pantallona. Me sa dukej, i vishte për herë të parë atë ditë dhe i vinte keq.

Vendi ku punonim quhej «Gjurmëmushkë». I qe vënë ky emër, mbase ngaqë ai shesh pritej nga tri anë prej dy përrenjve, dhe kjo prerje i ngjante tamam gjurmës së mushkës. Në krye të sheshit përrenjtë largoheshin njëri majtas e tjetri djathtas, duke hyrë në rrëzë të vargut të shkëmbinjve. Rreth e qark vazhdonte pylli me drurë ahu të dendur, të lartë e të drejtë. Midis pyllit gjarpëronte rruga që të çonte për në minierën e Larushasit. Në mbarim të pyllit, gjelbërimi ia linte vendin vrazhdësisë së shkëmbinjve, shkëmbinj me gunga të mëdha e hone të thella. Të ardhurve rishtas gungat e honet e shkëmbinjve u ngjanin si nofulla gjigantësh, nga ata që kemi dëgjuar nëpër përrallat e gjyshëve.

Në këtë vend kishim filluar ne punimet për ndërtimin e një hoteli trikatësh. Të dukej e çuditshme të ngrije një ndërtesë të tillë në këtë vend të humbur e të shkretë, ku natyra dukej e gjithëpush-tetshme. Por kjo punë qe studiuar, qe bërë projekti, filluan dhe punimet. Gjurmëmushka do të bëhej alpinistike. Përveç terrenit të përshtatshëm për alpinizëm, në marrjen e këtij vendimi do të ketë ndihmuar, mendoj, edhe prania e burimeve të shpeshta, që nuk i përmenda pak më parë, kur bëra përshkrimin e vendit.

Verë për verë, gjatë muajit gusht, këtu vijnë alpinistë. Vitin e kaluar kishte ardhur edhe Irini. Pra, ajo e njihte vendin dhe, kur mori vesh se këtu do të ndërtohej një hotel për alpinistët, nuk përmbahej, derisa t'i plotësohej dëshira për të punuar si teknike zbatimi.

Ne i patëm filluar punimet nga mesi i qershorit. Deri atëherë punonim në minierën e Larushasit. Atje vazhdonim gjysma tjetër e brigadës sonë. Bë-

heshim tridhjetë e tre vetë, duke përfshirë edhe brigadier Malon e teknik Skënderin.

Burrë i mirë Maloja. Edhe Skënderi, por ky pak si... shumë i butë. Burrë i leshtë, thoshte për të Mihallaqi. Mihallaq qyfyrexhiu. Nuk lë njeri pa ngacmuar, por pa të keq.

— M'u ndanë gjysma e djemve, — tha Maloja, kur u nisëm ne për në Gjurmëmushkë.

Atë ditë kishin ardhur drejtori dhe kryeinxhinieri i kantierit. Drejtori shfaqti mendimin që të vihesha unë brigadier.

Më erdhi e papritur. Unë isha mësuar gjithmonë të punoja, të bindesha dhe t'i kryeja sa më mirë punët që më caktonin Maloja dhe Skënderi. Jo, unë s'dija të drejtoja. Në grupin tonë, në brigadën e re që u krijua, kishte të tjerë, më të aftë se unë. Ja, ishte Ramadani. Ai kishte kategorinë e shtatë, unë të pestën. Ramadani do ta priste me kënaqësi detyrën e brigadierit. Për mua dhe shokët që e njihnin, s'ishite e vështirë t'ia kuptoje këtë dëshirë, ndërsa rrinte ulur mbi një gur dhe orvatej t'i kapte me një vështrim të gjithë njëherësh... Po të vihesha unë brigadier, Ramadani... A nuk i nxori ai gjithë ato telashe Malos?!... Jo, unë nuk mund ta mërrja përsipër drejtimin e brigadës.

Dhe e kundërshtova propozimin e drejtorit.

— Ju falem nderit për besimin, shoku drejtor, por, brigadierllëku për mua është si shumë. Pastaj, sikur nuk shkon, përderisa këtu ka shokë të tjerë me kategori më të lartë se unë.

— Unë bëra propozim, — tha qetë drejtori. — Jam i bindur dhe kam besim në këto që them. Ia shtroj për shqyrtim kolektivit, kolektivi vendos: e hedh poshtë, ose e pranon propozimin tim.

— Ashtu siç tha edhe vetë, Laudini nuk i ka af-tësitë, — e mori fjalën Stefani. — Laudini është i ri, i duhet më shumë të mësojë, sesa të drejtojë e të urdhë-rojë. Midis nesh ka shokë më të aftë në zanat e të pjekur.

— E ke fjalën për veten? — ia priti Mihallaqi.

— Ç'për vete, mor të plastë kungulli, — u nxeh Stefani dhe e ngriti zërin fort. Një tufë zogjsh, që rrinin në degët e një peme, u ngritën e fluturuan të trembur. — Unë propozoj që brigadier të vihet Ra-madani. Ai është...

— Ramadanin e kemi pasur brigadier edhe më parë dhe e kemi shkarkuar nga detyra, — ndërhyri drejtori. — Kjo dihet nga të gjithë. Ne mendojmë se ai ka ende shumë boshllëk për shlyerjen e atij dëni-mi.

Ramadanit iu var mjekra sipër gjoksit lështor.

— Lëre, mor, se u pëlqen ndonjë që ta heqin për hunde, — i tha Stefanit.

— Peshoji fjalët, Ramadan, — e qortoi drejtori.

Ramadan s'u ndie. Stefani u ul.

Propozimi i drejtorit u aprovua. Unë u caktova brigadier. I pari drejtori dhe pas tij kryeinxhinieri më uruan duke më shtrënguar dorën. Pastaj më për-gëzuan gjithë shokët.

— U bë kungulli e mori gardhin, — më pëshpë-riti Ramadan.

— Do të na ngordhë për lekë, atë do na bëjë, — tha Stefani, duke parë shtrembër. — Ku di ky të vje-lë...

E dija që, në gojën e tij, «të vjelë» donte të tho-shte «të vjedhë». Prandaj ai propozoi për Ramadanin, «Qen i lekut! I nxjerr paratë nga vrima e buallit», e mburrte shpeshherë Stefani atë.

Në makinë, gjatë rrugës nga Larushasi në Gjurmëmushkë, Ramadani qëndroi te bishti i karrocërisë. Sa fikthe njëzën cigare, ndizte tjetrën. Nuk i kish-te shkuar nëpër mend që mund të bëhej kungulli e të merrte gardhin. I vinte keq që humbi shtesën në përqindje. Edhe Malos donte t'ia zinte vendin. «Shiko, se ta ka me hile», i thoshte Skënderit. «Kur nuk ndodhesh ti në objekt, regjistron e të raporton punë të pakryer. Shkruan më tepër orë nga sa punojmë...»

Kur erdhi Irini, ne kishim mbaruar bodrumet dhe vazhdonim në gjysmën e katit të parë. Hoteli ndër-tohej me gurë të bardhë. Gurët, në vendin ku nxirreshin, në rrëzë të shkëmbinjve, i përgatitnin një skuadër kooperativistësh nga Derti, fshati i xha Demirit, ustait me qeleshe, dhe që andej na i sillte Qaniu me riportabël.

Ardhja e teknikës së re u prit me kënaqësi të madhe nga Skënderi. Prej asaj dite ai shpëtoi nga rruga Larushas-Gjurmëmushkë, më tepër se një orë, të cilën qe i detyruar ta bënte çdo ditë.

Një javë pas ardhjes së Irinit, Gjurmëmushka mori tjetër pamje. Barakën ku kishim fjetoret, mensën dhe magazinën e veglave i lyem me gëlqerë jashtë e brenda. Përreth ndërtesës vumë parulla. Burimin në anë të përroit, nga e majta e sheshit, që ishte me një koritë druri, bërë nga barinjët, e rregulluam me mur, e suvatuam me llaç çimentoje, i vumë dhe rubinet. Në faqen e suvatuar shkruan: *Ndërtuar më 5 korrik 196...* Poshtë shënuam emrat tanë.

— Do të mbetemi të paharruar. Brezat e ardhshëm do të na kujtojnë me respekt, admirim e mirënjohje, — bënte shaka Mihallaqi.

Bëmë dollapë për rrobat, frona për t'u ulur «si

njerëz, pranë tavolinës e jo sipër krevateve», thosh-te Irini.

Rregulluam një raft për librat (qysh kur kishim ardhur nga Larushasi i mbanim nëpër kokat e krevateve), pajisëm e vumë në funksionim kuzhinën tonë (nuk qe punë e mirë ta mbanim gjellën me kazanë që larg, nga mensa e minierës). Punën e kuzhinierit, derisa të na dërgonin një (Irimi kishte kërkuar të vinte një shoqe, kjo na pëlqeu edhe neve), e mori përsipër Hakiu. Ai e kishte ushtruar këtë profesion gjatë shërbimit ushtarak.

Që në Larushas ne ishim mësuar të punonim me orar të zgjatur, qysh kur lindte e derisa perëndonte dielli.

Irimi na ndaloi:

— Tetë orë punë dhe ta shfrytëzojmë kohën siç duhet.

— Dua të punoj e të marr lekë, — bërtiste Stefani, ndërsa gishtërinjtë i lëvizte sikur shtypte gjësendi midis tyre. — Për sevdanë e atij orari të zgjatur rri këtu, në majë të malit, bashkë me-ujqit e arinjtë. Po të jetë për tetë orë, shkoj e punoj në qytet, pranë shtëpisë.

— Nuk është sipas dëshirës sate apo simes, Stefan. Duhet t'i përmbahemi kodit të punës. Me ligj tetë orë duhet të punojmë.

— Posi! Vetëm ti e ditke dhe e zbatoke ligjin! Se është hera e parë që punojmë në objekte të largëta.

— Pse ta shohim kaq ngushtë, — ndërhyri Ramadani në bisedë. — Mendoj se ka diçka më të rëndësishme këtu. Afati i ndërtimit të hotelit është i shkurter dhe tetë orë punë në ditë s'mjaftojnë.

Unë dhe të tjerët vetëm dëgjonim. Nuk isha i bindur se ç'qëndrim të mbaja, në mënyrë që të dilja

në mbrojtje të së mirës së punës. Irini kishte të drejtë, mbështetej te ligji. Stefani e kishte kot, lëshonte fjalë në erë. Kurse vërejtja e Ramadanit nuk dukej të qe bosh, pavarësisht ç'fshihej përbrenda.

Irini u përgjigj, pasi heshti për një çast:

— Edhe në raste të tilla ka përcaktime ligjore. Lejohet të punohet deri në dhjetë orë, atëherë kur...

— Ama lejohet! — s'u përmbajt Stefani. — Kështu të bëhet. Qenka e thekur dreqi, — e mburrte Irinin. — S'na e mbushi syrin në fillim.

— Neve na intereson rezultati në fund të muajit, sa do të mbyllet përçindja, — thoshte Ramadani. — Gjithë të tjerat janë formale, s'lot rol nëse rri në karrige apo shtrihem mbi krevat me gjithë këpucë.

— Për ty mjafton që të ngopësh barkun, s'ka gjëse qëndron në mes të bajgave, — ia këpuste atij Mihallaqi.

Ramadani s'ia vinte veshin. «Dava Mihallaqi. Atë di ai, të futë hundët gjithandej...»

Këto biseda zhvilloheshin në mungesë të Irinit. Kur ajo ndodhej midis nesh, secili ndiente një frenim në vetvete.

Ditët e para pati mendime të ndryshme rreth veprimit të teknikës së re. Shumë prej nesh i besonim asaj.

Unë dhe Lulëzimi po lexonim. Në çdo kryeradhë ndaloja, ngrija sytë nga libri dhe pyesja veten: «Pse s'po vjen Irini? Si shumë dashka të rrijë e veçuar sonte.» Pastaj vazhdoja leximin me mendimin se mund të kishte ndonjë punë në dhomën e saj dhe së shpejti do të shfaqej në derë.

Pas pak mbylla librin dhe dola.

Irini ishte e tronditur. Sa më pa mua, sytë e kalër në formë bajameje lëviznin me shpejtësi, si të

donin të dilnin nga zgavrat. Duke vënë të gjitha forcat, mezi ia dilte të përmbante shpërthimin e lotëve.

— Nuk ma priste mendja, — tha ngadalë, me zë gjysmë të mekur, — Ramadani...

M'u kujtua një mbrëmje, javën e kaluar. Unë e Irini luanim shah, të tjerët shikonin. Ramadani qëndronte midis meje dhe Irinit. Duhet ta kishte ngacmuar vajzën me këmbë, derisa ajo ia prishi:

— Më dërrmove, Ramadan, me gjithë atë këmbë, si thundër elefanti.

Dhe mua hiç s'më shkoi ndër mend që t'i dilja përpara së keqes qysh atëherë.

— Këtë të sotmen s'ma priste mendja, — tha prapë Irini.

...Pasdite, si kishim lënë punën, ajo kishte shkuar vetëm në pyll. E dinim të gjithë që i donte shumë manaferrat. I mblidhte, i shkonte varg dhe bënte me to gjerdanë të gjatë. Ashtu edhe atë pasdite. Kishte mbledhur dy-tri vargje, kur ndjeu disa hapa dhe një fishkëllimë. Ngaqë e kishte humbur mendjen pas manaferrave, u tremb pak.

— Mos u shqetëso, jam unë, — foli Ramadani.

Irini në çast e mblodhi veten.

— Më erdhi keq kur të pashë vetëm dhe erdha të të bëhem shok.

— Falemnderit, — i tha ajo dhe u vu përsëri të mblidhte manaferra, duke menduar se edhe Ramadani do të bënte po ashtu. Por ai i kishte thënë se ishte vajzë e bukur, se për të ishte gjynah të rrinte e vetmuar e «ta digjte rininë kot». Kishte folur edhe disa fjalë të ngatërruara për dashurinë e për freskinë e pyjeve.

...Do të isha vonuar duke dëgjuar tregimin e Iri-

nit rreth kësaj ndodhie. Lulëzimin e kishte nxitur padurimi dhe erdhi vetë.

Unë qeshë nervozuar. Nisa t'ia tregojta Lulëzimit. Irini donte të më ndërpriste.

— Mos, Laudin, s'është mirë... — Ajo e kishte vënë re që shoku im ishte i papërmbajtur.

— Trego, trego, — tha Lulëzimi. — Është e kotë ta fshehësh tani. E nise, mbaroje!

Dhe unë ia tregova.

Ai ndezi një cigare. E prishi atë së kafshuari me dhëmbë dhe e pështyu. Doli me rrëmbim nga dera.

«Ç'ka ndër mend të bëjë!», thashë me vete dhe i rashë pas.

Ai kishte qëndruar më këmbë të hapura te dera e dhomës së çlodhjes dhe iu drejtua Ramadanit, që po luante domino.

— Po e bëre edhe një herë, do të ta çaj barkun me thonj dhe do të t'i nxjerr përjashta ato zorrë të qelbura!

Kaq tha dhe iku për nga burimi. Që nga mbrapa i vija re shkrepëset që, sapo i ndizte, i fikeshin, pa arritur të ndizte cigaren. Të tjerët në dhomë kishin mbetur të shtangur.

— Ç'ke gallamosur, mor barkderr?! — i shfryu Mihallaqi Ramadanit.

— Unë desha ta ngacmoja me shaka, ta shikoja sa trime ishte. Ajo kot u frikësua. S'kisha vajtur me paramendim të keq, — fliste Ramadani, pa guxuar të shikonte njeri në sy.

Shkova në dhomën e Irinit. Shokët e tjerë erdhën pas meje. Ramadanin e lanë vetëm.

— Ju lutem shumë, mos e bëni të madhe këtë çështje, — tha Irini, kur po dilnim andej.

Iku gjumi, iku, mori arratinë.

Shumë kohë përpara duhet ta kem lexuar këtë vjershë, përderisa vetëm një varg mbaj mend prej saj. Mundohem ta vazhdoj dhe ngatërrohem më keq. Shokët flenë. Këtë e kuptoja nga frymëmarrjet e tyre. «Lum ata që flenë». Pesë vetë flenë si qengja të urtë. Unë, i gjashti, dridhem e përdridhem në krevat, sikur dysheku të qe shndërruar papritur nga i pambuktë, në gjemba murrizash. Ja, ngjitur me krevatin tim, Lulëzimi ka rënë në qetësi të plotë, si të mos qe ai, që dy orë më parë i shtrëngonte grushtet aq fort. Kështu e ka ai. Në çastin e parë, kur ndodhet para diçkaje të papëlqyeshme, mer flakë dhe, kur nuk e shfryn dot inatin, zien përbrenda. Pastaj qetësohet dhe nis t'i gjykojë punët shtruar, urtë e me pjekuri.

Unë jam e kundërta e tij. Në fillim përmbahem, jam në gjendje ta kuptoj se deri në ç'shikallë arrin e keqja dhe si duhet vepruar. Dhe, kur të gjithë qetësohen, më vërsulen mendime të panumërta, koka më zien, sytë më përvëlojnë (ata që më shikojnë në një gjendje të tillë, më këshillojnë të shtrihem për t'u qetësuar). Edhe kur shtrihem, mundohem të mos mendoj për asgjë e megjithatë mendimet shumohen, ngatërrohen, saqë s'mund të duroj, ngrihem dhe bares si i dalldisur.

Kështu po më ndodhte edhe atë natë. «Ç'e shtyu Ramadanin ta ndiqte Irinin mbrapa?» Mos edhe ajo nuk ishte pa faj? Mos duhej të tregohej më e kujdesshme e të mos largohej e vetme në pyll, duke e ditur që është një vajzë midis burrave? Irini më ngjante me një sorkadhe që sapo ka mësuar të kërcejë e të vrapojë midis pyllit dhe, nga kënaqësia,

shkrihet së lodruari, kurse Ramadani, si një ujk me sy të skuqur e buzë të jargavitura, që i fanepset përpara e ia këput lodrimin.

Nga e ndara tjetër vinte një gërhitje. Ramadani... Ai gërhiste e gulçonte në gjumë, ngaqë flinte me zor prej barkut të madh («si shakull me gjizë», i thoshte Mihallaqi).

Edhe Mihallaqi i humbi gjakftohtësinë e humorin, kur mësoi për gjestin e Ramadani. Të gjithë morën inat. Edhe Stefani i shfryu: «Ptu, të hëngërt kolera, të hëngërt, more mi haleje! Ramadani s'duhet të qëndrojë më këtu.»

Gërhitja nga e ndara tjetër, si për inatin tim, ndihej edhe më fort.

S'mund të duroja më. U veshja e dola jashtë. Qielli ishte i kthjellët. E gërhitura e Ramadani më ndoqi deri jashtë. U largova për nga ndërtesa. Që nga poshtë më vinte zhurma e ujit të kataraktit, që përplasej me forcë pas shkëmbinjve. Në shkëmbin sipër pyllit u rrëzuan ca gurë; mbase vraponte ndonjë dhi e egër nëpër shkrepë. Një klithmë e trembur, si blegërimë e zgjatur, çau përmes fëshfëritjes së gjetheve të pyllit. «Ndoshta ndonjë sorkadhe e mbërthyer për gryke nga dhëmbët e ujkut». Kjo blegërimë, si duket, i dha shkas ulërimës së një çakalli. Në çast pylli u mbush me ulërimat e shumta të çakejve që mezi prisnin sinjalin e të parit të tyre. Hipa në ndërtesë dhe qëndroja në këmbë, sipër murit. Përballë kisha barakën e heshtur. Muret e saj prej dërrase zbardhonin nga gëlqerja. Brenda flinin shokët. Edhe Iri-ni flinte. Gërhitja e Ramadani nuk vinte deri aty.

Të nesërmen, qysh në mëngjes herët, Ramadani më kërkoi dy ditë leje për në shtëpi.

— Kur ika herën e fundit, djalin e vogël e lash të sëmurë. Kam merak si është bërë.

I thashë t'i drejtohej teknikës.

— Po deshe, t'i themi bashkë. Vetëm më vjen zor.

Iринi e lejoi. Ai mblodhi teshat, i futi në çantë dhe u nis.

Ecte me hapa të rëndë, duke ngjeshur qafën pas shpatullave. Vështrimet tona sikur e shtynin në drejtim të mjegullës, që kishte pushtuar gjithë faqen e shkëmbit dhe gjysmën e pyllit, ku kalonte rruga automobilistike.

Ai e dinte se do të priste gjatë atje, në anë të rrugës. Makinat në mëngjes shkonin lart, për në minierë dhe vonë ktheheshin për në qytet. Ai iku herët, për të mbetur larg shikimeve qortuese të shokëve.

Edhe ne e dinim që ai do të priste gjatë, i vetmuar, derisa t'i hipte ndonjë makine. Megjithatë, në heshtje, u solidarizua me ikjen e tij.

Në krye të dy ditëve, në vend të Ramadanit, erdhi një shkresë nga kantieri, ku thuhej se ai, me kërkesën e vet, transferohej nga brigada jonë.

— Më mirë që iku vetë, — thashë unë.

Pas pak ditësh na dërguan një murator tjetër, Zafir Guraleci e kishte emrin. Ky ishte një burrë i urtë, që, vetëm po t'i flisje, të kthente përgjigje, ndryshe s'e hapte gojën. Punës s'i ndahej gjithë ditën.

GELOJA MË THOSHTE QË S'GJEJ DOT NUSE

Jam njëzet e pesë vjeç. Dhe jam i fuqishëm. Siç duket, fuqia fizike ka qenë shkaku që ata të kryesisë së kooperativës më caktuan me kafshët, me mushkat, ta themi më konkretisht. Se fshati ynë është mallor dhe vendin kryesor si mjet i transportit të brendshëm e zë mushka. Unë e mbërthej thesin gjashtëdhjetëkilogramësh dhe e vërvit në majë të samarit *mu si një pendë*. Le të thotë kush të dojë që mushkat janë xanaxare, janë të sarta, kokëforta. Kokëfortësinë e tregojnë me atë që u shkon, me mua nuk ka dërti-mërti.

Sikur po ju mërzis, më duket, me këtë punën e mushkave. Po ç't'i bësh, këtë profesion kam. Dhe t'jua them hakçe, hiç nuk mërzitem. Ai që i mërzitet punës, është i humbur. Të mos e hedhim fjalën larg, Geloja është nga ata që i bëjnë dredha punës. Është edhe ai kafshar. Kur i caktuan një mushkë nga këto që kam unë, hidhej përpjetë e bërtiste me sa mundte:

— Është e egër! Është e prapë! Nuk përdoret! Le ta mbajë ai që e ka! Apo s'ia del dot vetë e kërkon të ma hedhë mua!

E lashë të zgjidhte cilën mushkë të donte.

I dridheshin duar e këmbë e vazhdonte britmat:

— Mos më bini më qafë! Ç'keni me mua?! Ç'faj kam bërë unë që më ngacmoni?! Më lini, jam mirë me pelat!

Dhe ashtu mbeti puna, siç qe: Ai tri pelat, unë pesë mushkat. Nuk pranon t'i bëjmë katër e katër. Dhe, megjithatë, s'ka gjë në vijë. Sa të ngarkojë ai njëren, unë kam mbaruar punë dhe i kam vënë përpara që të pesa. Mos pandehni ju tani se ky Geloja është ndonjë i dobët kockë e lëkurë, që i numërohen brinjët kur shkon rrugës. Sa të një demi trevjeçar e ka qafën. I kuqin faqet. Por i druhet lodhjes...

Një ditë u grindëm keq me të. Qemë caktuar të dy të prisnim furka për pjergulla. Sa shumë prodhuan rrushtë! U mbushën pjergullat plot dhe lindi nevoja të forcoheshin me furka të reja.

Kjo punë duhej bërë shpejt. U ngrita herët dhe, kur lindi dielli, isha në pyll. Në kohën kur unë kthehesha me të pesë mushkat ngarkuar, Geloja i ngjitej së përpjetës, hipur mbi samarin e pelës kuqaloshë. Dhe e përdridhte apo s'e përdridhte zërin:

*Kindat e fustanit palë përmbi palë,
Zotrote në mushkë, xhaxhai në kalë.*

I lëshova një «tungjatjeta! Si u gdhive?» S'ia zgjata më tej. U futa nga një purtekë lajthie mushkave dhe hë, o burra për në fshat. E pata vendosur që të bëja katër rrugë atë ditë, nga dy që qe norma. Duheshin forcuar pjergullat, or vëlla, ndryshe rrushi shkonte dëm. Nga kush të prisje, nga Geloja?! Ai tundej e lëkundej sipër samarit të pelës kuqaloshë dhe e ngryste ditën vetëm me një rrugë furka!

U ktheva për herë të dytë. Pelat e Gelos po kullojnë në sheshin mes pyllit. Zhurma e sëpatës së tij dëgjohej më tej, në korijen me lisa të mëdhenj. Ai zakonisht i bënte të rralla goditjet me sëpatë. Asaj radhe nxitonte, qëllonte shpesh e shpesh. «Do t'ia ketë këputur me gjumë deri tani», mendova. Desha t'i thërrisja njëherë, po ndërrova mendje. E di që justifikimin e ka në majë të gjuhës. «Do të kullotin pelat. I kam pa ngrënë. Nuk i duam vetëm për sot, na lipsen përgjithnjë.» Djalli vetë është. Unë e di sa i qan zemra nga kjo anë!

«Po ç'bën kësaj radhe ky merhum?», thosha me vete.

I lëshova mushkat në livadh dhe iu futa pyllit, andej nga dëgjohej zhurma e sëpatës së Gelos.

Gelon e pashë hipur mbi një lis të madh. Sëpata u lëshohej degëve të lisit dhe i bënte palë në tokë.

Gjithçka ishte e qartë. Ai që nisur për furkat e pjergullave të kooperativës dhe po priste degë dushku për bagëtinë e tij. Lisi me degët e prera kasapçe ngjante si një skelet i stërmadh, me gjymtyrë të thata, drejtuar nga qielli. Gelon e kishte mbuluar djersa, që shkëlqente nga rrezet e diellit. Më pat qëlluar disa herë të punoja me të. S'e kisha parë të djersinte. Mua s'më vuri re që iu afrova pranë.

— Ç'bën, o Gelo? — i fola.

Ai ngriti kokën. Një çurg djerse i vajti në sy. U mundua ta fshinte me shpinën e dorës. Dora ishte vetë e djersitur dhe sytë i dogjën më shumë. Sëpata i ra poshtë. Me njërin dorë iu desh të mbahej.

— Punë po bëj, — foli i inatosur. — Nuk e shikon ç'po bëj, apo të kanë plasur?!

Ndjeva se flegrat e hundës m'u bënë si gryka çifteje. Kam dëgjuar të thuhet që s'u vihet veshi fjalëve.

ve. Unë s'jam dakord. Goja flet, zemra zemërohet, dora... Jo, s'duhet të arrijë puna deri te dora, te të goditurit, desha të thosha. Njeriu ka arsye. Mushkave, kur bëjnë mbi rrugë e nën rrugë, u fut ndonjë shufër. Por Geloja, ama, të pëlçet shpirtin! Se ku i gjenca fjalë gjithë hejm!

Iu afrova pranë. Ai mori sëpatën dhe bëri të hip-te prapë në lis.

— Mos pri gjethe dushku! Përgatit furkat! — i klitha.

— Shiko punën tënde. Kam marrë leje atje ku duhet, — ma ktheu.

— Kujt i ke marrë leje, more?... E kush është ai që të lejon të merresh me një gjë kaq hiçe, para rrushit që po shtrihet përtokë?...

— Ik, ik, mos m'u jargavit ashtu, se t'u mbush gjoksi me pështymë!

— Ti të më tregosh mua... Ti... ti... — S'po gjeja dot fjalën që më hynte më shumë në punë atë çast. S'doja ta shaja. Jo se kurseja Gelon, po s'më vjen mirë për veten të përdor fjalë të ndyra.

Ai bëri prapë të ngjitej në lis.

— Mos! —... — Desha t'i thosha: «Mos e luaj këmbën».

Ai ndaloi:

— Ç'ke, or jahu, që i hyn sherrit kot së koti?! Ka kush kërkon llogari. Ka brigadier, ka kryetar. Ti je njësoj si unë, bile ca më keq, me pesë mushka.

— Mos mbetsha gjallë, në qofsha si ty! — Kjo përgjigje më erdhi njëherësh. Ai u ngërdhesh:

— Thashë që jemi njësoj nga pozita, të dy kafsharë. Nga anët e tjera, ehuuu... Ti u bërë njëzet e pesë vjeç e s'gjen dot një copë nuse! Unë, në moshën

tënde, isha me tre fëmijë. Po ç'hesap bëj me ty! Si njeri me mushka, ç'vete më tutje?

Hej, ç'muhabet! U morëm vesh bukur! I ktheva krahët. Ai u ngjit të priste degë dushku. Ia nisi me fishkëllimë një kënge banale.

...Ika t'i prisja furkat në një vend tjetër, ku të mos dëgjoja të goditurat e sëpatës së Gelos. Nisa të punoja si i ndërkrayer. Sëpata ngulej si e pangopur. Fluturonte nën forcën e krahëve të mi. Kur... diçka ndodhi. Një gjë e ftohtë m'u përplas pas këmbës. Më fshiku si gjarpër. Sëpata më pat dalë nga bishti. Presa kishte flakur tej majën e këpucës. Gjë pa zarar. Një prerje shumë e vogël në gishtin e madh të këmbës së djathtë. Shpëtova mirë. Mund të fluturonte dhe gjysma e këmbës. Vazhdova punën. Sëpata ngulej në dru. E prera hapej si gojë e shtrembër, që dukej sikur thoshte: «Ti s'gjen dot një nuse. Njëzet e pesë vjeç!»

Në krahinë tonë djemtë janë martuar në moshë shumë të re. Zakon i vjetër. Po të shkelte djali të shtatëmbëdhjetat, i ati përpiquej t'i gjente nusen. Kështu ka ndodhur me tim atë, me moshatarët e tij, me më të rinjtë, moshën e Gelos, bie fjala...

Me gjithë ligësinë, fjalët e Gelos kishin diçka të vërtetë. Një pjesë djemsh, edhe më të mëdhenj se unë, nuk po martoheshin dot. Mjaft vajza iknin nga fshati. Nga fshatrat përreth s'jepte, njeri nuse në fshatin tonë. «Vendi i egër, malësi», — thoshin. Pritërit e vajzave i mbanin sytë nga vendet e buta.

Në fshatin tonë Geloja që njëri nga ata (i pari i mblesëve) që na i përzinin vajzat. Se nga ia gjente sërën, kurdiste mblesërira, dhe kur ta shikoje syzëzën apo flokëverdhën (që ndonjërit ia pat rrëmbyer

zemrën) hipur në kalë, tek përcillej jashtë kufijve të fshatit.

Ngarkova mushkat. Pelat e Gelos ende kullotnin te sheshi. S'që nisur. Që larg ia dëgjoja fishkëllimën. Nga melodia kuptohej se ishte kënga. *Mblidhuni, o shokë, t'i biem bozuket.* Vargu i dytë i kësaj kënge thotë: *Të na mblidhen çapat, si dhitë pas dushkut.*

Këngëtari i vjetër ka shfaqur dëshirën që të mblidhen vajzëria rreth djemurisë, kurse Geloja do që t'i mbledhë e pastaj t'i shpërndajë ku të mundet.

Kohët e fundit hiqet sikur e ka mbledhur bish-tin. Është dhelpra ai. Dhelpra e mbledh dhe e lëshon bishtin sipas terrenit. Geloja pat premtuar në mbledhjen e Frontit që nuk do të merrej më me mblesëri-ra. Veçse kur ia thuri rrjetën Lirisë, që dashurohej me mësues Mensurin. Po ç'i gjuan çastet, i djallëzuar. Mensuri shkoi të jepte provimet me korrespondencë në institut, Geloja e ngriti planin e martesës së Lirisë. Dhe ku pa, në një qytet larg krahinës sonë! Po i lumtë Lirisë! U ngrit e i shkoi Mensurit atje ku jepte provimet...

Geloja e sajoi edhe fejesën e Kostandinës. Keni dëgjuar për Kostandinën, besoj. Është ajo që iku natën e dasmës dhe mori një kooperativist nga fshati fqinjë, një djalë të ri, me të cilin kishte qenë dy muaj në aksion. Një bejtexhi i fshatit ngriti edhe një këngë për Kostandinën. Melodinë e kësaj kënge nuk e kam dëgjuar ta marrë Geloja me fishkëllimë. Sikur të vepronim të gjitha vajzat si Liria dhe Kostandina! Se ka ndonjë që s'është ashtu, pa i mbetet radha Gelos t'i vërvitë nga t'i vijë për mbarë. Meremen e ka dërguar në Kolonjë, Luljetën në Berat, Liljanën në Gjirokastër...

Po ta shoshitësh mirë punën, arrin të nxjerrësh në shesh se vajzat s'kanë shumë faj. Edhe djemtë nuk janë të gjithë si Mensuri dhe si ai djali nga kooperativa fqinjë që u martua me Kostandinën. Ja, për shebull, unë, që u grinda me Gelon dhe ma mbylli gojën se «s'qenkam i zoti të gjej një copë nuse.» Nuk u bëra më i gjallë... Atëherë le të fliste Geloja me mua...

Për punë martesë kishim ca zakone të guditshme. Në qoftë se djalit i kalonte koha, i djersinin mustaqet dhe babai s'e vinte atë ujë në zjarr, djali i vinte natën nën jastëk një tufë me lule. Çfarë zakoni, ë! Më pas, kur babai, me lulet, s'bënte gjë, nën kokë i viheshin një shkop e një trastë. Dhe, në qoftë se edhe kjo dilte pa sukses, në vend të luleve e të trastës me shkopin, gjendej një sëpatë...

...Hej, ç'm'u zhdërdhit gjuha fare sot dhe po tregoj historira.

Të pesë mushkat ecin para meje në rrugën drejt fshatit, me hapin e tyre të zakonshëm. Ato e kanë në terezi. Kur zemërohen, inatin e nxjerrin duke hedhur shqelma. Shqetësimi i tyre kryesor është të mbushin barkun me bar, tagji e ujë...

...Sipas të thënave, në fshatin tonë vetëm Halili i Feritit ia ka vënë sëpatën te koka të atit, këtu e dyzet vjet të shkuar. Flitet se përdoren edhe sot të tilla marifete, por s'është për t'u besuar...

*
* *

Ishte errur, kur u ktheva nga rruga e katërt. Shkova nga zyrat e kooperativës. Do të merrja tagji për mushkat. Më duhej të takoja edhe brigadierin. Para zyrave-qetësi. Çdo mbrëmje aty ka gjallëri. Pa-

shë vetëm Gelon që po bënte fjalë me të mbesën për punë të tagjisë. Ai vetëm një rrugë kishte bërë. Desha t'i thosha brigadierit për të, por s'po e shikoja.

— Kanë ikur të gjithë në aksion për ndërtimin e rrugës, — tha magazinierja, Lida.

Ndërtohej një rrugë e re automobilistike. Së shpejti do të festohej dita e çlirimit të krahinës dhe, me këtë rast, populli i gjithë zonës kishte marrë zotim ta përfundonte rrugën.

— Nga gjithë forcat keni mbetur vetëm ju të dy, bukëpjekësja dhe unë, që më është ngarkuar të shes edhe bukën, — foli përsëri magazinierja. Ajo s'e dinte që ne ishim grindur atë ditë dhe na u drejtua të dyve njëherësh. — Më la porosi brigadieri që t'i vini forca e t'i mbaroni furkat këto tri ditë. Të bëni nga katër rrugë.

— Nuk i ngordh pelat, më duhen për ngahera, — foli Geloja, që qe hequr mënjanë e po dridhte një cigare.

— Unë jua thashë porosinë e brigadierit, — përsëriti magazinierja. Ajo qe zemëruar me të dhe s'donte ta çonte më tej grindjen.

Geloja e drodhi cigaren dhe filloi të lagte letrën me gjuhë.

— Duhet marrë punët me radhë, me rregull, — shtoi, sikur t'i fliste cigares. — Jo si te ne, hop andej e hop këtej, s'e merr vesh qeni të zonë.

Magazinierja mori të peshonte tagjinë e mushkave të mia. S'qe hera e parë që i dëgjonte këto fjalë.

U mata njëherë të futesha në bisedë e t'ia bëja samarin copë Gelos, por... kot. Të ishte brigadieri, po. Kurse magazinierja e kishte xhaxha Gelon. Sado që bënin fjalë për punë të tagjisë, prapë anën e tij do

të mbante. Shtëpitë veç e veç i kishin, vërtet, po gjakun nga një damar.

Mora tagjinë dhe u nisa për nga dera.

— Po ti, pse çalon ashtu? — më foli Lida. Ajo s'e kishte vënë re këpucën e prerë dhe gishtin e lidhur me shami.

Një çjerrje e vogël, — thashë.

— Ç'e vogël, ore! Ti mezi shkel në atë këmbë! U afrua dhe me një ton urdhërues më tha të hiqja këpucën. Ajo shërbente edhe si sanitare në fshat. Kishte mësuar tre muaj në një kurs. — Ua, po ti e paske prerë shumë keq! — foli, kur e hoqi shaminë. — Dhe pret që të shërohet me duhan! Duhet të bësh gjilpërat e tetanozit.

— Mirë, mirë, edhe ato më duhen. Nesër me natë do të shkoj për furka.

Ajo vajti te kutia e barnave, mori një shishe alkool dhe jod. Filloi të më pastronte plagën. Plaga më dogji. Geloja pinte duhan dhe shikonte nën vetullat e trasha.

— Hajde, do të më japësh tagjinë e pelave, se s'kam kohë të rri këtu, — i tha ai së mbesës. Zëri i doli i vrazhdë.

— Gati e ke, ta peshova qysh qëparë, — ia ktheu ajo, ndërsa merrej me plagën time.

— Aq sa peshove ti, s'del për tri pula, jo për tri pela.

— Kjo normë ushqimi është caktuar nga kryesia.

— Pelat i kam unë në ngarkim, jo kryesia.

Ajo s'ia ktheu më. Po merej gjatë me të prerën e këmbës sime. Dhe ngulte këmbë se duhej t'i bëja patjetër gjilpërat kundër tetanozit. Nuk dëgjova.

Kush i duronte ato! Sa ma lidhi gishtin, bëra prapë të ikja. Lida më ndaloi përsëri.

— Nuk ma solle atë filiçin që të kam porositur.

Filiçi është një vegël që përdoret për të rrahur kosin në tundës, me bisht të hollë dhe me fund të trashë, të rrumbullakët.

— Pse s'më the mua? — u fut Geloja në bisedë.

— Apo më kishe larg?

— Ta sjell nesër, — i thashë. — Natën e mirë!

— Natën e mirë! — ma ktheu ajo.

Kur dola jashtë, dëgjova zërat e tyre. Më kapi veshi: «Pse s'i the natën e mirë ti, xhaxha?» Përgjigja e tij erdhi e mbytur. U largova për në shtëpi.

Ditën tjetër bëra katër rrugë. Geloja vetëm dy. Unë ngjitesha përpjetë për herën e katërt, Geloja zbriste tatëpjetë për herën e dytë. Sa më pa që nga larg, nisi të këndonte:

*Bëje dru, o, moj, në, o, në përcëllimë,
moj leshve—, moj — verdha, hajde, o, trëndelinë...*

Kjo do të thoshte që e kishte punën shumë në rregull, dhe unë të pëlçisja nga inati.

Kur u gjendën përbri njëri-tjetrit, ndodheshin në një vend të ngushtë. Ai i nxiti kafshët fort, saqë pela e zezë dhe për pak sa s'më rrëzoi me barrën e furkave. Mua më kapën sytë që ato ishin shumë të holla. Ai qëllimisht shpejtonte, të mos ia vëreja punën e dobët. Kokën e mbante lart, si kalë, shenjë që tregonte se kishte shpallur mërinë ndaj meje. Mua s'më pëlqen të mbaj mëri me njeri. Megjithatë, kush s'do, le të mos flasë. Geloja e përdorte mërinë për t'iu shmangur kritikës. S'e vlente të bëja fjalë me të atje, në mes të rrugës. Vazhdova të ngjitesha përpjetë. Nga prapa dëgjohej zëri i Gelos:

*Ku e ke bandillin tinë,
t'i bëjmë kartë të vijë...*

Ai ulej poshtë. Unë ngjitesha lart.

*Qenka, mos na qenka, një hatri bylmes.
na kërkon për nuse çupën, time mbesë»...*

Vetvetiu këmbët m'u mbërthyen në rrugën ku shkelja. Aty për aty më hipi në kokë t'i kthehesha e ta kapja për fyti, t'ia mekja atë zë që i dilte nga zgavra e gojës.

Ai ecte dhe këndonte mbrapa pelave. Figura e tij sa vinte e zvogëlohej.

Eca përpjetë. Pjergullat me prodhim të bollshëm prisnin të mbështeteshin në furka.

Këmba m'u përplas pas një guri. Gishti i prerë më dhembti. I marrë me punët e ditës, e pata harruar atë.

...Natën që kaloi më qe enjtur. Dhe rënkoja në gjumë. Nëna më zgjoi. Qe trembur. S'më ka dëgjuar tjetër herë të rënkoj. Ishte edhe vetëm atë natë. Të tjerët kishin shkuar në aksionin e rrugës automobili-stike. Kur ma pa këmbën të lidhur me fasho (s'i kisha treguar në mbrëmje), shqetësimi iu shtua më shumë. Vrapoi në shtëpinë e Gelos. I qe lutur të më çonte në spitalin e lokalitetit.

— Unë jam sëmurë për vete, — i qe përgjigjur ai.

Magaznierja e kishte ngjitur shtëpinë me xhaxhanë e saj. Trokitja në derën e Gelos e zgjoi dhe atë. I dëgjoi ajo edhe lutjen e nënës sime edhe përgjigjen e xhaxhit të saj. U ngrit dhe erdhi tek unë. Edhe e ëma i kishte thënë:

— Shko, bijë, shko, mbase heq keq i ngrati djallë.

Së bashku me nënën më bënë kompresa me uthull.

— Do t'i bëj një penicilinë, — iu drejtua nënës.

Unë, si i sëmurë, përjashtohesha nga e drejta për t'u pyetur.

— Si të duash, ti e di... — Nëna mblodhi supet.

Lida më zbuloi vendin ku do të bënte gjilpërën. Më vinte turp, po s'kisha ç'bëja, punë mjekësie... Maja e hollë hyri në mish.

Jashtë u dëgjua e lehura e Balos. Disa hapa të rëndë u ndien te qoshja e avllisë. Një kollë e shtirur... «Geloja», thashë me vete.

— Xhaxhai, — murmuriti e mbesa.

— Qenka shëruar, — tha nëna nëpër dhëmbë.

Ato vazhdonin me kompresa.

Pas pak më mori gjumi.

Kur e zgjova, ndihesha i lehtësuar. Këmba më ishte çenjtur. Po afronte mëngjesi. U ngrita të kullojtja mushkat.

...Kisha dalë në krye të së përpjetës. U ktheva të shihja mbrapa. Geloja dukej si lëmsh që rrokullisej mbrapa pelave. U futa në monopatin që shtegtonte midis pyllit. Furkat i kisha të përgatitura. Kërkoja një dru panje për filiçin e Lidës. S'bënte të mos ia kryeja përsëri porosinë. E preva dhe nisa ta gdhendja. Kisha marrë me vete një limë druri. Duhej bërë i lëmuar, të mos ia vriste duart, kur të rrihte kosin. Si e përfundova, shënova me biçak datën e përgatitjes, emrin e përgatitësit, domethënë timin dhe të asaj që ia dhuroja, të magazinieres.

Rrugës për në fshat mendoja për këtë dhuratë që

i bëja një vajze. Më vjen ndoresh të merrem me gdhendje druri.

Këto mendime më përziheshin me këngën e Gelos:

Qënka, mos na qënka...

S'm'u nda që s'm'u nda. Le të këndoje çfarëdo kënge që të ketë qejf, po të bëjë edhe punë, të mos tallet me rrushtë e kooperativës. Unë me pesë mushka bëj katër rrugë, ai me tri pela... Dhe bën punë të keqe. Kur të ktheheshin shokët nga aksioni, do ta bëja problem. Po s'mori masa brigadieri, do të kap kryetarin. Dhe, po s'bëri gjë as kryetari, ka më lart. S'mban më ujë pilafi... Po do të marrin masa se s'bën. Vetë brigadieri ka lënë porosi që të përfundohen furkat këto tri ditë. Dhe le t'i shohë furkat që ka sjellë Geloja. T'i shohë edhe të miat. I kam lënë mënjane....

Po Geloja, si ta dinte ç'mendoja unë, i doli së keqes përpara. I kishte përzier furkat e mia me ata shkopinj të e hollë që kishte sjellë vetë. Përzierja që bëre aq keq, sa doje një ditë plot për t'i ndarë veç e veç.

Nuk e donte t'i kthehesha e ta bëja petë? Po lëre, me kë të merresh... S'është nevoja për forcë fizike tani. Ka masa të tjera, rregulla. Janë ligjet të forta për ata që ecin shtrembër.

Shkova në magazinë. Përpiqesha ta harroja me çdo kusht. Përpara kisha mbesën e tij. Ajo dukej e qeshur, e çelur dhe më e zbukuruar se zakonisht. U gëzua shumë nga dhurata që i solla.

— Shumë i mirë. Shumë i mirë, — tha. — Më sollli dhe xhaxhai një, por s'më pëlqeu.

Ndërkaq u dha në derë Geloja. Shkoi përsëri në qoshe, larg nesh dhe zuri të dridhte cigare. Shikonte nga ne tinëzisht, me bisht të syrit. Unë qëllimisht qëndroja i kthyer nga ai. Lida shikoi ç'kisha gdhendur me brisk në filiç. Sytë e saj shkëlqenin. Fytyra e Gelos nxinte. Ishin të dy, xhaxha e mbesë, të një fisi, të një gjaku. Dhe prapë nuk shkonin, ishin e kundërta e njëri-tjetrit.

— Si e ke këmbën tani? — më pyeti Lida.

— M'u shërua, ma largove ti dhembjen.

Ajo qeshi. E qeshura e saj i ngjante gurgullimës së ujit që bie nga kataraktet e vogla.

— Unë ta largova dhembjen?

— Ti më shërove.

— Kaq shpejt?

— Ou, menjëherë!

— Nuk më gënjen?

— Kë të gënjej, ty të të gënjej?!

— Ashtu, ë?

— Ashtu, posi!

Vështrimi më qe mbërthyer te buzët e saj në ngjyrë qershie.

Geloja e thithi fort duhanin dhe i ngeci në grykë. U kollit me forcë.

Sa më brengoste prania e tij në magazinë atë mbrëmje.

— Duhet të ta kontrolloj plagën. — Lida e zgjidhi fashon. — Duhet ndërruar, — foli pas pak.

Isha pënkulur edhe unë për të parë plagën. Flokët e saj më ceknin në fytyrë. I ndieja frymëmarrjen.

— Edhe sa duhet të pres?! — foli Geloja. Ai ishte afruar pranë nesh.

— Tagjinë e kam bërë gati, — iu përgjigj e mbesa, ndërsa më lidhte mua këmbën.

Geloja nuk foli më. Qëndronte pa lëvizur, me këmbë të hapura, në mes të magazinës. Prisja ç'do të bënte. Por ai ndenji edhe pak ashtu, pastaj, pa folur, mori tagjinë e doli jashtë.

— Më prit, kam pak punë dhe shkojmë bashkë, — tha Lida.

E prita. Kur dolëm, ishte errur. Hera e parë që ecnim bashkë.

Mbrapa na ndiqte një hije. Geloja...

...Lida është moshatare me time motër, Linditën. Ajo vjen, hyn e del në shtëpinë tonë sa herë i do qejfi, njësoj si në shtëpi të saj. Nëna shpeshherë lë ndonjë gatesë të mirë mënjanë dhe thotë: «Është për çupat.» Në shtëpi unë flas e sillem lirshëm me të, si fqinjë, si shoqe e sime motre. Ndërsa jashtë shtëpisë marrëdhëniet ndryshojnë. Mund të takoheshim në mbrëmje te furra e bukës. Shtëpitë i kishim afër, por bashkë s'mund ta bënim atë rrugë. Ajo do të kërkonte ndonjë shoqe dhe unë ndonjë shok. Shumica kështu vepronin në fshatin tonë. Një rast i kundërt...

*
* *

Atë mbrëmje rrugën nga magazina deri në shtëpi e bëme bashkë me Lidën. Dhe një si hije na ndiqte mbrapa. Them unë një si hije. Njeri nuk shikoja. Ndoshta më ndiqte mendimi i shqetësuar. Thashë që ishte hera e parë.

Sidoqoftë gëzimi ishte më i madh dhe e mbulonte shqetësimin. Rruga që e qetë, s'kalonte njeri. Do të dëshiroja që ajo rrugë të zgjatej, të zgjatej pa

fund. Po rruga që e shkurtër. Doja t'i thosha shumë fjalë, t'i shfaqja shumë mendime. Ç'e do, nuk isha i zoti! Edhe Lida diç bluante në mendje. E ndieja ngaqë merrte frymë me zor.» Epo, njësoj qenkemi», thashë me vete. Mora zemër t'i kapja dorën. Dhe i zura vetëm gishtin, gishtin e vogël të dorës. E mallkova dorën time, atë dorë të madhe, me gishta të trashë, që thesin 60-kilogramësh e rrëmben dhe e vërvit si pendë në majë të samarit të mushkës. Kjo dorë ishte e pazonja për të marrë plotësisht në pëllëmbën e vet (si putër ariu) dorën e një vajze që ndodhej fare pranë. Nejse, edhe me kapjen e një gishti duhej të mbetesh i kënaqur. Trembeshja se mos Lida e hiqte rrëmbimthi. Dhe, kur u binda se jo, zemra më rrahu më me forcë. Ajo i afroi edhe gishtat e tjerë pranë dorës sime. Atëherë u bëra trim: ia mbërtheva gjithë dorën e vogël në dorën time të madhe. Ia shtrëngova aq fort, sa i dhembti. Lëshoi një «oh» të lehtë. Atëherë ia lirova pakëz. Dhe ashtu, të zënë për dore, ecëm disa hapa. E çova Lidën deri pranë shtëpisë së saj.

Te qoshja e avllisë ndalua. Kishim qëndruar fare pranë, gati sa s'na prekeshin supet. Mendova në çast që ta kapja nga të dyja duart. Por e kapa për supesh dhe... Ajo u drodh. M'u duk sikur u përpoq të më largonte. «Mos, mos...»

...U ndien disa hapa të rëndë. Një kollë e thatë, e shtirur.

Geloja na ndiqte mbrapa si hije. Po s'kishim pse të frikësoheshim. Ai ishte hije. Ne ishim dy njerëz, dy të rinj që duheshim. Zemrat tona sapo i kishin bashkuar trokitjet me njëra-tjetrën.

Nga dritarja e hapur e shtëpisë së Lidës vinte një erë e mirë gjalpi të skuqur. Nëna e Lidës përgatiste

gjellën. Për të bijën sigurisht. Ajo s'e dinte se... Me Lidën për dore u drejtuam për nga hyrja e shtëpisë. Si do të na priste nëna e saj?

Hapat e rëndë dhe kolla e thatë e Gelos mbetën përjashta. Ç'do të bënte tani Geloja? E ç'i mbetej të bënte? Tani ne s'ishim vetëm shokë pune, shokë të një profesioni, po edhe miq. Mik me Gelon? Sa të vinte brigadieri e Geloja do të përgjigjej për punën e këtyre ditëve. Po ai, si do të sillej me mua? Geloja thoshte që unë s'gjeja dot një nuse.

1978.

UNË QË NDËRTOJ SHTEPI PËR NJERËZIT

Kur eci rrugëve të qytetit, mbaj sytë nga ndërtesat. Në muret e tyre ka një pjesë të djersës sime. Edhe një pjesë të forcës së mendimeve, një pjesë të rinisë. Kur hipa për herë të parë në skelë, usta Kadriu, që tani është në pension dhe që s'i ndahen as zemra as mendja nga ndërtesat, më thoshte me të qeshur: Ngriji pantallonat, se do të të bien! Epo, kisha ardhur nga fshati im i largët malor dhe pantallonat i mbaja të lidhura me një gjalmë prej leshi të dhirtë. Po ç'rëndësi kanë pantallonat! Megjithëse atëherë ishte edhe ca vështirë të kishe dy palë njëherësh. Ndryshe tani... Sidoqoftë pantallonat s'më ndalonin të punoja...

Para se të vija në qytet, unë njihja vetëm dy muratorë: Ruçon edhe Llambbron. Ata bënë shtëpi të reja e të bukura me gurë. Ruçoja dhe Llambroja për mua ishin njerëzit më të zotë në gjithë krahinën dhe mezi prisja të rritesha, që të mund t'u afrohesha sadopak. Por erdha në qytet dhe pashë me qindra si ata, bile edhe më të zotë. Ruçoja e Llambroja bënë vetëm shtëpi me një kat e rrallë me dy. Këta këtu me katër, me pesë, me gjashtë kate...

Kaloi një vit, kaluan dy, u bënë tre vjet...

Kur pashë për herë të parë emrin tim në stendën e të dalluarve, ndjeva gudulisje në zemër. Se si më vinte: «Jam apo s'jam unë?» Më vonë u shpalla edhe sulmues i parë. Fotografia ime radhitej shpesh në krye të më të dalluarve. Në mbledhjet ruhej gjithnjë karrigia për mua, midis anëtarëve të presidiumit. Kur ecja rrugës, i jepja enkas kokës lart e gjoksit përpara. Më takonte.

Kush punoi i pari me metodën e re në ndërtimin e mureve? Ç'ishte kjo metodë? Një murator punonte me dy ndihmës: njëri prej tyre hidhte llaçin me lopatë mbi mur, tjetri ia jepte tullat te dora. Muratori shtronte llaçin e vendoste shpejt e shpejt tullat pas spangos, dhe rendimenti rritej e rritej. Për këtë metodë, disa nga shokët në fillim hezitonin. Beqiri e kundërshtoi hapur para të gjithëve: «Kalamallëk, — tha. — Ç'na duhet zakoni i ri në fshat të vjetër?» Po unë bëra dy norma në një ditë. Taqoja, pas një jave, bëri edhe më tepër.

Kush e filloi i pari suvatimin me lopatë? Po edhe këtu ma kaloi Mezani ditën e tretë. Mezanit i doli përpara Ademi ditën e pestë. Në krye të dhjetë ditëve unë i dola përsëri përpara Ademit...

Po në shtrimin e pllakave kush bëri i pari një dhomë në ditë nga një gjysmë që bëhej zakonisht? Pas një muaji ne bënim secili nga një dhomë e gjysmë...

Prandaj ecja rrugës, anës së ndërtesave, i krekosur, me kokën lart e gjoksin përpara. Kështu ecnim edhe së bashku me inxhinier Besnikun, me gjeometër Kostën, me Taqon, me Mezanin, me Ademin...

Dhe atëherë qëlloi që... rashë në dashuri. Dashuria ime e parë. Në fshatin tim të largët malor thoshin se

dashuria e parë të shumtën e herës është si shiu në behar; të lag e thahet brenda orës. Por unë mendoja se dashuria e parë duhej të ishte si dielli i korrikut; ta çon urrejtësinë deri në palcë. E pra, rashë në dashuri me Zanën. Zana ishte një studente që mësonte për inxhinieri dhe bënte praktikën në ndërtesën ku punoja edhe unë. Unë e mësoja të suvatonte dhe në punë e sipër ia mbaja dorën e saj në timen. Por po mbushej muaji i praktikës së Zanës, dhe unë s'po gjeja aq forcë, sa t'i shprehja atë që ndieja. Ditën e fundit vendosa: do t'i them. Dhe i thashë. Po... mora edhe përgjigjen.

— S'e kam në plan fejesën, do të vazhdoj studimet, më tha — Zana si me keqardhje.

— Të pres, — fola unë.

— Edhe ti duhet të mësosh, — ma priti Zana, e vrenjtur. — Ja mbrapa.

Dhe mua m'u varën duart, si njëherë në fshat, kur desha të këputja një kokërr mollë pa leje dhe i zoti i bahçes, që u ndodh aty, më qëlloi me shkop duarve.

U rrëzuan ëndrrat, u hoqën shpresat. Unë, që për punë quhesha sulmues i parë, për Zanën nuk isha as i fundit.

Unë isha ulur në bankën e shkollës 14-15 vjeç djalë. Vite më parë, në fshatin tim të largët malor shkolla mbetej vetëm si një ëndërr. Ruçoja me Llambron e ngritën një shkollë qysh para luftës. E ngritën me mundime. U shpërblyen vetëm me djersën që derdhën. Askush s'i paguante. E kush do t'i paguante? Fshatarët dogjën edhe një furrë gëlqere. Shtëpitë e fshatit ishin ndërtuar të gjitha me baltë. Por për shkollën prodhuan gëlqere, mblodhën edhe gurë të mirë, të zgjedhur

dhe ua afruan Ruços e Llambros për të ngritur shkollën. E bënë të bukur dhe me dritare të mëdha, paçka se shtëpitë i kishim të errëta, me dritare të vogla, saqë, po të nxirrte kokën fëmija jashtë, me vështirësi e fuste prapë brenda.

U ndërtua shkolla, por mësues nuk na erdhi. Dhe mbeti shkolla si hambarët bosh të fshatit tim të largët malor...

...Një ditë u hap. Dhe u mbush me njerëz. Jo me nxënës e mësues. Ose edhe nxënës e mësues mund t'i quaje. Nxënës ishin fshatarët, mësues ishte murator Llambroja. U hap shkolla atëherë, kur krismat e pushkëve ndiheshin më dendur nga Qafa e Dëllinjës dhe Maja e Kokojkës. Murator Llambroja formoi Këshillin Nacionalçlirimtar të fshatit. Usta Ruçoja i thijnur, në punët e reja u bë ndihmës i ndihmësit të tij të punëve të zanatit. Shkollën s'e kishin bërë kot. «Hambarët bosh u mbushën me bereqet të mbarë», thoshte Ruçoja.

Po gjermanët e ballistët të parën dogjën shkollën e fshatit.

Pas luftës, Ruçoja dhe Llambroja, bashkë me fshatarët që kishin mbetur (20 dëshmorë ranë nga fshati ynë i vogël me 18 shtëpi), e ngritën shkollën e re. Në themelet e saj hodha edhe unë shumë gurë. Kur e mbaruam, zura vend në bankën e parë.

Pastaj ika nga fshati. Më thërriste zëri i ndërtesave, zëri i shtëpive të reja me shumë kate. Në mbrëmje, kur shkoja në shkollë, pas pune, në sirtarin e bankës ku vendosja librat, mbeteshin edhe copërat e llaçit.

Zana ishte edhe shtatë vjet më e vogël se unë dhe nuk i dinte të gjitha këto. Për një muaj kohë unë e mësoja si të mbante e të përdorte mistrinë dhe s'mbeti kohë t'ia tregoja historinë time. Se, po ta dinte, s'do t'i shqiptonte me aq lehtësi ato dy fjalë: «je mbrapa». Por...

Secili prej nesh kishte rrugën e vet në jetë. Zana pranë librave e fletoreve, në bankat e shkollës, unë me mistri e çekiç, në skelat e ndërtesave. Në vend të letrës e tabelës së zezë unë përdorja edhe faqet e gjera të mureve. Rruga jonë u bashkua vetëm në një pikë, për një muaj kohë. Dhe unë kujtoja se kjo pikë takimi do të zmadhohej, e prej saj do të niste një vijë e gjatë.

Të nesërmen Zana nuk ishte më në dhomën ku suvatoja. Pranë ndieja hijen e saj. Në gishtërinj ruheshin prekjet e dorës së saj, kur i mësoja si të punonte. Në veshë, dy fjalë më rrinin si grerëza: «Je mbrapa».

Beqiri nga një dhomë tjetër e afërt këndonte:

*Binte shiu pa pushu,
ngelën çunat pa u martu.*

Me Beqon isha ndeshur në disa raste. Për herë të parë, kur zbatuam metodën e re dhe ai tha që ishte kalamallëk. Për herë të dytë, kur filluan suvatimin me lopatë dhe tha: «është hamallëk. Për herë të tretë, kur ngritëm normat dhe tha se po bënim budalla-llëk. Për herë të katërt, kur u mblodhëm e shkarkuam drejtorin, që e kërkonte mbështetjen në njerëz servilë si Beqiri. Dhe për herë të pestë, kur shpifte për brigadier Latifin, sepse përpiqej t'i zinte vendin.

Ai i mbante mend mirë të gjitha, ndoshta edhe

më mirë se unë. Ai kishte dalë përherë i mundur dhe të gjithë dufin donte ta shfrente me dy rreshta të një kënge të rëndomtë: «*Binte shiu...* si ato rake-traket që vinim në fshat në arat me misër, për të trembur shpesët e egra. Le të çirrej. Gurmazin e tij do të lodhte. Unë isha i sigurtë për këtë, ashtu siç isha i sigurtë se nuk kisha mbetur mbrapa. Rrugën e shkollës e kisha nisur prej kohësh. Nuk ishte Zana ajo që ma jepte këtë mësim, që ma zbulonte nevojën e shkollës. Unë e kisha ndier këtë nevojë që kur fshatarët e mi mbli-dheshin me Llambbron e Ruçon te shkolla që dogjën gjermanët, që kur shikoja gjithë ata njerëz që mezi lexonin një letër, me ndihmën e shkronjave që kishin mësuar vjedhurazi. Prandaj edhe i vura duart e mia të dobëta në përdorim, për t'u afruar gurë Ruços e Llambros, që të ngrinin themelet e shkollës në fshatin tim të largët malor.

Kaluan përsëri disa vite. Dhe u ndeshëm përsëri me Zanën në një pikë takimi. Rrugët tona s'kishin qenë aq të veçuara, sa kujtoja atëherë, kur ajo më tha: «Je mbrapa». Mua, pasi mbarova teknikumin, më emëruan përgjegjës sektori në ndërtimin e bane-save. Zana kishte dalë inxhinierë dhe qe caktuar në kantierin tonë, pikërisht në sektorin ku punoja unë. Zana disi me vështirësi i shqiptonte fjalët: shoku përgjegjës.

Dalngadalë sektori u rrit, u bë kantier. Unë mbe-ta përgjegjës me vendim të mbledhjes së gjithë ko-ektivit. Ndërsa Zana u caktua kryeinxhinierë. Në atë mbledhje u ngrit vetëm Beqiri dhe foli mbi një orë kundër meje. Ai tha se unë kisha punuar gjith-një për bujë e për reklamë.

S'më lanë aq kohë, sa të ngrihesha për të bërë

sqarimet. Fill pas Beqos foli Taqoja; pas Taqos dis-
kutoi Ademi, folën Mezani, Kosta, Besniku... Dhe
ndërsa shokët flisnin, Beqiri shikonte nga dera. Don-
te të ikte...

Kështu, puna na mbajti përsëri pranë mua me
Zanën. Zana nuk i shqipton më me vështirësi fjalët:
shoku përgjegjës. Verën që kaloi unë dhashë provi-
met e fundit në shkollën e Partisë. Zana buzëqesh
shpeshherë, kur më kërkon në zyrë dhe më gjen du-
ke ngritur qoshet e mureve bashkë me shokët e mi
të vjetër e të rinj.

Kanë kaluar vite qysh atëherë, kur Zana më tha:
«je mbrapa.»

Tani atë ndodhi e kujtojmë me të qeshur. Dhe
ashtu, duke qeshur, Zana më thotë: «ma kalove.» Ajo
bën shaka, sepse unë asnjëherë nuk kam synuar t'ia
kaloj. Synimi im mbetet: Të ndërtoj shtëpi për nje-
rëzit.

1978.

PASQYRË E LËNDËS

Ngjitja nëpër skela (novelë)	5
Unë, Habibi dhe brigadieri	67
45 minuta mbi çati	73
Hall me tullat e bardha	81
Brigada e shakaxhinjve	86
Godina 17 (novelë)	95
Krushq pa nuse (tregim humoristik)	158
Një ditë me dhembje dhëmballe	161
Një vajzë në Gjurmëmushkë	171
Geloja më thoshte që s'gjej dot nuse	186
Unë që ndërtoj shtëpi për njerëzit	203